REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Nr.203/9.Prot. Tiranë, më 20/10/2021

Miratohet

KRYETAR

Arben SHEHU

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
ME TEMË:
ñEFEKTIVITETI I AKTIVITETIT TË BIBLIOTEKËS KOMBËTAREò



X

Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës

Publik: *Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", specifikisht nenin 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.*
Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; E-mail: Web-site: www.klsh.org.al

RAPORT AUDITIMI

ñEfektiviteti i aktivitetit të Bibliotekës Kombëtareò

Tetor 2021

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 203/1 prot.Datë 29.04.2021.

Faza studimore e auditimit nisi më datë 11.02.2021, me shkresën për njoftim-fillim auditimi nr. 203 prot. datë 04.02.2021, dhe përfundoi më datë 29.04.2021.

Faza e terrenit të auditimit nisi në datë 29.04.2021, me Programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi në 29.05.2021.
Projekt-raporti është draftuar nga grupi audites në datë 29.06.2021, dhe nisur subjektit nën auditim, me shkresën me nr. 203/2. Prot, datë 05.08.2021, në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës.
Auditimi me temë ñEfektiviteti i aktivitetit të Bibliotekës Kombëtareò, ka mbuluar periudhën 2018-2020 dhe është fokusuar në Bibliotekën Kombëtare Shqiptare si ïnstitucioni përgjegjës në hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me aktivitetin eBibliotekës Kombëtare. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën me protokoll nr. 203/2. prot, datë 05.08.2021,iu përcoll Projekt-Raporti i Auditimit subjektit të audituar.
Biblioteka Kombëtare Shqiptare ka dërguar komentet e saj mbi projekt-raportin me anë të shkresës nr. prot. 203/6, datë 27.09.2021, ku grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje argumentimet e subjektit dhe i reflektoi ato në raportin përfundimtar.
Ky Raport është hartuar në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës e konkretisht: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI, Udhëzuesin e Auditimit të Performancës ISSAI 3000 ï 3100, Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës, si dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në konsultë të vazhdueshme me stafin e institucionit kryesor BKSH, subjekt auditimi, intervistat, përvojën më të mirë audituese në këtë fushë, etj.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. Z. X, (përgjegjëse e grupit të auditimit);
2. Z. X, (auditues);
3. Z. X, (auditues).

Procesi audites u mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme nga drejtori i departamentit.
Dosja audituese kaloi në procedurën e Kontrollit të Cilësisë dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.

PËRMBAJTJA

1.PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT..... 6
1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL..... 6
1.2 RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS..... 7
1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË..... 8
2. SUBJEKTI/ET NË AUDITIM 8
2.1 HYRJE NË SUBJEKTET NË AUDITIM..... 8
2.2 BAZA LIGJORE QË RREGULLON ÇËSHTJEN NËN AUDITIM 11
2.3 RËNDËSIA E PRODUKTEVE TË SUBJEKTIT 12
2.4 PESHA NË BUXHET 15
2.5 PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA 17
2.6 SKEMA E ANALIZËS SË PROGRAMIT 18
2.7 FEEDBACK-U I SUBJEKTIT NË FAZËN STUDIMORE 19
3. DETAJET E AUDITIMIT 19
3.1 VLERËSIMI I RISQEVE TË AKTIVITETEVE TË SUBJEKTIT 20
3.2 OBJEKTIVAT E AUDITIMIT 20
3.3 PYETJET E AUDITIMIT 21
3.4.FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT.....21
3.5KRITERET E AUDITIMIT 23
3.6. QASJA E AUDITIMIT.....24

4. SHTJELLIMI I PIRAMIDËS SË PYETJEVE TË AUDITIMIT..... 25
4.1 A JANË EFEKTIVE POLITIKAT NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E VEPRIMTARISË SË BK?..... 27
4.1.1 A KA SIGURUAR BK ZBATIMIN E KUADRIT LIGJOR /RREGULLATOR? 44
4.1.2 A JANË TË MJAFTUESHME HAPËSIRAT BIBLIOTEKARE PËR PËRMIRËSIMIN DHE RRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMIT NDAJ PËRDORUESVE TË LIBRIT? 73
4.1.3 A KA QENË E MJAFTUESHME MBËSHTETJA FINANCIARE NË PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË BK?..... 82
4.2 A ËSHTË KRYER DIGJITALIZIMI I PLOTË I SHËRBIMIT BIBLIOTEKAR,PËRPERIUDHËNNËAUDITIM?.....
.....93
4.2.1 A KA QENË EFEKTIV PROCESI I DIGJITALIZIMIT TË TË DHËNAVE TË FONDIT TË MATERIALEVE BIBLIOTEKARE?..... 94
Â 4.2.2 A KA QENË EFEKTIVE QENDRA E DIGJITIMIT TË TRASHËGIMISË SË SHKRUAR PËR PERIUDHËN 2018-2020?.....96
5. PËRMBLEDHJE 123
5.1 Anekse 128

LISTA E SKEMAVE, GRAFIKËVE DHE TABELAVE

SKEMA 1: ORGANIGRAMA E ADMINISTRATËS SË BKSH-SË 10
SKEMA 2: ADISA 11
SKEMA 3: PAMJE TË KOLEKSIONEVE NË FORMAT ELEKTRONIK 12
SKEMA 4: FLETË KËRKESË ELEKTRONIKE 12
GRAFIKU 1: GRAFIK I FAQEVE TË PUBLIKUARA ONLINE 14
SKEMA 5: MODELI LOGJIK 18
SKEMA 6: PYETJET E AUDITIMIT 21
TABELA 1: TABELA E FONDEVE TË SHPENZIMEVE BUXHETORE 16
TABELA 2: ANALIZA SËOT 19
TABELA 3: KATEGORIZIMI I RISKUT 20
TABELA 4:MATRICA E KRYERJES SË AUDITIMIT SIPAS KOHËS 22

SHTJELLIMI I PIRAMIDËS SË PYETJEVE TË AUDITIMIT

SKEMA NR. 1: LËVIZJA E MATERIALEVE BIBLIOTEKARE SIPAS SEKTORËVE.....51
SKEMA NR. 2: LIDHJA E SEKTORËVE QË KANË FUNKSIONIN KRYESOR NË PROCESIN E DIGJITALIZIMIT TË BKSH 90
GRAFIKU 1: TOTALI I FONDEVE TË SHPENZIMEVE KAPITALE 78
GRAFIKU 2: TOTALI I FONDEVE TË SHPENZIMEVE BUXHETORE.....78

GRAFIKU 3: TREGUESIT E QASJES SË FAQES ONLINE 93
GRAFIKU 4: MATERIALET E DIGJITUARA DHE PËR DIGJITIM 95
GRAFIKU 5-6: PARAQITJA E BIBLIOTEKËS DIGJITALE ONLINE ME NUMRIN E FAQEVE TË DIGJITUARA NË VITET 2015-2020 109
GRAFIKU 7: QASJA ONLINE NË FAQEN ZYRTARE TË BK 110
GRAFIKU 8: REALIZIMI I PROGRAMIT VJETOR TË QTB-SË 114
GRAFIKU 9: TRAJNIME PËR PËRVETËSIMIN E TEKNOLOGJISË DHE PAJISJEVE INFORMATIKE 115
TABELA 1: ZHVILLIMI I SISTEMIT INFORMATIK BIBLIOTEKAR 31
TABELA 2: NUMRI I PJESËMARRËSVE NË SHKOLLËN KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË 35
TABELA 3: NUMRI I PJESËMARRËSVE NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT DHE AFTËSIMIN NË INFORMACION 36
TABELA 4: NUMRI I PJESËMARRËSVE NË PROGRAMET E AFTËSIMIT NË INFORMACION NGA INSTITUCIONET ARSIMORE 37
TABELA 5: TREGUESIT PËR SHËRBIMET ONLINE DHE NË MJEDISET E BKSH 42
TABELA 6: TË DHËNAT SIPAS ORGANIKËS, POZICIONEVE DHE PROCESEVE TË PUNË QË KRYEJNË 48
TABELA 7: TË DHËNAT E HYRJEVE DHE DALJEVE TË LIBRIT NË SASI DHE LEKË 55
TABELA 8:HYRJET SIPAS LLOJIT TË FONDIT DHE NË MËNYRË PROGRESIVE 57
TABELA 9: TË DHËNAT E GJENDJES SË FONDEVE NË BK SIPAS SEKTORIT TË ZHVILLIMIT TË KOLEKSIONEVE 58
TABELA 10: TË DHËNA INVENTARIALE 59
TABELA 11: (LËVIZJET E FONDEVE) VITI 2020 63
TABELA 12:TABELA PËRMBLEDHËSE E MATERIALEVE BIBLIOTEKARE TË KONTAMINUAR/INFEKTUARA 63
TABELA 13: TABELA PËRMBLEDHËSE E MATERIALEVE BIBLIOTEKARE TË DJEGURA TËRËSISHT NGA ZJARRI 63
TABELA 14: TABELA NË TOTAL TË HUMBURA (DJEGIE DHE KONTAMINIM/INFEKTIMI) 63
TABELA 15: TABELA E NJËSIVE TË SPASTRUARA TË LITERATURËS RUSE-SOVJETIKE 64
TABELA 16:TABELA E VLERAVE TOTALE TË NJËSIVE TË SPASTRUARA TË LITERATURËS RUSE-SOVJETIKE 65
TABELA 17: TABELA INVENTARIALE PËRMBLEDHËSE 66
TABELA 18: KRAHASIM MES GJENDJES AKTUALE DHE STANDARDEVE TEKNIKO-PROFESIONALE NË NJË PERSPEKTIVË AFATGJATË (50 VJEÇARE) 70
TABELA 19: KRAHASUESE MES GJENDJES AKTUALE DHE STANDARDEVE TEKNIKO-PROFESIONALE NË NJË PERSPEKTIVË AFATMESME (25 VJEÇARE) 71
TABELA 20: FONDET PËR SHPENZIMET BUXHETORE / KAPITALE PËR VITET 2018, 2019 DHE 2020 78
TABELA 21: BUXHETI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE PËR VITET 2018-2020 NË ARTIKULLIN 602 (SHPENZIME OPERATIVE) 80
TABELA 22: PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR INVESTIME (RIKONSTRUKSIONE, PAJISJE, PROJEKTE) PËR VITET 2018 ï 2020 82
TABELA 23: PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR INVESTIME (RIKONSTRUKSIONE, PAJISJE, PROJEKTE) PËR VITET 2019 ï 2021 82
TABELA 24: PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR INVESTIME (RIKONSTRUKSIONE, PAJISJE, PROJEKTE) PËR VITET 2020 ï 2022 83
TABELA 25: TË ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHËRBIMET NDAJ INDIVIDËVE TË NDRYSHËM 84
TABELA 26: TABELA E BOTIMEVE TË FINANCUARA NGA KUVENDI I SHQIPËRISË DHE NGA BK E KOSOVËS 85
TABELA 27: STRUKTURA E SEKTORIT TË BIBLIOGRAFISË SIPAS URDHRIT TË KRYEMINISTRIT NR.139, DATË 28.03.2014 90
TABELA 28: STRUKTURA E SEKTORIT TË BIBLIOGRAFISË SIPAS URDHRIT TË KRYEMINISTRIT NR. 122, DATË 17.09.2019 91
TABELA 29: TREGUESIT NË LIDHJE ME PËRDORIMIN ON-LINE TË MATERIALEVE TË NDRYSHME 93
TABELA 30: MATERIALE BIBLIOTEKARE PËR TõU DIGJITUAR DHE TË DIGJITUAR DERI NË VITIN 2020 95
TABELA 31: PËRQINDJA E DIGJITIMIT 97
TABELA 32-33: ORGANIKA E SEKTORIT ALBANO-BALKANOLOGJIK 98
TABELA 34: AKTIVITETI I KËSHILLIT SHKENCOR 101
TABELA 35-36: ORGANIKA E SEKTORIT TË IT 103.104
TABELA 37: TË DHËNAT TOTALE TË REGJISTRIMIT INFORMATIK 104
TABELA 38: TË DHËNAT PËR STATISTIKAT PËR AKSESIN ONLINE NË FAQEN ZYRTARE TË BK 110
TABELA 39: TABELA E TRAJNIMEVE TË SPECIALISTËVE TË BK-SË 113

LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MK	Ministria e Kulturës
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit (**I**nternational **O**rganization of **S**upreme **A**udit **I**nstitutions)
EUROSAI	Organizata Europianee Institucionevetë Larta të Auditimit (**Eur**opean **O**rganization of **S**upreme **A**udit **I**nstitutions)
BKSH	Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
IFLA	Federata Ndërkombëtare e Institucioneve dhe Shoqatave Bibliotekare (**I**nternational **F**ederation of **L**ibrary **A**ssociations and Institutions)
CENL	Këshilli i Bibliotekave Kombëtare Europiane (**C**ouncil of **E**uropian **N**ational **L**ibraries)
LIBER	Lidhja Europiane e Bibliotekave Shkencore (**Li**gue des **B**ibliothèques **E**uropéennes de **R**echerche
ËDL	BibliotekaDigjitaleBotërore (**Ë**orld **D**igital **L**ibrary)
ISBD	Standardi Ndërkombëtari Përshkrimit Bibliografik (**I**nternational **S**tandard **B**ibliographic **D**escription)
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (**I**nternational **O**rganization for **S**tandardization)
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (**U**nited **N**ations **E**ducational, **S**cientific and **C**ultural **O**rganization).
SK	Strategjia Kombëtare
Material ose Njësia bibliotekare	Libër, periodik, dorëshkrim, antikuar, hartë, libër i huaj, CD, material filmik, etj. Ka përmasa të ndryshme e për rrjedhojë zë një volum të ndryshëm në m^3.
Fondi arkivuesi Bibliotekës Kombëtare	Përbëhet nga fondi arkivues i librit, periodikut e disertacioneve
Fondi arkivues i vlerave të rralla	Përbëhet nga fondi i arkivit të botimeve shqip, fondi antikuarit, Fondi i dorëshkrimeve, fondi i hartave, si dhe fondi i albano-balkanologjisë.

1.PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre. Rrjeti kombëtar bibliotekar përbëhet nga tërësia e bibliotekave të Republikës së Shqipërisë dhe funksionon në bashkëpunim me rrjetin e arkivave dhe atë të muzeve, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo shtetas në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga raca, mosha, seksi, kombësia, formimi arsimor e kulturor, gjendja sociale, bindjet politike dhe përkatësia fetare ka të drejtën e shërbimit bibliotekar. Shteti garanton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dokumentare sipas ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat" dhe ligjit nr.9048, datë 07.04.2003 "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore", ndryshuar me Ligjin nr. 27, datë 17.05.2018 òPër mbrojtjen e trashëgimisë kulturoreò si dhe sipas konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat ai është palë. Ministria e Kulturës harton dhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar.Kanë kaluar 100 vjet që nga themelimi i Bibliotekës Kombëtare, një prej institucioneve kulturore më të rëndësishme të Shqipërisë. Një nga ato institucione që të lidhte me botën, edhe atëherë kur shqiptarët ishin tërësisht të izoluar. Si institucioni i pari shtetëror, publik dhe laik në fushën e kulturës, Biblioteka Kombëtare u themelua më 10 Korrik 1920 nën drejtimin e prof. Mati Logorecit, i caktuar në atë kohë nga Ministria e Arsimit. Në këtë rrugëtim të gjatë, gati shekullor, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë u shndërrua në burimin kryesor të dijes për të gjithë shqiptarët. Si qendra e vetme arkivore për botimet shqip, BKSH ruan thesarin kulturor të shkruar të kombit tonë. Vetëm një fond i vogël prej 3 mijë librash të Bibliotekës së ñKomisisë letrare shqipeò dhe të shoqërisë ñVllazniaò shërbeu në vitin 1920 si bërthama për krijimin dhe themelimin e Bibliotekës Kombëtare, për të arritur 95 vjet më pas në një fond prej 1.1 milion njësish, duke përfaqësuar kështu arkivin dhe thesarin më të pasur të kulturës së kombit shqiptar. Sot, BKSH është jo vetëm një institucion arkivor që ruan dëshminë dhe trashëgiminë e shkruar, por mbi të gjitha, një dritare gjithnjë e hapur drejt dijes, një nxitje për të shkuar në botën e magjishme të librit, të studimit dhe nxënies. Në ditët e sotme, kur zhvillimi marramendës i teknologjisë të mundëson aksesin e shpejtë në informacion, kurdo dhe kudo, Biblioteka Kombëtare mbetet një burim i pashtershëm informacioni i strukturuar dhe i sigurt, gjithmonë e gatshme për tôi shërbyer lexuesit dhe për të lehtësuar qasjen në informacion. Shkolla e Kombëtare e Bibliotekonomisë funksionon në Bibliotekën Kombëtare që nga viti 1969. Vitet ô90 sollën mundësi ndryshimi edhe në politikat e BKSH-së. Tani, nga modeli i bibliotekave të Evropës Lindore, me kufizime të skajshme në sigurimin e informacionit dhe shfrytëzimin e disa kategorive të literaturës, ajo kaloi në heqjen e barrierave kufizuese të kësaj natyre, duke shkuar drejt lirisë së plotë të informacionit për përdoruesit. Thesari më i çmuar, jo vetëm për Bibliotekën Kombëtare, por për të gjithë kombin dhe kulturën shqiptare, është koleksioni i antikuarëve dhe inkunabulat. Koleksioni i antikuarëve përbën një fond të posaçëm, shumë të rëndësishëm, jo aq për nga numri i vëllimeve sesa nga përmbajtja e tij. Përmban 2491 vepra të rralla të botuara në shekujt XV-XVIII, përfshirë edhe veprat e para në gjuhën shqipe të Gjon Buzukut, PjetërBudit, PjetërBogdanit, Frang Bardhit dhe të JulVaribobës, si dhe veprat në latinisht të humanistëve shqiptarë Marin Barleti, MarinBeçikemi dhe Dhimitër Frangu. Pjesë e këtij koleksioni janë edhe botimet e Voskopojës që i takojnë shek. XVII-XVIII, si dhe 9 inkunabula.Po kaq i rëndësishëm është edhe fondi i dorëshkrimeve, rreth 1199 njësi, ku përfshihen kryesisht dorëshkrime në gjuhët orientale (arabisht, osmanishte dhe persisht). Të një rëndësie të veçantë janë edhe munsheatet për veprimtarinë e Ali Pashë Tepelenës e të Mustafa Pashë Bushatit, për historinë e qyteteve të Tiranës e të Shkodrës etj. Prej vitit 1959 përgatitet dhe publikohet Bibliografia Kombëtare e Librit që botohet në Shqipëri, ku regjistrohen të gjitha materialet e botuara në formë libri, të cilat sigurohen përmes ekzemplarit të detyruar. Në epokën

digjitale, ku mbizotëron Interneti, ëëë (ëorldëideëeb), e-book, e-reader, Facebook, Twitter, Instagram, Smartphone-t, dhe aksesi i shpejtë dhe i menjëhershëm në informacion, kudo dhe kurdo, ñqëndrimi onlineò është mënyrë jetese në mbarë globin. Në këtë rrjedhë të furishme ndryshimesh teknologjike, por edhe ñmendësishò, Biblioteka Kombëtare nuk mund të mbetej pas. Aktualisht janë digjituar176 antikuarë; 234 dorëshkrime; koleksioni prej 79 hartash të rralla; 156 koleksionetë plota të periodikëve të rëndësishëm të historisë së shtypit shqiptar, si ñAlbaniaò, ñLEKAò, ñHylli i Dritësò dhe ñDituriaò.

*Në vitin 1994, në Bibliotekën Kombëtare filloi katalogimi në një sistem të automatizuar, përmes përpunimit dhe regjistrimit elektronik të gjithë fondit të saj arkivor. Shfrytëzimi i kërkimit elektronik, përmes Katalogut elektronik (OPAC), ka lehtësuar rrënjësisht aksesin në informacion. Prej 10 vitesh, Biblioteka Kombëtare, përmes faqes së saj zyrtare (ëëë.bksh.al), ofron një sërë shërbimesh të rëndësishme on-line si: Katalogët On-line, Katalogët e Digjituar, Biblioteka Dixhitale, e-Bibliografi etj., duke pasur vit pas viti rritje shumë të shpejtë të frekuentuesve të saj.

Nuk mund të flitet më për një rol dhe funksion ñtradicionalò të bibliotekave, jo se kjo mënyrë është *"shuar"* apo harruar, por bibliotekat dhe bibliotekarët po kërkojnë dhe po krijojnë rrugë të reja për të ndihmuar dhe orientuar publikun drejt informacionit të shpejtë dhe të saktë.

Në epokën digjitale, në Bibliotekë më mirë se kudo, publiku mund të marrë një informacion të shpejtë, të detajuar dhe mbi të gjitha të sigurt, si për tëi kujtuar njerëzve se sa gjëra fantastike gjenden në Bibliotekë, duke iu dhënë atyre një arsye të fuqishme për ta vizituar dhe frekuentuar atë. Ato duhet të funksionojnë në mënyrë të tillë që të reflektojnë funksionet e shërbimit bibliotekar, të sigurojnë një menaxhim efektiv për të realizuar përdorim sa më të mirë të mjediseve e mjeteve bibliotekare për të gjithë komunitetin. Biblioteka ndihmon në krijimin dhe mbajtjen e një shoqërie të mireinformuar, ndihmon njerëzit në pasurimin e zhvillimin e jetës së tyre dhe komunitetit ku ata jetojnë.Në datën 22 Tetor të vitit 2020, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë kremtoi 100-vjetorin e themelimit të saj. Me këtë rast, në ambientet e Kryeministrisë, BKSH në bashkëpunim me Qendrën për hapje dhe Dialog (COD), organizoi ekspozitën ñVerbaVolant, ScriptaManent-Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisëò.

1.2.RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Auditimi në përgjithësi ka të bëjë me ekzaminimin sistematik dhe të pavarur të dokumentacionit tërësor të një institucioni, ndërsa auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efiçiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm.

KLSH, nëpërmjet auditimeve, bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj. Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe EUROSAI, të cilat gjejnë pasqyrim në ***Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022***[1] dhe në Manualin e Auditimit tëPerformancës, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr.78, datë 30.06.2020.

Me shtimin e zhvillimeve të reja të cilat sjellin me vete edhe risqe të reja, auditimi i performancës sa vjen edhe bëhet më i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesit publik. Për këtë, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjithmonë e më shumë po vendos theksin në rritjen e numrit dhe të cilësisë të auditimeve, veçanërisht atyre të performancës. KLSH është në linjë me konkluzionet dhe rekomandimet e rezolutave dhe kongreseve të INTOSAI-t për një qasje gjithëpërfshirëse drejt auditimeve të performancës dhe inkurajim për auditime të përbashkëta dhe për një shkëmbim më intensiv të njohurive.

[1] *KLSH: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022, fq. 37.*

Ky auditim ka në fokus efektivitetin e aktiviteteve të Bibliotekës Kombëtare, grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe vënien në dispozicion të përdoruesve, koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

*Nëpërmjet këtij auditimi, KLSH synon të vlerësojëperformancën eveprimtarisë sëBibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) e cila realizohet nëpërmjet:

a) përpunimit standard të materialeve bibliotekare;

b) përgatitjes dhe shpërndarjes së informacionit bibliotekar-bibliografik;

c) krijimit dhe mirëmbajtjes së katalogëve përmbledhës të pasurisë bibliotekare kombëtare dhe asaj të huaj;

ç) shkëmbimit dhe huazimit ndër bibliotekar.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, ka për kompetencë auditimin me qëllim mbrojtjen e interesave publike, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH ka ndërmarrëauditimin e performancës me temë ñEfektiviteti i aktivitetit tëBibliotekës Kombëtareò, kjo edhe me rastin e 100-vjetorit të krijimit të saj, nëpërmjet këtij auditimi, i cili përfshin një periudhë tre-vjeçare (01.01.2018-31.12.2020) dhe shqyrton politikat dhe strategjinë, kuadrin ligjor dhe rregullator, eksperiencat bashkëkohore, strukturat përgjegjëse, si dhe masat e ndërmarra për të menaxhuar veprimtarinë dhe performancën e Bibliotekës Kombëtare, synojmë të japim rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit të shërbimit bibliotekar e veçanërisht të Bibliotekës Kombëtare, e cila ka të bëjë me arkivimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore, mbështetjen e leximit dhe të vetë-edukimit të qytetarëve. Biblioteka Kombëtare, si institucioni kryesor i bibliotekave në Republikën e Shqipërisë, e cila luan dhe rolin e një biblioteke publike përqytetin e Tiranës, përveç të tjerash, ka si detyrë kryesore shërbimin direkt ndaj përdoruesve nëpërmjet koleksioneve të veta (libra,dorëshkrime,periodikë, harta, etj.), informimit të tyre me mjete elektronike, organizimit të veprimtarive të ndryshme informuese në bashkëpunim dheme institucione e organizma të tjera, si:ekspozita, promovime, konferenca shkencore, etj., për përmbushjen e rolit parësor të saj: *plotësimin e nevojave bibliotekare dhe informuese të komunitetit të cilit i shërben.*

1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË

KLSH bazuar në ligjin e tij organik ka kryer auditimperformance në vitin 2014, në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë si dhe në 11 institucione të tjera të përfshira në këtë auditim (bibliotekat publike dhe Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik , Tregtisë dhe Sipërmarrjes-MZHETS) me nr.prot.100/26, datë 26.12.2014 dhe me temë ñInfrastruktura bibliotekare kombëtare në shërbim të librit dhe lexuesitò

Ngaauditimi i ushtruar është konkluduar se mos-hartimi i strategjisë kombëtare të bibliotekave dhe Bibliotekës Kombëtare ka sjellë mungesën e objektivave për mbarëvajtjen e tyre si qendra të dijes, kulturës dhe trashëgimisë kombëtare me pasojë stanjacionin dhe regresin (mos-zhvillimin dhe lënien pas dore) e bibliotekave në përgjithësi dhe Bibliotekës Kombëtare si institucioni kryesor i kësaj fushe.

Mesazhi i auditimit të kryer ishte :

"Biblioteka Kombëtare dhe Rrjeti Bibliotekar Kombëtar, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe pushtetin vendor, të krijojnë një qasje të re në vlerësim të librit dhe shërbimit qytetar, me synim ruajtjen e kulturës kombëtare dhe rritjen e vetë-edukimit të shoqërisë".

ñEfektiviteti i aktivitetit të Bibliotekës Kombëtareò është auditimi i 2-të, (i dytë) i performancës i fokusuar në problematikën e rëndësishme dhe shqetësuese që ky institucion ka kryesisht në mungesën e një statusi ligjor pronësie, në infrastrukturë, në rrezikun që godina e vjetër paraqet: si në rënien e mundshme të zjarrit apo përmbytjeve, gjë që do të sillte një katastrofë në humbjen e gjithë pasurisë kulturore të trashëguar në shekuj.

2.2 SUBJEKTE NËN AUDITIM

2.1 HYRJE NË SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Rrjeti kombëtar bibliotekar përbëhet nga tërësia e bibliotekave të Republikës së Shqipërisë dhe funksionon në bashkëpunim me rrjetin e arkivave dhe atë të muzeve, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ministria e Kulturës harton dhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar. Ministria e Kulturës orienton dhe mbikëqyr veprimtarinë profesionale në të gjithë rrjetin bibliotekar të vendit. **Subjekt i këtij auditimi do të jetë vetëm Biblioteka Kombëtare e Republikës së Shqipërisë.**

BKSH kryen detyrat funksionale në mbështetje të nenit 27 të Ligjit nr.8576, datë 03.02.2000òPër bibliotekat nëRepublikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, dhe statutin e BKSH-së, miratuar nga Ministri i Kulturës, me nr.70, datë 13.02.2015.Ajo zhvillon veprimtarinë e saj profesionale në përputhje me dokumentet e organizatave ndërkombëtare në fushën e bibliotekave dhe të informacionit, ku ajo aderon si IFLA, CENL,UNESCO etj.[2]

*Për vitin 2018, BK ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Ligjin e Buxhetit nr. 109/2017 për buxhetin e vitit 2018. Në fillim të vitit 2018, numri i punonjësve ka qenë 100 persona dhe është ndryshuar sipas Urdhrit nr.108, datë 31.07.2018, me 97 punonjës.

*Për vitin 2019, BK ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Ligjin e Buxhetit 99/2018 për buxhetin e vitit 2019. Në fillim të vitit 2019,numri i punonjësve ka qenë 97 dhe është ndryshuar sipas Urdhrit nr. 122 datë 17.09.2019, të Këshillit te Ministrave ñMbi organikën e BKò duke ndryshuar në 92 persona.

Sipas rregullores së miratuar me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010 nga ish drejtori i BKSH-së, /neni 3, Struktura e BK ka qenë e përbërë nga Drejtoria e Bibliotekës dhe 15 sektorë. Drejtimi i Institucionit është kryer nga Drejtoria. Në nenin 5 të rregullores përshkruhen detyrat dhe funksionet që ka Drejtori dhe Zv. Drejtori i Drejtorisë.Në pikën 3 citohet se:

Drejtori planifikon dhe organizon veprimtarinë e institucionit mbështetur e ndihmuar nga Këshilli Administrativ dhe Këshilli Shkencor i BK.

Këshilli Shkencor i BK, sipas nenit 16 të Statutit të BK, miratuar me Urdhër nr.70, datë 13.02.2015, funksionon si organ këshillimor i Drejtorit të BK dhe përbëhet prej 7 anëtarësh. Përbërja e Këshillit Shkencor miratohet nga Ministri i Kulturës me propozim të BK. Mbledhja e Këshillit thirret dhe drejtohet nga Titullari i saj dhe mblidhet jo më pak se 4 herë në vit. Këshillit Shkencor shqyrton dhe jep mendime për :

a)Politikat e zhvillimit të BK, programet dhe planet e veprimtarisë studimore dhe vlerësimin e rezultateve të tyre.

b)Veprimtaritë kryesore të BK-së

c)Çështje të tjera që lidhen me aktivitetin e BK-së.

*Sipas nenit 6, të rregullores së miratuar me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010, Këshilli Administrativ i Bibliotekës thirret nga drejtori dhe përbëhet nga përgjegjësit e sektorëve. Funksioni i këtij këshilli është shqyrtimi i çështjeve të ndryshme, që kanë rëndësi primare në aktivitetin e BK-së. Gjithashtu sektorët e BK-së zhvillojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në rregulloret e sektorëve përkatës të miratuara nga Drejtori.

- [2]***IFLA*** *(Internacional Federation of Library Association and Institutions), CENL (Konference of European National Libraries)*
- ***CENL:*** *institucion i bibliotekave kombëtare vendet e të cilave janë anëtarësuar në Këshillin e Evropës, që synon të forcojë dhe rrisë rolin e bibliotekave kombëtare në Evropë; të krijojë dhe të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet rrjetit të bibliotekave kombëtare të Evropës në epokën digjitale; të ofrojë dhe lehtësojë qasjen në koleksionet e bibliotekave kombëtare të Evropës.*

*Nga auditimi për funksionimin e strukturës së BK, konstatohet se për periudhën në auditim 2018-2019-2020, BK është organizuar dhe funksionon sipas drejtorive përmbledhur në organigramën e mëposhtme:



* Për periudhën në auditim 2018-2019-2020, BK është organizuar dhe funksionon me 15 sektorë dhe një Drejtor.
Për vitin 2018, BKSH, ka funksionuar sipas Urdhrit nr. 139, datë 28.03.2014 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Bibliotekës Kombëtareò, të Kryeministrit (plani 100 punonjës, fakti 99 punonjës).
Pra ka pasur vetëm një vend vakant në sektorin e Katalogimit Retrospektiv Elektronik, në pozicionin e punës "Klasifikator". (Sektor, i cili nuk ekziston më që pas organigramës së shtatorit 2019).
*Struktura e ndryshuar sipas Urdhrit nr.108, datë 31.07.2018,të Kryeministrit ka ulur numrin total të punonjësve nga 100 në 96 punonjës dhe konkretisht ndryshimi rrjedh prej largimit të sektorit të informatikës dhe teknologjive të reja pranë AKSH-it.
Struktura e fundit e ndryshuar sipas Urdhrit nr. 122, datë 17.09.2019, ka reduktuar numrin e punonjësve në 92, dhe konkretisht ndryshimet kanë qenë në :

1. Sektori i Katalogimit Retrospektiv Elektronik, me ardhjen e organigramës së re të 2019-ës, u shkri, duke u bërë pjesë e Sektorit të Albano-Balkanologjisë.
2. Sektori i Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtare të Standardizuar (ISBN,ISSN, ISMN), me ardhjen e organigramës së re të 2019-ës u shkri, duke u bërë pjesë e Sektorit të Katalogimit. Tani, quhet Zyra e Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtarë të Standardizuar (ISBN,ISSN,ISMN).

Direktivat e BE-së, rekomandimet e Komisionit Evropian, të cilët në objektivat kryesorë në strategjitë e tyre vitet e fundit kanë digjitimin e trashëgimisë kulturore evropiane dhe qasjen më të madhe në të, për të cilën është duke u punuar në BKSH me intensitet për periudhën koherente.
E parë në këtë këndvështrim, zhvillimi i strategjisë digjitale institucionale ka shënuar disa arritje në drejtim të procesit dinamik të digjitimit (revistave, antikuarëve, doreshkrimeve, librave) dhe qasjes gjithnjë e më të madhe në trashëgiminë e shkruar kombëtare e më gjerë brenda dhe jashtë mureve të bibliotekës, me mënyra të ndryshme leximi e shfletimi në koleksionet digjitale (në faqen e ëeb-it: www.bksh.al), e cila është mundësuar nga shtimi dhe rëndësia që i është dhënë stafit të punonjësve të Qendrës së Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar **(QDTSH).**
Ka ende shumë për të bërë në procesin e digjitimit të cilat më hollësisht do të trajtohen në zhvillimin e pyetjeve përgjatë materialit.

2.2.BAZA LIGJORE QË RREGULLON ÇËSHTJEN NË AUDITIM

BKSH funksiononsipas:

- Ligjit nr.8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikëne Shqipërisëò, i ndryshuar,
- Ligjit nr.9217, datë 8.4.2004 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò;
- Ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 ñPër trashëgiminë kulturore dhe muzetëò.
- Ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò.
- Ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 ñPër bazat e të dhënave shtetëroreò.
- Ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- RregulloressëBrendshmetëmiratuarngaish-Drejtori i BK-së me urdhërnr. 136, datë 15.09.2010 ñPërorganizimindhefunksionimin e BibliotekësKombëtareò.
- UrdhrittëKryeministritnr. 139, datë 28.03.2014 ñMbimiratimin e strukturës dheorganikëssë BKò.
- Urdhritnr. 122, datë 17.09.2019, ñMbimiratimin e strukturësdheorganikëssë BK.
- VKM nr. 945, datë 2.11.2012 Për miratimin e rregullores ñAdministrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetëroreò.

- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò të ndryshuar.
- VKM nr. 134, datë 7.3.2018 ñPër krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar DATA BKSH.

2.3 RËNDËSIA E PRODUKTEVE TË SUBJEKTIT

Në Bibliotekën Kombëtare, fondi i arkivit të botimeve shqip, i antikuarëve, i dorëshkrimeve, hartave, si dhe fondi albano-balkanologjik përbëjnë pasuri me vlera të mëdha për thesarin e kulturës kombëtare shqiptare e për rrjedhim të kulturës evropiane.

*Në vitin 1994, në Bibliotekën Kombëtare filloi katalogimi në një sistem të automatizuar, përmes përpunimit dhe regjistrimit elektronik të gjithë fondit të saj arkivor. Shfrytëzimi i kërkimit elektronik, përmes Katalogut elektronik (OPAC), ka lehtësuar rrënjësisht aksesin në informacion. Prej 10 vitesh, Biblioteka Kombëtare, përmes faqes së saj zyrtare (www.bksh.al), ofron një sërë shërbimesh të rëndësishme on-line si: Katalogët on-line, Katalogët e Digjituar, Biblioteka Dixhitale, e-Bibliografi etj., duke pasur vit pas viti rritje shumë të shpejtë të frekuentuesve të saj.

-Shumë lehtë i aksesueshëm për përdoruesin është edhe fondi elektronik i disa prej bibliografive më të rëndësishme të BKSH-së përmes shërbimit on-line, ñe-Bibliografiò. Nuk mund të flitet më për një rol dhe funksion ñtradicionalò të bibliotekave, jo se kjo mënyrë është *"shuar"* apo harruar, por bibliotekat dhe bibliotekarët po kërkojnë dhe po krijojnë rrugë të reja për të ndihmuar dhe orientuar publikun drejt informacionit të shpejtë dhe të saktë.

Në epokën digjitale, në Bibliotekë më mirë se kudo, publiku mund të marrë një informacion të shpejtë, të detajuar dhe mbi të gjitha të sigurt, si për tôi kujtuar njerëzve se sa gjëra fantastike gjenden në Bibliotekë, duke iu dhënë atyre një arsye të fuqishme për ta vizituar dhe frekuentuar atë.

-Biblioteka Kombëtare Shqiptare , si institucioni kryesor i bibliotekave në Republikën e Shqipërisë, e cila luan dhe rolin e një biblioteke publike për qytetin e Tiranës, përveç të tjerash, ka si detyrë kryesore: shërbimin direkt ndaj përdoruesve nëpërmjet koleksioneve të veta(libra,dorëshkrime,periodikë, harta, etj.), informimit të tyre me mjete elektronike, organizimit të veprimtarive të ndryshme informuese në bashkëpunim dhe me institucione e organizma të tjera, si:ekspozita, promovime, konferenca shkencore, etj., për përmbushjen e rolit parësor të saj: *plotësimin e nevojave bibliotekare dhe informuese të komunitetit të cilit i shërben.*

<u>Disa nga rezultatet e arritura nga BKSH, sipas objektivave dhe planeve strategjikë vjetorë, për periudhën në auditim janë:</u>

<u>Aplikimi i teknologjive të reja (2018)</u>

A. Paketa e kartelave informative përshërbimet e ofruara nga Biblioteka Kombëtare e ShqipërisënëpërmjetPlatformës IPSD[3] për shërbimet publike në kuadër të zbatimit të VKM-së Nr. 648, datë 31.10.2018,"Për Kartela Informative për ShërbimetPublike që iu ofrohen qytetarëve" ADISA[4]



[3] *Improve Citizen – Centric Public Service Delivery*
[4] *Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara*

B. Teknologji e re leximi të materialeve bibliotekare:

C. Këndi Digjital i Leximit

Në kuadër të rregullimit të veprimtarisë në shërbim të përdoruesve/anëtarëve të Bibliotekës Kombëtare në mjediset e saj për përdoruesit nëpërmjet ngritjes së ñKëndit Digjital të Leximitò (prej 2017) është mundësuar shfletimi i koleksioneve të rralla, bibliografive si dhe revistave e librave të botuara deri në vitin 1944 të përpunuara në format elektronik dhe me elementë kërkimi në tekst. Në një rubrikë të veçantë në ëebsite-in e BKSH-së të titulluar ñKoleksionet në format elektronikò përdoruesit i ofrohet lista, si dhe një link për plotësimin online të kërkesës duke ia vënë në dispozicion materialin e kërkuar 24 orë mbas parashtrimit të kërkesës.

Fletë-palosje e mënyrës së shërbimit të koleksioneve në format elektronik





D. Fletë-kërkesa elektronike nëpërmjet website-it të BKSH-së (përdoruesit/lexuesit)

Prej vitit 2018 përdoruesi kërkon materialin edhe në distancë nëpërmjet linkut *fletëkërkesa elektronike*



në faqen zyrtare të BKSH-së (ëëë.bksh.al). Materiali i kërkuar jô u vihet në dispozicion 24 orë mbas parashtrimit të kërkesës me tôu paraqitur në pikën e shërbimit.

E. Kindle, e-reader, tablet

F. Baza e të dhënave e BKSH:

OPAC (katalogu elektronik) nëpërmjetëebsite-it të BKSH-së:

Shtimi i rekordeve/regjistrimeve nëbazën e tëdhënave (OPAC)
Kërkim on line për libra, artikuj, harta, disertacione, materiale audio-vizuale
Kërkim i thjeshtë (me 11 elementëkërkimi) dhe kërkim i kombinuar

G. **G. Brenda mjediseve: Pika e informacionit**

H. **H. Jashtë mjediseve:** Pasurimin e rubrikës ñe-bibliografiò nëpërmjet ëebsite-it të BKSH-së *Katalogët e digjituar*nëpërmjetëebsite-it tëBKSH-së:

***Qasje në trashëgiminë kulturore kombëtare:**
Nëkoleksione digjitale: Biblioteka Digjitale e-Albanica (harta, antikuarë, periodikë, dorëshkrime, libra) brenda e jashtë mjediseve;
Portale ndërkombëtare online: Biblioteka Evropiane/EUROPEANA, Biblioteka Digjitale Botërore (BKSHpartnerë nëinfrastrukturën globale të informacionit)
Shërbim elektronik
Pyet bibliotekarin
Internet
Biblioteka në rrjete sociale:
Përgjigje e shpejtë e pyetjeve dhe kërkesave qëvijnë në inbox.
Prezantim/promovim i të gjitha veprimtarive tëBKSH ï së.
Shërbimi ndaj botuesve:
Shërbim elektronik ISBN-ja (Pajisje dhe anulim)

***Botime elektronike**
2018
Musine Kokalari ñVetëdija e shkrimit dhe e qëndresësò
https://www.bksh.al/bksh/e-Botime/MusineKokalari_vetedija_e_shkrimit_dhe_e_qendreses.pdf
2019
Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës ñ*Dituria"*
https://www.bksh.al/bksh/e-Botime/lumoskendo_diturija.pdf
Mars 2020
Shërbim bibliotekar online nëpërmjet portalit e-albania:
Aplikim online për anëtarësim në BKSH (formular elektronik);
Aplikim online për huazim për lexim/rezervim të materialit (formular elektronik),
Rritja e pranisë së BKSH -së në rrjetet sociale (FB, INSTAGRAM)
Objektivi specifik: Zhvillimi i Bibliotekës Digjitale

1. Qasje gjithnjë e më e madhe në trashëgiminë e shkruar kombëtare kulturore e më gjerë jashtë mureve të bibliotekës
2. Qasje online në materialet digjitale:(265,133 faqe)
3. Qasje në kategori koleksionesh digjitale: antikuarë, dorëshkrime, revista, harta, libra;
4. Lexim e shfletim në koleksionet digjitale në mënyra të ndryshme: imazh, libër, galeri.
5. Sistemi digjital mundëson:

- Mbajtje shënimesh në çdo faqe
- Zgjedhje të pjesës së tekstit që i duhet përdoruesit
- Ruajtje të faqes kur ndalon leximin për tëu rikthyer pa humbur gjë
- Shfletim disa materialeve njëherësh
- Shpërndarje të materialeve automatikisht në rrjete sociale

Pamje grafike e faqeve të publikuara online



Shërbim i kufizuar për përdoruesit

Shërbimi i kufizuar për anëtarët e Bibliotekës Kombëtare lidhet jo vetëm me situatën e krijuar pas dy incidenteve të sipërpërmendura, (zjarrin dhe përmbytjen), por dhe me **krizën e theksuar të hapësirave për** depozitimin e fondeve (në tre katet e nëndheshme) të materialeve bibliotekare, si libra, revista, gazeta etj., (aktualisht për këtë qëllim sipërfaqja është 1,560 m² kur në fakt sipas perimetrave të sigurisë asaj i nevojitet një sipërfaqe prej rreth 12,000 m²: 8 herë më shumë).

Gjithashtu, prej vitit 2017 e në vijim, librat e rinj që vijnë në bibliotekë nuk përcillen në mjediset e hapësirave depozituese të materialeve bibliotekare, por janë vendosur në ambientet që më parë shërbenin për lexuesit.

Edhe kushtet e sigurisë në Bibliotekën Kombëtare, veçanërisht në sallat e fondeve (katet e nëndheshme) vazhdojnë të mos jenë plotësisht në përputhje me parametrat dhe normat teknike të përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në fushën e mbrojtjes nga zjarri.

Sipas Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë e Tiranës *"Për të pasur një aktivitet normal të bibliotekës si dhe nga rasti i mëparshëm i rënies së zjarrit duhen përmirësime të masave mbrojtëse kundra zjarrit dhe shpëtimit për vijimin e një aktiviteti normal të bibliotekës".* ***Kjo situatë mund të zgjidhet vetëm me ndërtimin e një biblioteke të re.***

2.4 PESHA NË BUXHET DHE PBB

Referuar Raporteve Vjetore të Bibliotekës Kombëtare, si institucion varësie i MK, rezulton se:

Biblioteka Kombëtare për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2020, është financuar me fonde buxhetore nga Ministria e Kulturës për vitin 2018 në shumën prej 102,459 mijë lekë ose 4,4 % të totalit të fondeve të MK, për vitin 2019 në shumën prej 99,011 mijë lekë ose 4,3% të totalit të fondeve të MK, dhe për vitin 2020 në shumën 99,894 mijë lekë ose 4% të totalit të fondeve të MK, fonde të cilat kanë pësuar ulje ndër vite pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të BKSH-së në PBA përkatëse për fonde për investime të kërkuara MK-së. .

Fondet për investime për Bibliotekën Kombëtare janë dhënë vetëm për vitin 2018 dhe për vitin 2020, si rezultat i dy fatkeqësive të ndodhura dhe konkretisht: zjarri dhe përmbytja në sallën P 300. Për këtë arsye jashtë planifikimit të buxhetit vjetor(pra jo sipas kërkesave ndër vite të PBA-së së BKSH-së) u alokuan fonde nga MK për rikonstruksione (punime elektrike, ndërtime, etj.) në Gusht të vitit 2018, dhe në Shtator tëvitit 2020).

Për vitin 2019 nuk janë dhënë fonde për investime pavarësisht kërkesave të vazhdueshme tëinstitucionit.

Si përfundim, Bibliotekës Kombëtare për periudhën objekt auditimi, fondet buxhetore nuk i janëakorduar në bazë të kërkesave të PBA drejtuar MK. Këto fonde kanë rezultuar në ulje nga viti 2018 e në vazhdim referuar akt-rakordimeve të fondeve buxhetore të mbajtura në fund të vitit me përfaqësuesit e Degës së Thesarit Tiranë, si dhe referuar mungesave në fonde për investime për rikonstruksion godine veçanërisht katet e nëndheshme të godinës dhe në blerje librash albanologjike.

Vlen të theksohet fakti, se me gjithë kërkesat e vazhdueshme të BK përdomosdoshmërinë e ndërtimit të një godine të re bashkëkohore nga ana e MK për vitet 2018,e në vazhdim nuk rezulton të jenë përcaktuarfonde buxhetorereferuar dheobjektivit të strategjisësëMK 2019-2025 për një projekt të ri godine me standarde bashkëkohore.
Godina ku zhvillon aktivitetin institucioni i BKSH-së, aktualisht rezulton pa status juridik të pronësisë.
Mungesa e fondeve buxhetore, veçanërisht të fondeve për investime ka sjellë mosfunksionim të sallave në dispozicionte lexuesve, të ambienteve ku mbahen librat e rrallë si antikuarë apo dorëshkrime të cilat ndodhen nëarka metalike jashtë standardeve të ruajtjes së tyre dhe në lagështi të ekspozuar ndaj zjarrit apo përmbytjeve.
Aneksi i Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare) po ri konstruktohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturësnë bazë të kontratës publike të shërbimit në datën 03.12.2020 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ñXò,ShPK, i përfaqësuar nga Sekretaria e Përgjithshme z.X dhe nga përfaqësuesi i operatorit nga Administratori z.X, në shumën prej 44,636,849 lekë me TVSh me afat përfundimi deri në Dhjetor të 2022.
Për sa më sipër po paraqesim sipas tabelës nr. 1, fondetbuxhetore në total të akorduara si për MK dhe BK dhe në veçanti fondet për investime të BK dhe ato të MK për periudhën objekt auditimi

Ministria e Kulturës/ Biblioteka Kombëtare
Fondet për shpenzimet buxhetore/kapitale për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Tabela nr.1 ***Në 000 / lekë***

Institucioni	Shpenzimet	Viti		
		2018	2019	2020
Ministria Kulturës	*Totali i fondeve i shpenzime kapitale*	*853,000*	*785,000*	*1,097,950*
	Totali i fondeve të shpenzimeve buxhetore	*2,282,153*	*2,275,687*	*2,526,331*
Biblioteka Kombëtare	*Totali i fondeve i shpenzimeve kapitale*	*1,956*	*- - -*	*2,400*
	Totali i fondeve të shpenzimeve buxhetore	*102,459*	*99,011*	*99,894*

Burimi: BK dhe MK, Përpunoi: grupi i Auditimit të KLSH-së

Për vitin 2018 janë dhënë fonde për rikonstruksion (punime elektrike, ndërtimi, mekanike të sallës P300 të cilat i përkasin kateve të nëndheshme të BK) në bazë të kërkesës së bërë nga BK me shkresë nr.382/39, datë 03.07.2018, aprovuar nga MK sipas shkresës nr.4601/3 prot., datë 15.08.2018, në shumën prej 400 mijë lekë (projekti për përmbytjen e ndodhur në datë 23.06.2018), dhe me nr.6183/3, prot. datë 23.08.2018 në shumën prej 2,002 mijë lekë për rikonstruksion pjesore të sallës P300 në fondin e BK i cili ndodhet nëkatet të nëndheshme të godinës.
Për vitin 2019 megjithëse janë kërkuar fonde për investime nga BK, sipas PBA me shkresë nr.prot. 431/1, datë 20.08.2018,në shumën prej 32,160 mijë lekë, rezulton që nga MK nuk janë akorduar fonde për investime për BK.
Për vitin 2020 janë kërkuar fonde për investime nga BK në bazë shkresës nr. 276/1, datë 18.04.2019 në vlerën 21,420 mijë lekë. Nga ana e MK janë alokuar fonde për investime sipas shkresës nr.3412/5 datë 03.09.2020 të MK në vlerën 1,200 mijë lekë dhe shkresës nr.2869/16 datë

16.07.2020, në shumën prej 1,200 mijë lekë, për rikonstruksionin e rrjetit elektrik në sallën P300 për eliminimin e pasojave të zjarrit të ndodhur më 15Mars 2017.

2.5 PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA

"Auditimi i performancës" vlerëson ekonomicitetin, efektivitetin dhe eficencën e veprimtarisë dhe përdorimit të fondeve nga njësia e sektorit publik në përmbushjen e objektivave.

"*Biblioteka Kombëtare*"Biblioteka Kombëtare është institucioni qendror që mbledh përpunon, ruan trashëgiminë e shkruar e botuar të kombit të tyre, duke e vënë në shërbim të përdoruesve. Është institucion depozitues i kopjes së detyruar.

"Efektivitet" është masa në të cilën arrihen objektivat ose përputhshmëria midis rezultatit të produktit dhe rezultatit social për një aktivitet të caktuar.

"Eficiencë" është raporti ndërmjet rezultateve të produktit dhe burimeve të përdorura për prodhimim e tij.

"Ekonomicitet" është minimizimi i kostos së burimeve publike të përdorura për kryerjen e veprimtarisë, pa cenuar cilësinë.

"Subjekt" përfshin individin, personin fizik, personin juridik.

Sistemi i digjitalizimit ALIS-Ka 6 module, qe janë të integruara me njëri-tjetrin, bazuar në ëeb.Bazuar në standarde ndërkombëtare MARC 21 (MARC ISO 2709), AACR2, ISBD, Z 39.50, UNICODE, ISO 639, ISO/DIS 25577, ISO 20775.

Moduli i katalogimit është moduli kryesor i sistemit, i cili mundëson krijimin dhe modifikimin e bazës së të dhënave të BKSH ï së, bazuar në standarde ndërkombëtare.

Moduli ipasurimit, funksiononmëvete, poredhei integruarnësistem.

- Funksionojnëtëkatër format e pasurimit (kopje e detyruar, dhuratë, blerje, shkëmbim).
- Kryenkontrollinparashikiminpërpasurimin me material tështypuradhe jo tështypurasidheburimetelektronike duke përfshirëtëgjithamaterialetbibliotekare, kryenkërkesë/Porosi, pranimin, anulim, dokumenthyrës, Raporte/Statistika.

Moduli i serialeve (periodikëve)iintegruarnësistem, bën të mundur krijimin e rregjistrimevepërgazetatdherevistat, regjistrimin e njësisë, kontrollin e qarkullimit, lidhjen e njësive, nxjerrjen e etiketave, kontrollin e numravetërinjqëdalin.

Moduli i huazimit i integruar në sistem, përmes të cilit kryhet regjistrimi i anëtarëve duke përdorur kredencialet e tyre unike.

Katalogu Online: Siguron publikimin online të bazës së të dhënave të BKSH duke mundësuar: metoda kërkimi (të thjeshtë dhe të avancuar) për të gjitha fushat përfshirë edhe kërkimin me anë të operatorëve, rezervimin e njësisë bibliotekare, selektimin, grupimin, citimin dhe printimin e të dhënave.

Standardet ndërkombëtare MARC 21 (MARC ISO 2709), AACR2, ISBD, Z 39.50, UNICODE, ISO 639, ISO/DIS 25577, ISO 2077

2.6 SKEMA E ANALIZËS SË PROGRAMIT



2.7 FEEDBACK-U I SUBJEKTIT NË FAZËN STUDIMORE

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit ka mbledhur të dhëna nga Drejtoria e Bibliotekës Kombëtare, stafi i saj. Nga takimi paraprak me drejtuesin e BKSH-së-, z.X u krijua një tablo më e qartë mbi ecurinë e aktivitetit të bibliotekës, risitë dhe problemet në performancën e saj.Subjekti ka vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, sipas rastit edhe në format elektronik, në përgjigje të kërkesave në formë pyetësori drejtuar Titullarit, Zv/Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare, z.X dhe përgjegjësve të sektorëve. Gjithashtu janë kryer intervista të vazhdueshme me përgjegjësit e sektorëve të BK, për sqarimin dhe mbledhjen e informacionit sa më korrekt për kryerjen e auditimit. Pyetësorët janë hartuar në përputhje me dispozitat e nenit 15, pika (dh) (e) të Ligjit 154/2014 ñPër Kontrollin e Lartë të Shtetitò. Subjekti nën auditim ka qenë i disponueshëm në garantimin e informacionit dhe dokumenteve të kërkuara, pavarësisht vështirësive që paraqet situata e rënduar e pandemisë Covid-19.

3.DETAJET E AUDITIMIT

3.1 VLERËSIMII RISQEVE TË AKTIVITETEVE TË SUBJEKTIT

Institucionet dhe organizatat janë vazhdimisht të ekspozuara ndaj faktorëve të mjedisit të jashtëm, të cilët mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në performancën e tyre. Një mjet analitik i cili mundëson identifikimin e faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe ndikimin që mund të kenë këta faktorë në veprimtarinë institucionale, është analiza SËOT.

Analiza SËOT paraqet fuqitë dhe dobësitë e institucionit që janë faktorë ñbrenda kontrollit menaxherialò, si dhe shanset dhe kërcënimet që janë faktorë ñjashtë kontrollit menaxherialò ose të klasifikuara si risqe nga faktorë të brendshëm dhe risqe nga faktorë të jashtëm.

Kur risqet vijnë nga faktorë të brendshëm, institucioni duhet të mbështetet në fuqitë dhe të minimizojë dobësitë, ndërsa kur risqet vijnë nga faktorë të jashtëm institucioni duhet të shfrytëzojë shanset dhe të shmangë kërcënimet.

Tabela nr.2. Analiza SËOT

	Fuqitë (S)	Dobësitë (Ë)
Faktorë të brendshëm	• Kuadri ligjor që parashikon administrimin dhe ruajtjen e Fondit të Bibliotekës Kombëtare. • Sistemi Informatik i BK-së. • Mungesa e hapësirës virtuale, • Plani Strategjik i BK 2016 ï 2021, etj.	• Struktura e BK, jo e plotë për të përmbushur detyrat funksionale. • Planet strategjikëdhe operacionale jo-SMART. • Mangësi në raportet inventariale. • Mospërditësimi i një rregulloreje të re të brendshme në menaxhimin dhe funksionimin e aktivitetit të BK-së, edhe me ndryshimin e strukturës organizative. • Mungesa e fondeve për investime nga MK, etj. • Mungesa e gjurmës së auditimit në procese të ndryshme specifike të BK dhe mosrakordim ndërmjet sektorëve zyrtarisht. • Mosfunksionim i Këshillit Shkencor dhe administrativ të BK bazuar në rregullore dhe statut.

	Shanset (O)	**Kërcënimet (T)**
Faktorë të jashtëm	• Asistenca e BE-së, • Praktika të mira ndërkombëtare, për Bibliotekat Kombëtare: Biblioteka Kombëtare Universitare e Kroacisë. • Standardet ndërkombëtare për të matur hapësirat e bibliotekave, mënyrën e arkivimit të librave si dhe mënyrën e përshkrimit bibliografik të materialeve bibliotekare.(IFLA[5])	• Ngjarje të jashtëzakonshme, si: tërmeti, pandemia, zjarri, përmbytja etj., • Mungesa e sigurisë së ruajtjeve të librave nga dëmtimet natyrore.

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH-së.

Në vijim të analizimit të risqeve për efektivitetin e aktivitetit të BK-së, nëpërmjet Analizës SËOT dhe klasifikimit të tyre në faktorë risku të mjedisit të jashtëm dhe të mjedisit të brendshëm, më poshtë është paraqitur klasifikimi i tyre në risk strategjik, financiar, juridik, taktik dhe operacional.

Tabela nr.3: Kategorizimi i riskut

Nr.	**Risku i Subjektit**	**Kategorizimi i riskut**	**Niveli i Riskut**
1	Plane strategjike dhe operacionale, jo-smart	Risk Strategjik	I Lartë
2	Pasurimi i koleksioneve bibliotekare me botime në gjuhë të huaj që përmbajnë informacion për Shqipërinë dhe përbëjnë koleksionin Albano-Balkanologjik.		I Mesëm
3	Hapësirat për depozitimin e materialeve bibliotekare në katet e nëndheshme .		I Lartë
4	Mungesa e investimeve në kushtet e ruajtjes së fondit të trashëgimisë kulturore kombëtare (mosplotësimi i standardeve ndërkombëtare).	Risk Financiar	I Mesëm
5	Mos kryerja e inventarëve në afatet kohore të fondit bibliotekar.		I Mesëm
6	Përdorimi i rregulloreve jo të përditësuara sipas strukturave të miratuara dhe të ndryshuara me VKM si dhe moszbatimi i Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, i MFK, në dokumentet brendshme për mirëfunksionimin e Institucionit..	Risk Rregullator dhe Juridik	I Mesëm
7	Pasaktësi nëRaportet menaxherialë të inventarizimit.	Risk Operacional	I Lartë
8	Moszbatimi i metodës së analizës së riskut në menaxhimin e Fondit të Bibliotekës Kombëtare.		I Mesëm

Përpunoi: Grupi i auditimit tëKLSH-së

3.2 OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Auditimi me temë ñEfektiviteti i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtareò synon të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv nëse burimet publike janë menaxhuar me përgjegjësi duke informuar publikun, Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Ministrinë e Kulturës, mbi

[5] *Internacional Federation of Library Association and Institutions*

efektivitetin e veprimtarisë së institucionit për menaxhimin e shërbimit bibliotekar sipas rregulloreve dhe ligjeve përkatëse me qëllim sigurimin e arkivimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kombëtare.

Auditimi me temë ñEfektiviteti i aktivitetit së Bibliotekës Kombëtareò është shtrirënë periudhën **2018–2020,** dhe synon të analizojë efektivitetin e sektorëve pjesë e strukturës sëBK-së, subjekt auditimi të cilët janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbarëvajtjen e BK-së, sipas Ligjit 8576, datë 03.02.2000ñPër Bibliotekën në RSHò, i ndryshuar si dhe statutit të BK-së , miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës, nr.70, datë 13.02.2015.
Për sa më lart, objektivi kryesor i këtij auditimi është vlerësimi iefektivitetit të sistemit të ngritur për menaxhimin e veprimtarisëbibliotekare përgjatë periudhës 2018-2020.

3.3 PYETJET E AUDITIMIT



3.4 FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Nisur nga pyetjet e ngritura më sipër nga grupi i auditimit, si dhe nga vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit, Auditimi me temë ñEfektiviteti i aktivitetittë Bibliotekës Kombëtareò i shtrirë në periudhën 2018ï 2020, ka analizuar:

ÅProblematikat në lidhje me hartimin e një strategjie kombëtare nga MK për veprimtarinë e BK-së, në zbatim të nenit 11 të Ligjit 8576, datë 03.02.2000. i ndryshuar ñPër Bibliotekat në RSHò si dhe draft strategjinë e hartuar nga BK për periudhën 2016-2021, në zbatim të kërkesave të nenit 27 të ligjit 8576, datë 03.02.2000. i ndryshuar ñPër Bibliotekat në RSHò dhe statutit të BKSH-së, miratuar nga Ministri i Kulturës nr.70, datë 13.02.2015.

ÅFinancimineveprimtarisë së BKSH-së nga MK dhe ndikiminetyre në zbatimin dhe realizimin e politikave të zhvillimit e shërbimit bibliotekar me qëllim ruajtjen dhe arkivimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.

ÅAktivitetineKëshillit Shkencor dhe administrativ tëBKSH në lidhje me politikat e veprimtarisë së BKSH-së.
ÅÇështjene pronësisë së ambienteve ku zhvillohet veprimtaria e BKSH-së,
ÅInfrastrukturëne ndërtesës së BKSH, hapësirat dhe ambientet në të cilat është vendosur Fondi i BKSH-së(pra materialet me vlerë të rrallë dhe trashëgimi kulturore) etj. dhe ndikimin në ruajtjen e koleksioneve të rralla e botimeve nga entet botuese brenda dhe jashtë vendit.
ÅMungesëne kuadrit ligjor specifik që parashikon administrimin dhe ruajtjen të Fondit të BKSH-së.
ÅRaportet inventariale të kryera në BKSH, nga struktura përkatëse deri në miratimin e tyre.
ÅMos-përditësimineRregullores aktuale, miratuar me Urdhër nr136, datë 15.09.2010 nga ishTitullari i Institucionit të BK ñPër organizimin dhe funksionimin e BKSH-sëò, në përputhje me ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën e saj përkatësisht :

-Për vitin 2018, BK ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Ligjin e Buxhetit nr. 109/2017 për buxhetin e vitit 2018. Në fillim të vitit 2018, numri i punonjësve ka qenë 100 veta dhe është ndryshuar sipas Urdhrit nr. 108, datë 31.07.2018, me 97 veta.

-Për vitin 2019, BK ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Ligjin e Buxhetit 99/2018 për buxhetin e vitit 2019. Në fillim të vitit 2019,numri i punonjësve ka qenë 97 veta dhe është ndryshuar sipas Urdhrit nr. 122 datë 17.09.2019, të Këshillit te Ministrave ñMbi organikën e BKò duke ndryshuar në 92 persona.

•Ecurinëe procesit të digjitalizimit të plotë dhe bashkëkohor tëshërbimit bibliotekar për plotësimin e nevojave të përdoruesve .

3.5 KRITERET E AUDITIMIT

Pyetjet e Auditimit		**1. A ka qenë efektiv menaxhimi i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare për periudhën 2018-2020?**	
Pyetjet e nivelit të parë	**Pyetjet e nivelit të dytë**	**Kriteret Krahasuese**	**Referenca e kritereve**
1.1A janë efektive politikat në lidhje me menaxhimin e veprimtarisë së BKSH-së ?	**1.1.1**.A ka siguruar BK zbatimin e kuadrit ligjor/rregullator?	KA1: Strategjia Kombëtare e Ministrisë së Kulturës 2019-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 903, datë 24.12.2019 . KA2:Korrespondenca me MK dhe ngritja e problemit aktual **KA3:** Strategjia dhe Planet operacion ale vjetorë të BK-së. -Rregullorja e Këshillit shkencor. -Rregullore për funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Librit, miratuar me Urdhrin nr. 433, datë 30.10.2020 të Ministrit të Kulturës;	-Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 903, datë 24.12.2019 . -Ligji nr. 8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë ñ i ndryshuar me -Ligjin nr. . 9217, date 8.4.2004 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8576, date 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò; -Ligji nr. 9616, datë 27.9.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2021 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar;
	1.1.2.A janë të mjaftueshme hapësirat bibliotekare për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë se shërbimit ndaj përdoruesve te librit?	**IFLA** (Internacional Federation of Library Association and Institutions), CENL (Konference of European National Libraries) **LIBER** (Ligue Internationaledes Bibliotheques Europeenes de Recherches), UNESCO etj.	-Rregullore teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin plan evakuimi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, miratuar me Urdhër nr. prot. 220, datë 31.12.2014 të Drejtorit të BK; -Ligji nr. 8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë ñ i ndryshuar me -Ligjin nr. . 9217, date 8.4.2004 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8576, date 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò;

	1.1.3..A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare në përmirësimin e infrastrukturës së BK?	KA1: Strategjia Kombëtare e Ministrisë së Kulturës 2019-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 903, datë 24.12.2019 . KA2:Korrespondenca me MK dhe ngritja e problemit aktual **KA3:** Ligji nr. 109/2017 ñPër buxhetin e shtetit të vitit 2018ò; -Ligji nr. 99/2018 ñPër buxhetin e shtetit të vitit 2019ò; -Ligji nr. 137/2020 ñPër buxhetin e shtetit të vitit 2019;ò	-Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 903, datë 24.12.2019 . -Ligji nr. 8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë ñ i ndryshuar me -Ligjin nr. . 9217, date 8.4.2004 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8576, date 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò; -Ligji nr. 9616, datë 27.9.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 ñ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
1.2 A është kryer digjitalizimi i plotë i shërbimit bibliotekar, për periudhën në auditim?	1.2.1.A ka qenë efektiv digjitalizimi i të dhënave të Fondit të materialeve bibliotekare?	KA1:VKM nr. 134, datë 7.3.2018 ñPër krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar DATA BKSH. -KA2:Standardet ndërkombëtare MARC 21 (MARC ISO 2709), AACR2, ISBD, Z 39.50, UNICODE, ISO 639, ISO/DIS 25577, ISO 20775.	Rregullore për administrimin e bazës së të dhënave të sistemit të integruar Bibliotekar data BKSH/data NLA të Bibliotekës Kombëtare, miratuar me Urdhrin nr. 239, datë 25.02.2016 të Drejtorit; -Rregullore e Brendshme e Bibliotekës Kombëtare, miratuar me Urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 të Drejtorit të BK-së, e ndryshuar;
	1.2.2.A ka qenë efektive Qendra e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar për periudhën 2018-2020?	-Rregullore e Brendshme e Bibliotekës Kombëtare, miratuar me Urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 të Drejtorit të BK-së, të ndryshuar;	-Rregullore e Brendshme e Bibliotekës Kombëtare, miratuar me Urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 të Drejtorit të BK-së, të ndryshuar;

Tabela 4:Matrica e kryerjes së auditimit sipas kohës

3.6 QASJA E AUDITIMIT

Auditimi me temë ñEfektivitet i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtareò synon të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv nëse burimet publike janë menaxhuar me përgjegjësi duke informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë mbi efektivitetin e veprimtarisë së institucionit për menaxhimin e shërbimit bibliotekar në kushtet e pamundësisë së sigurimit të ambienteve të përshtatshme me qëllim sigurimin e arkivimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kombëtare. Në këtë mënyrë do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtariae institucionit subjekt auditimi.

Paradigma e këtij auditimi ishte: "Menaxhimi i suksesshëm i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare për të realizuar qëllimin e veprimtarisë së saj si institucion qendror kulturor, informues e shkencor të botimeve shqipe të huaja nëpërmjet koleksioneve të saj me fondet e buxhetit të shtetit, në drejtim të ofrimit të shërbimeve dhe të mirave publike për përdoruesit shqiptarë"

Në këtë auditimperformance, grupi i auditimit, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e përfshira dhe kuadrin ligjor e rregullator të fushës, gjykoi si më të përshtatshme për arritjen e objektivave të auditimit ***qasjen pragmatike*,një ndërthurje midis qasjes cilësore dhe asaj sasiore**. Në funksion të qasjes pragmatike u përdorën kritere të përcaktuara në program, ku përfshihen baza ligjore e rregullatorë, si dhe draft dokumentet strategjike të BK dhe Dokumentet Strategjike të MK. Grupi i auditimit gjykon se kjo qasje siguroi një trajtim shterues të fokusit të auditimit.

Kyauditim performance u orientua kryesishtkahprocesit, pasi janë analizuar strukturatpërgjegjësedheaktivitetet e ndërmarraprej tyre. Gjithashtu ngapyetësorët e përgatiturdhe përgjigjet e subjektit në auditim është dhënë njëtabloeqartë, ebesueshmebazuarnëmetodat e

përdorurangagrupiiauditimit përdhënietëopinionitnëlidhje me ekonomicitetin, eficensëndheefektivitetin e veprimtarisësëBibliotekësKombëtare Shqiptare.

Metodologjia e auditimit

Për tëju dhënë përgjigje pyetjeve të auditimit grupi i auditimit ka përdoruar metodologjinë si më poshtë:

- Intervista me nëpunësit përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në menaxhimin e aktivitetit në BKSH;
- Shqyrtimi dhe analizimi i dokumenteve, rregulloreve, manualeve, statistikave të grumbulluara;
- Shqyrtim i legjislacionit specifik, rregulloreve, raporteve dhe informacionit mbi mbetjet në tërësi ku përfshihen dhe mbetjet plastike;
- Vizita informuese dhe vizita audituese në terren për të parë nga afër situatën reale dhe për të kuptuar procesin aktual të aktivitetit të BKSH-së.
- Pyetësorë me nëpunësit përgjegjës lidhur me perceptimin dhe përfshirjen e tyre dhe analizimin e përgjigjeve;

4. SHTJELLIMI I PIRAMIDËS SË PYETJEVE AUDITUESE:

A ka qenë efektiv menaxhimi i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare për periudhën 2018-2020?

Mesazhi i auditimit:

Nga auditimi i performancës i kryer në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, për periudhën 2018-2020, me temë ñEfektiviteti i aktivitetit të Bibliotekës kombëtareò, u konkludua se: Menaxhimi i aktivitetit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) në nivel strategjik vuan nga një planifikim pjesërisht efektiv si rezultat i mungesës së një strategjie të miratuar nga Ministria e Kulturës në kryerjen e aktiviteteve strategjike, mungesës së analizave për të përcaktuar indikatorë të matshëm, relevant dhe të arritshëm, si dhe mungesës së targeteve për të vlerësuar realizimin e këtyre aktiviteteve vit pas viti, duke shkaktuar kështu pamundësinë e monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat drejtuese, si dhe mungesën e vëmendjes nga Ministria e Kulturës për të vlerësuar realizimin e objektivave kryesorë të saj:
1- Zhvillimi i hapësirave;
2- Sfida teknologjike dhe digjitale;
3- Aftësimi në informacion, fuqizimi i jetës kulturore.
Mungesa e gjurmës së auditimit në proceset e digjitimit të materialeve bibliotekare ka sjellë një proces digjitimi pjesërisht efektiv dhe jo të matshëm, të materialeve të Fondit bibliotekar. Mungesa e politikave dhe udhëzimeve në ndihmë të procesit të inventarizimit, mangësia e planeve operacionale dhe strategjikë të sektorit të zhvillimit të koleksioneve, moskryerja e monitorimit nga strukturat drejtuese të BK-së, si dhe mungesa e rregullores së re për institucionin në funksion të ndryshimit strukturor të BK-së, ka sjellë mos realizimin e disa prej detyrave funksionale që janë: verifikimi dhe inventarizimi i koleksioneve, proces i cili rezulton i pa kryer ndër vite duke ndikuar në performancën e dobët të këtij sektori.

Observacioni i subjektit(*në formë të përmbledhur*)*: BKSH*, me shkresën prot. nr. 185/15, datë 24.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 203/6, datë 24.09.2021, sugjeron se digjitimi është një proces efektiv i mbështetur në protokollin e vitit 2016 dhe se skanuesit, përpunuesit dhe bibliografët janë përdorur me efikasitet.
-BKSH shprehet se grupi i auditimit është marrë fare pak me projektin e Rehabilitimit të aneksit të BK ose biblioteka e ñvjetërò.
-BKSH shprehet për mungesë vëmendje nga grupi i auditimit edhe ndaj Sektorit të Restaurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Fillimisht grupi i auditimit vlerëson vëmendjen e stafit të BKSH-së në trajtimin hap pas hapi të problematikave të konstatuara në projekt-raport, si dhe pas leximit me korrektësi të observacioneve tuaja në vijim paraqesim qëndrimin tonë.
Shënim: Edhe pse obesrvacionet nuk janë vendosur në raport, theksojmë që ato janë lexuar dhe trajtuar tërësisht nga grupi i auditimit.
-Observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë, reflektuar edhe më sipër në mesazhin e auditimit, por duke ri theksuar faktin që procesi i digjitimit ka qenë pjesërisht efektiv dhe kjo si rezultat i arsyeve të cituara e të konsultuara nga ana jonë me stafin punonjës dhe struturat drejtuese vazhdimisht gjatë periudhës së auditimit në terren dhe konkretisht në vijim paraqesim argumentet:

1-Në pikën 4.1, A janë efektive politikat në lidhje me menaxhimin e veprimtarisë së BK?, ne kemi trajtuar draft strategjinëdhe objektivat e saj, por ky dokument ka mbetur në formën e një drafti dhe ne si audites të KLSH-së në bazë të standardeve të auditimit bazohemi vetëm ne vendime, ligje apo dokumente të cilët kanë marrë formën e tyre përfundimtare. Juve bini në kundërshtim me çfarë kërkoni, pasi edhe ju në observacionin tuaj konfirmoni që ky dokument është ende draft dhe s'ka marrë akoma miratim nga Ministria e Kulturës, rekomandim ky i lënë edhe nga grupi i mëparshëm i auditimit të KLSH-së, që rezulton pjesërisht i zbatuar dhe shumë i vonuar. Gjithashtu grupi i auditimit studioi me vëmendje maksimale Draft Strategjinë e ndërtuar nga stafi përkatës dhe arriti në konkluzione se në këtë dokument nuk janë trajtuar me prioritet problematikat e administrimit dhe inventarizimit të materialeve bibliotekare e në veçanti verifikimi i tyre duke përcaktuar politika të qarta për pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve të mbështetura në akte nënligjore si hartimi i një Udhëzimi specifik kryesisht në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e fondeve të BK.(trajtuar më hollësisht në fq. 30)

-Në lidhje me protokollin e vitit 2016 që ju citoni në observacionin tuaj , trajtuar nga ne si në raport por edhe në intervistat e vazhdueshme, nuk merret në konsideratë, pasi parimisht ai protokoll është thjesht një ñletërò, ku përcakton në përgjithësi detyrat funksionale që sektori i bibliografisë ka, pra është nënjëudhëzues manual për mënyrën se si funksionon dhe punon ky sektor, por ai nuk mund të zëvendësojë në asnjë mënyrë atë që ne kemi theksuar: Mungesën e planeve vjetorë operacionalë nga sektorët përkatës, planifikimi konkret i listave për digjitim vjetore dhe mujore dhe rrjedhimisht si mungesë e këtyre mos matje e punës dhe efektivitetit si dhe mungesë monitorimi nga përgjegjësit e sektorëve.

2-Observacioni juaj në lidhje me ñBibliotekën e ñvjetëròose aneksi i BK, nuk merret parasysh, pasi jo vetëm që e kemi cituar dhe trajtuar përgjatë materialit, por sjellim në vëmendjen tuaj që ky është ende një projekt që ka nisur me lidhjen e kontratës publike të shërbimit në datën 03.12.2020 ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ñXò ShPK dhe përfundon sipas kësaj kontrate në një periudhë dy vjeçare, brenda datës. **31.12.2022**. Gjithashtu kemi theksuar faktin se : evidentohet mos financim ndër vite për një ndërtesë të re me standarde bashkëkohore në lidhje me BKSH si dhe shkresën e Titullarit të BKSH-së, me nr.618. prot. datë 25.11.2019 me objekt ñ Kriza e hapësirësò, drejtuar Ministres së Kulturës, ku prezanton problemin kryesor me të cilën BK përballet sot.

Ndërkohë periudha jonë e auditimit është 2018-2020 dhe për fat të keq gjendja e librave apo materialeve bibliotekare që ndodhen në këtë aneks është alarmante. Gjithashtu edhe me përfundimin e kësaj strukture do të duhet një kohë e gjatëpër ri konceptimin arkitekturor të gjithë godinës për ta bërë atë sa më funksionale e tërheqëse për lexuesin, me hapjen e sallave të reja, krahas Sallës ñFrancezeò dhe asaj ñGjermaneò që tashmë funksionojnë, dhe konkretisht bëhet fjalë për hapjen e Sallës ñHerbertò, në të cilën do të rindërtohet një ndër bibliotekat e para publike të ngritura në Shqipëri nga personaliteti i njohur anglez Aubrey Herbert dhe Sallën e ñGjuhëve të Rrallaò (librat në greqishten e vjetër dhe në latinisht), si dhe Salla e ñBibliofilisëò.

Pra këto janë cituar nga ne por ende çdo gjë është në fazën e projekteve dhe jo e materializuar.

Auditimi i performancës ka për qëllim të evidentojë realitetin dhe mangësitë që një institucion ka për përmirësimin e punës dhe politikave në tërësi.

3- Observacioni juaj në lidhje me ñSektorin e Restaurimitò merret parasysh, por kjo në kuadër të rekomandimit të bërë nga ana jonë, pasi si problematikë ajo është trajtuar nga grupi i auditimit në fq. 38 të PRA.

Gjithashtu sqarojmë se programi i auditimit të KLSH-së në lidhje me auditimin e performancës si dhe risqet apo drejtimet që ne trajtojmë janë puna jonë e vazhdueshme të cilat përcaktohen dhe miratohen nga Kryetari i KLSH-së.

4.1. A janë efektive politikat në lidhje me menaxhimin e veprimtarisë së BK?

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë është institucioni kryesor bibliotekar i vendit dhe qendër e rëndësishme studimore-kërkimore shkencore. Historiku i saj fillon me themelimin e saj më 10 Korrikun e vitit 1920dhe në përurimin e saj në vitin 1922, ajo numëronte rreth 6,000 vëllime. Në periudhën e paraluftës, spikat veprimtaria e saj (1928-1937) dhe me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, BKSH kishte një koleksion prej 15,000 vëllimesh. Koleksionet me karakter albanologjik u shtuan kryesisht si rezultat i konfiskimit të disa librarive dhe bibliotekave private të personaliteteve të kulturës. Në fund të vitit 1947 fondi i saj numëronte rreth 100,000 vëllime, ndërsa sot numërohen në BKSH rreth **1,155,557**materiale bibliotekare (libra, periodikë, harta, atlase, mikrofilma e materiale të tjera).
Çdo gjë të mirë e mësova nga librat!

Abraham Lincoln.

Në Bibliotekën Kombëtare, fondi i arkivit të botimeve shqip, i antikuarit, i dorëshkrimeve, hartave, si dhe fondi i albano-balkanologjisë përbëjnë pasuri me vlera të mëdha për thesarin e kulturës kombëtare shqiptare e si të tilla, të kulturës evropiane.
Bibliotekat në Evropën ku ne kërkojmë të integrohemi plotësisht, janë mjet i rëndësishëm për zhvillim kulturor, social dhe ekonomik. Deklarata e nismës Publike të Bashkimit Evropian në konferencën e Kopenhagës (Tetor 1999) nënvizon rolin e bibliotekave publike në mbështetje të:

- ✓ demokracisë dhe qytetarisë;
- ✓ zhvillimit ekonomik dhe social;
- ✓ të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- ✓ diversitetit kulturor dhe gjuhësor.

Vlera e bibliotekave si një "hapësirë neutrale" është ideologjikisht dhe politikisht në mbështetje të gjithë përfshirjes sociale.
Këshilli i Evropës ka theksuar se zhvillimi i një strategjie të qartë, brenda një kuadri ligjor të përshtatshëm, është domosdoshmëri për përparimin e rrjetit kombëtar të bibliotekave publike të vendeve anëtare të tij.
Duke iu referuar dispozitave ligjore të ñDeklaratës Universale të Drejtave të Njeriutò, posaçërisht nenit 22, 26 dhe 27, përmendim se në to theksohet rëndësia e edukimit dhe arsimimit si një e drejtë kulturore bazë, gjë e cila përforcohet edhe në ñKonventën në kuadër të të drejtave të fëmijëveò,neni29 dhe neni 31, ku ritheksohet fakti se shtetet duhet të promovojnë të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe artistike, si dhe të drejtën për të pasur mundësi të barabarta rikrijuese në të gjitha llojet e formave kulturore dhe artistike, pasi edhe përmes leximit, fëmijët dhe të rinjtë do të ndërgjegjësohen për larminë e formave kulturore dhe përmes tyre do të mund të njohin tjetrin dhe kulturën e tij, për tôi shërbyer një të ardhmeje në paqe dhe zhvillim.
Nga vetë rëndësia dhe vlerat që promovon BK, Ministria e Kulturës, në ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisèò, i ndryshuar, neni.11 dhe neni.13, citohet se:
-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve harton dhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar.
-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve drejton dhe mbikëqyr standardet profesionale në të gjithë rrjetin bibliotekar të vendit nëpërmjet Bibliotekës Kombëtare, si qendër e kualifikimit profesional në nivel kombëtar.".

Strategjia është drejtimi dhe qëllimi i organizatës në planin afatgjatë, që të arrijë avantazhe në një mjedis vazhdimisht të ndryshueshëm, nëpërmjet konfigurimit të burimeve dhe kompetencave të saj, më qëllim përmbushjen e pritshmërisë, ose menaxhim i integruar i fushës përkatëse, i cili kombinon analizën, formulimin dhe implementimin, më qëllim arritjen e avantazheve konkurruese. E thënë në terma të shkurtuara në strategji përfshihen;

- Drejtimi afatgjatë i organizatës;
- Fusha e veprimtarisë së organizatës;
- Përshtatja strategjike me ambientin;
- Burimet dhe kompetencat e organizatës;
- Vlerat dhe pritshmërinë.

Në nenin 14 të ligjit nr. 8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, citohet se: **pranë MK funksionon** Këshilli Kombëtar i cila ka përbërje të tij:

- 2 përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, anëtarë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Akademia e Shkencave, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Punonjësve të Bibliotekave, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Biblioteka Kombëtare, anëtar;
- 1 përfaqësues nga bibliotekat publike, anëtar;
- 1 përfaqësues nga bibliotekat e veçanta, anëtar;
- 1 përfaqësues nga bibliotekat universitare, anëtar;
- 1 përfaqësues nga çdo shoqatë botuesish, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, anëtar.

Auditimi u fokusua në drejtim të hartimit të planeve operacionale për realizimin e objektivave referuar strukturave përkatëse, monitorimi i zbatimit të objektivave strategjik, proces i cili është vendimtar për të vlerësuar arritjen e rezultateve të parashikuar, si dhe për të evidentuar shmangiet nga rezultatet e pritura me qëllim marrjen e masave për përmirësim.

Strategjia Kombëtare e Ministrisë së Kulturës 2019-2025

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është krijimi i një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese, dhe në përgjithësi futjen në shinat e duhura të kulturës shqiptare në 6 vitet e ardhshme.

Misioni: Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat dhe në përgjithësi futjen në shinat e duhura të kulturës Shqiptare në 6 vitet e ardhshme.

Qëllimi strategjik: Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën.

Në të janë parashikuar 5 objektiva specifikë strategjikë, ndërmjet së cilës është dhe hartimi i projekt ideve për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë, ku përfshihet dhe hartimi i projektit të bibliotekës kombëtare referuar pikës:

Qëllimi i politikës e cila është: -Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptarë dhe shtimi i veprimtarisë kulturore dhe artistike;

Objektivi specifik 4- Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, produkteve si dhe cilësisë artistike.

a- Veprimtaria e Bibliotekës Kombëtare si institucioni unik kulturor, shkencor publik e qendror i vendit, referuar akteve ligjore, përgjigjeve të pyetësorëve dhe dokumentacionit të paraqitur nga BK rezulton se për periudhën objekt auditimi: **Nuk është zhvilluar në bazë të një politike kulturore për zhvillimin e rrjetit të bibliotekave të hartuar nga MK.**Kjo për faktin se Ministria e Kulturës ka detyrimin ligjor që të hartojë strategji afatmesme apo afatgjatë mbarë-kombëtare për bibliotekat publike dhe Bibliotekën Kombëtare, referuar nenit. 11 të ligjit nr. 8576, datë 3.2.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, ku citohet se: ñ*Ministria e Kulturës hartondhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe të politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar*ò, e <u>*parealizuar*</u> për periudhën objekt auditimi.
Strategjia Kombëtare e MK për vitin 2019-2025, miratuar me VKM nr.903, datë 24.12.2019, është dërguar në formë elektronike titullarit të institucionit më 22 Prill 2020, ku u konstatua se megjithëse në zbatim të misionit të saj ka të parashikuar pas shumë vitesh hartimin e projekt idesë për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore në të cilën përfshihet dhe projekti për ngritjen e një Biblioteke të re Kombëtare, nuk ka gjetur zbatim dhe BKSH vazhdon të zhvillojë aktivitetin e saj në një godinë të amortizuar dhe me shume risqe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në strategjinë e MK-së nuk ka afate kohore dhe nuk janë alokuar fonde buxhetore për realizimin e kësaj ñprojekt idejeò, e cila ka mbetur vetëm në letra!

b- Rezulton se për periudhën 2018, 2019 e në vazhdim, veprimtaria e BK është mbështetur në *draft strategjinë 2016-2021* të hartuar nga një grup prej 13 anëtarësh punonjës të Bibliotekës Kombëtare, të përbërë nga kryetar ish Titullar ja e BK z. X , dhe 12 anëtarët e tjerë përgjegjës të sektorëve të institucionit, sipas shkresës nr.19.prot., datë 19.01.2015, draft i cili nuk rezulton të jetë shqyrtuar nga Këshilli Shkencor në bazë neni 24 të ligjit nr. 8576,datë 03.02.2000, ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisë ñi ndryshuar, dhe të jetë miratuar nga MK si institucion i cili harton politikat për tu zbatuar nga institucionet e varësisë, në bazë të nenit 11të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000.të ligjit nr. 8576,datë 03.02.2000, ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëòi ndryshuar.
Draft Strategjia e Bibliotekës Kombëtare Shqiptare për vitet 2016-2021 afatshkurtër është hartuar në vitin 2015 ngaish Titullarja e BK z. X , bazuar në rekomandimet e KLSH-së me shkresën nr.100/26, datë 26.12.2014, në problematikat kryesore të hasura ndër vite sikurse janë kriza e hapësirave si dhe funksionet e përhershme dhe të patjetërsueshme bibliotekonomike si dhe të kuadrit ligjor që i mbështet ato, duke e konceptuar si sfidë të forta emancipuese, të domosdoshme për një bibliotekë kombëtare moderne dhe bashkëkohore referuar dhe objektivave të BE si dhe të organizmave ndërkombëtare në të cilat aderon BK.

Kjo draft strategji është përcaktuar në tre drejtime:

1- Zhvillimi i hapësirave;
2- Sfida teknologjike dhe digjitale;
3- Aftësimi në informacion, fuqizimi i jetës kulturore.

a-Objektivi i vendosur në Draft Strategjinë2016-2021, si zhvillimi i hapësirave është iparealizuar pasi mungon mbështetja me fonde buxhetore nga MK, referuar kërkesave të vazhdueshme të BK-së, për këtë qëllim drejtuar Ministrisë së Kulturës, të shoqëruara me informacion përkatës nga viti 2015, konkretisht(shkresa nr.238.prot, datë 25.11.2015) dhe ndër vite ky objektiv nuk u shoqërua me investime të domosdoshme nga MK për zhvillimin e hapësirave apo në investime për mirëmbajtjen dhe sigurinë e objektit të godinës qendrore të BK, sipas kërkesave të paraqitura nga BK për fonde buxhetore për vitet 2018-2020, e konkretisht shkresave nr.140/3 datë 08.08.2017, shkresës nr.431/1 datë 20.08.2018, dhe shkresës nr. 276/1, datë 18.04.2019 të PBA dërguar Ministrisë së Kulturës si

dhe të dhënave sipas akt rakordimeve në fund të vitit të mbajtura në degën e thesarit Tiranë me përfaqësuesit e institucionit të BK në lidhje me fondet e planifikuara dhe të përdorura në institucion.

c-Draft strategjia në lidhje me objektivat si Sfida Teknologjike dhe Digjitale, Aftësimi në Informacion nuk është shoqëruar me plane operacionale në realizimin e objektivave sipas sektorëve e shoqëruar kjo me tregues konkretë, të realizueshëm dhe të matshëm sipas vitevedhe të protokolluara në arkivin e institucionit sipas ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 ñ Për arkivat ñ, neni 2/pika 1,pika 5 dhe Rregullores së Njehsuar të Punës me dokumente administrative në Autoritetet Publike të R. Shqipërisëò të Këshillit të Lartë të Arkivave me nr.4, datë 19.06.2017, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish Titullarin dhe sektorët përkatës sipas urdhrit të ish Titullares referuar shkresës nr.19/prot., datë 19.01.2015.

d-Në planet e punës të institucionit mungojnë treguesit e performancës që do të përdoren nga strukturat drejtuese për të siguruar arritjen e objektivave të Administratës së Bibliotekës Kombëtare dhe feedback të saktë mbi realizimin e aktiviteteve, informimin e stafit për mënyrën se si është zbatuar draft strategjia përmes punës së tyre, etj., çka do të siguronte instrumente për të vlerësuar performancën e strukturave të administratës së BK, si dhe informacion të paanshëm që do të përdorej për analiza dhe ndryshime të draft -Strategjisë, nëse do të ishte e nevojshme.

Kjo bëhet me qëllim jo vetëm për të siguruar rezultate të matshme, por e rëndësishme është që draft-strategjia të monitorohet dhe të vlerësohen në përputhje me metodologjinë e pranuar të treguesve të performancës. Monitorimi i zbatimit të draft planit strategjik është vendimtar për të vlerësuar arritjene rezultateve të parashikuara, si dhe për të evidentuar shmangiet nga rezultatet e pritura me qëllim marrjen e masave për përmirësim, gjë që në BK nuk realizohet referuar mungesës së të dhënave të cilat duhet të bazoheshin në norma teknike profesionale të miratuara nga Titullari në planet operacionale të strukturave përkatëse.

Referuar të dhënave të raporteve të performancës vjetore në institucion, po paraqesim realizimet e paraqitura sipas objektivave në ***draft strategji***:

1. Sfida teknologjike

1.1 Teknologji të reja leximi dhe kërkimi, të cilat do tâu lejojnë përdoruesve akses komod, lexim të teksteve, kërkim të kombinuar në database-në BKSH, por edhe në lidhjet e shumta të BKSH me rrjetet ndërkombëtare;

1.2 Implementim i një sistemi të ri të gjurmimit dhe qarkullimit të librit. Ky sistem do të zhvillojë një marrëdhënie të re të përdoruesve me BKSH, duke e porositur librin apo njësinë përmes aplikacioneve nga celularët apo mjetet e tyre personale të teknologjisë së lartë;

1.3 Në varësi të investimeve në teknologji: Shtim i posteve kompjuterike të leximit dhe kërkimit;Aftësim në përdorimin e teknologjisë; Qasje e re në shërbimet e BKSH-së;

1.4 Rritja e pranisë së BKSH-së në rrjetet sociale;

1.5 Ndryshimi dhe përshtatja e ëebsite-it të BKSH duke synuar shndërrimi e saj në një site më tërheqës dhe më modern ku përdoruesi do të ndihej familjar sipas konceptit bashkëkohor *user-friendly,*duke qenë se BK anëtare në CENL (Konferenca e Bibliotekave Kombëtare të Evropës)qysh prej vitit 1998, **nga 1 Janar 2008në portalin Evropian " Biblioteka Evropiane", ky site** ofron shërbim falas në burime digjitale dhe bibliografike të Bibliotekave Kombëtare të Evropës në 20 gjuhë, përfshirë dhe mundësinë e kërkimit në gjuhën Shqipe.

2. Zhvillimi i një strategjie Digjitale.

2.1 Fuqizimi i procesit të digjitimit;

2.2 Zhvillimi i mëtejshëm i Qendrës aktuale të Digjitimit pranë BKSH-së;

2.3 Digjitimi i Periodikëve, Antikuarëve; Dorëshkrimeve;
2.4 Publikim i trashëgimisë së digjituar në portale botërore e evropiane.

3. Projekti pilot në Aftësimin në Informacion.

3.1 Aftësimi në informacion i bibliotekarëve të sistemit kombëtar bibliotekar;
(Biblioteka Kombëtare, bibliotekat publike, akademike dhe speciale)
3.2 Aftësimi në informacion i përdoruesit tradicional të bibliotekës;
3.3 Aftësimi në informacion i grup moshave 10-15 vjeç; i grup moshës rinore; i grup moshës së nivelit universitar.

4. Veprimtari kulturore e shkencore.

Ekspozita, konferenca, ligjërata, forume kulturore.

5. Proceset standarde në vijueshmëri sipas sektorëve: Ushtrimi i funksioneve dhe detyrave të përhershme nëpër sektorë sipas ligjit dhe detyrave funksionale në funksion të shërbimit ndaj publikut.

5.1 Qasje të barabartë për të gjithë përdoruesit në burime informacioni, koleksioneve dhe shërbimeve bibliotekare;
5.2 Shërbim i përdoruesve nëpërmjet koleksioneve të veta bibliotekare, mjeteve elektronike të informacionit, veprimtarive të organizuara prej saj ose në bashkëpunim me institucione apo organizma të tjerë.
5.3. Formimi bibliotekar: Shkolla Kombëtare e Bibliotekonomisë sipas nenit 27/pika 8 e ligjit nr.8567, datë 03.02.2000ò Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar i cili bazohet në Urdhrin nr.139, datë 28.03.2014. ñPër Miratimin e strukturës dhe të organikës së bibliotekës kombëtareò, I ndryshuar me Urdhrin nr.122, datë 17.09.2019 ku është përcaktuar që Sektori I studimit dhe I kualifikimit me 4 punonjës në organikë sipas kësaj skeme:

6. Fuqizim i Qendrës së Trajnimit Bibliotekar

Programit profesional tõ shtohet edhe:
- aftësimi maksimal i bibliotekarëve për implementimin e teknologjive të reja në bibliotekë, përdorimin e burimeve të informacionit elektronik, katalogut elektronik, Internetit, kërkimin e burimeve digjitale etj.;
- përfshirja e aftësimit të nxënësve e studentëve në forma e mënyra të ndryshme, si: kurse orientuese për përdorimin e bibliotekës, burimeve të informacionit, katalogut elektronik.

Objektivat/prioritetet e Bibliotekës Kombëtare për vitin 2020

1. Festimi i 100 - vjetorit të krijimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.
2. Vizibiliteti publik i BKSH.
3. Hapja ndaj një publiku sa më të gjerë.
4.Ri konceptimi i Bibliotekës së Vjetër.
5. Sektori i restaurimit të BKSH.

6. Bashkëpunimi me jashtë

Strategjia është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të zhvillimit të bibliotekave[6], në mbështetje të direktivave të BE-së e rekomandimeve të Komisionit Evropian për digjitim të trashëgimisë kulturore, politikave të strukturave ndërkombëtare ku Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë aderon, (IFLA,CENLetj.),standardeve/dokumentave/udhëzuesve/deklatave/manifesteve të organizatave ndërkombëtare në fushën e librit, informacionit dhe bibliotekave (UNESCO, IFLA etj.); partnereve evropiane e botërore; programit të Ministrisë së Kulturës (digjitimi); praktikave më të mira evropiane; detyrave funksionale të sanksionuara në nenin 27 të Ligjit për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë; përvojave/praktikave më të mira ndërkombëtare; gjendjes së institucionit dhe nevojave të sistemit bibliotekar kombëtar; problematikave të krizës së hapësirave që BKSH-së e krijuar/trashëguar ndër vite (daton prej 30-vitesh) dhe nevojave për gjetjen e zgjidhjeve optimale. Duke u mbështetur nëkëto standardeve, BKSH orientohet si në strategjinë afatshkurtër, ashtu edhe atë afatgjatë për garantimin e qasjes së lirë në trashëgiminë kombëtare për përdoruesit e saj dhe të integrimit në portale të trashëgiminë kulturore evropiane e më gjerë përmes regjistrimeve bibliografike të standardizuara dhe njësive të digjituara.

Dokumentet mbështetëse

- ✓ Rekomandime për digjitimin dhe qasjen online të materiale kulturore dhe ruajtjen digjitale
- ✓ Manifesti i IFLA-s & UNESCO-s për bibliotekat digjitale: të tejkalosh hendekun digjital: ta bësh trashëgiminë kulturore dhe shkencore të qasshme për të gjithë
- ✓ Manifesti i IFLA-s për Internetin
- ✓ Manifesti i Aleksandrisë për bibliotekat (IFLA)
- ✓ Deklarata e Aleksandrisë në Aftësimin në Informacion dhe të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (IFLA)
- ✓ Deklarata e Lionitpër qasjen në informacion dhe zhvillim (IFLA)
- ✓ Deklaratë e Parisit për vëmendje të vazhdueshme mbin Aftësimit në Media e Informacion në epokën digjitale (UNESCO)
- ✓ Deklarata e Pragës ñDrejt një shoqërie të aftësuar në informacionò (UNESCO)
- ✓ Rezoluta e Luksemburgut për digjitimin e trashëgimisë kulturore evropiane (CENL)
- ➢ Udhëzues i IFLA-s *Projektet e digjitimit të koleksioneve të librave të rrallë dhe dorëshkrimeve*;
- ➢ Udhëzues i IFLA-s *Programi i formimit profesional për bibliotekonominë dhe informacionin;*
- ➢ Çështjet kyçe në një projekt ndërtimi: botim i shkurtër, bazuar në udhëzimet e IFLA-s mbi ndërtesat në vitin 2007.
- ➢ Etj.

Realizimi i objektivave sipas viteve

Sipas objektivave strategjikë për menaxhimin e shërbimit bibliotekar, indikatorët e përdorur dhe rezultatet e arritura:
Zbatimi dhe zhvillimi i standardeve ndërkombëtare (përpunim, digjitim, organizim);
Zhvillimi i programit bibliotekar;
Monitorimi i vijueshëm i treguesve statistikore (çdo muaj);
Raportimi javor i punës dhe planifikimi i javës në vijim;

[6] *Standardet në bibliotekonomi formës ojnë të gjitha proceset e punës në biblioteka që nga përpunimi informacionit, shërbimet ndaj përdoruesve në mjedis fizik e virtual dhe deri tek matja.*

Analiza pune, mbledhje pune me tematika specifike, relacione/memo/informacione rast pas rast drejtuar titullarit të institucionit;
Monitorimi i buxhetit (çdo katër muaj);
Kontrolli i vijueshëm periodik tekniko-profesional (katalogim përshkrues, kontroll bibliografik, analizë subjekti, indeksim e abstrakt) i proceseve të punës për çdo punonjës nga përgjegjësi i sektorit përkatës sipas standardeve ndërkombëtare të bibliotekonomisë;
Monitorimi i kërkesave/nevojave të përdoruesve për qasje në informacion.

Mars 2020

Shërbim bibliotekar online nëpërmjet portalit e-albania:

Aplikim online për anëtarësim në BKSH (formular elektronik);
Aplikim online për huazim për lexim/rezervim të materialit (formular elektronik)
Rritja e pranisë së BKSH -së në rrjetet sociale (FB, INSTAGRAM)

Objektivi specifik 1.2: Shtimi i posteve kompjuterike të leximit dhe kërkimit.
Teknologjia me prekje në postet kompjuterike të leximit dhe kërkimit.

Objektivi specifik 1.3: Rritja e pranisë së BKSH-së në rrjetet sociale.

Objektivi specifik 1.4: ëebsite dhe ndërfaqe e re e BKSH2020
- tërheqëse
- bashkëkohore
- miqësore me përdoruesin.

Objektivi specifik 1.5: Zhvillimi i sistemit bibliotekar/programit bibliotekar
Maj 2020
Sistemi:
- më profesional, cilësor, i shpejtë
- me fusha e funksionaliteteve të shtuara
- me elementë të larmishëm kërkimi;
- bazuar në standardet ndërkombëtare të ndërtimit të sistemeve bibliotekare botërore.

Tabela 1: Zhvillimi i sistemit informatik bibliotekar

2018	2019	2020
Sistem i pa përditësuar, me standarde të kufizuara, me probleme në plotësimin e fushave si p.sh., ISBN.	Sistem i pa përditësuar, me standarde të kufizuara, me probleme në plotësimin e fushave si p.sh., ISBN.	U implementua sistemi i ri, me standarde bashkëkohore si p.sh., MARC21, u rregullua problemi me fushën e ISBN si dhe u shtuan shumë fusha të cilat mungonin.
Sistemi kishte 3 module në gjendje pune dhe jo të ndërlidhur.	Sistemi kishte 3 module në gjendje pune dhe jo të ndërlidhur.	Sistemi sot përmban 5 module kryesore të ndërlidhur me njëri-tjetrin të cilat janë të përshtatur sipas kërkesave specifike të stafit dhe institucionit të Bibliotekës Kombëtare.
		Protokolli i shkëmbimit Z39.50.

		U krijua lidhja me Bibliotekën Digjitale.

Objektivi specifik 1.6: Shtimi i elementëve të kërkimit dhe funksionaliteteve në OPAC.
Baza e të dhënave e BKSH:
Kërkim online për libra, artikuj, harta, disertacione, doreshkrime, materiale audio-vizuale
Kërkim i thjeshtë (me më shumë elementë kërkimi:17) dhe kërkim i kombinuar
Përpilimi/hartimi automatikisht i listave të materialeve të shfaqura gjatë kërkimit me renditjen : autor, numër vendi etj.
Objektivi specifik 1.7: Zhvillimi i Bibliotekës Digjitale

-Qasje gjithnjë e më e madhe në trashëgiminë e shkruar kombëtare kulturore e më gjerë jashtë mureve të bibliotekës.

- Qasje online në materialet digjitale: 265,000 faqe.
- Qasje në kategori koleksionesh digjitale: antikuarë, doreshkrime, revista, harta, libra.
- Lexim e shfletim në koleksionet digjitale në mënyra të ndryshme: imazh, libër, galeri.

Objektivi specifik 1.8: Risi teknologjike
Viti 2020
Video-galeri
Objekti specifik 1.9: Aftësim në përdorimin e teknologjisë
Orientimi dhe aftësimi i përdoruesve në përdorimin e teknologjisë (çdo ditë përdoruesit, sidomos moshën e tretë).

Objekti specifik 1. 10: Zhvillimi i standardeve
2020
Standardet e reja: Z 39.50; MARC 21.
2. Qëllimi i strategjisë: Zhvillimi i strategjisë digjitale.

Objektivi specifik 2.1: Digjitimi i trashëgimisë kulturore kombëtare: rritja e njësive të digjituara të: Periodikëve, Antikuarëve; Doreshkrimeve.

Objektivi specifik 2.2: Digjitimi i periodikut për të mundësuar edhe botime anastatike.

2018
Digjitimi i Periodikëve

Digjitimi i Antikuarëve
Digjitimi i Librave
Digjitimi i Bibliografive
Botim anastatik revista ñDiturijaò

2019
Digjitimi i Periodikëve
Digjitimi i Dorëshkrimeve
Digjitimi i Librave
Fletorja zyrtare 1922-1944
Botim anastatik gazeta ñLirijaò

2020
Digjitimi i Periodikëve
Digjitimi i Librave

Fuqizimi i procesit të digjitimit u mundësua me zgjerimin/shtimin e stafit të Qendrës Bibliotekare të Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar në organikën e vitit 2019 (shtator): nga 2 kaloi në 4 persona (2 skanues dhe 2 përpunues).
Krahas procesit të digjitimit, Qendra Bibliotekare e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar është angazhuar me përgatitjen e botimeve anastatike*, digjitimin e materialeve të ndryshme për veprimtari që institucioni ka realizuar në bashkëpunim me institucione kulturore e jo vetëm, ngritjen e muzeumeve etj. (që ndodhen vetëm në koleksionet e BKSH-së) si* dhe digjitimit të dosjeve të personelit të kërkuara nga DAP (2018).

Objektivi specifik 2. 3: Publikim i trashëgimisë së digjituar në portale botërore e evropiane:

Në cilësinë e partnerit në Bibliotekën Evropiane dhe Bibliotekën Digjitale Botërore, BKSH ka mundësuar promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare në portale botërore.

https://ëëë.europeana.eu/en/item/9200510/10c419fe_ef5b_4d7c_be99_6c9c45ab9ab1
https://classic.europeana.eu/portal/en/record/9200510/10c419fe_ef5b_4d7c_be99_6c9c45ab9ab1.htmlutm_source=ne ëebsite&utm_medium=button
https://ëëë.ëdl.org/en/item/12052/#q=scanderbeg

3. Qëllimi i strategjisë: Projekti pilot në Aftësimin në Informacion

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë si një ndër pionieret e zbatimit të Aftësimit në Media e Informacion, luan edhe sot rolin drejtues në vend. Programet e Aftësimit në Media dhe Informacion janë pjesë përbërëse e strategjisë së përgjithshme të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, me module teorike apo praktike, ku krahas punonjësve të sistemit kombëtar bibliotekar, përfshihen edhe grupmosha të ndryshme përdoruesish.

Objektivi specifik 3.1: Aftësimi në informacion i bibliotekarëve të sistemit kombëtar bibliotekar:

Përfshirja e modulit ñAftësim në Informacionò në programin e Qendrës së Trajnimit Bibliotekar (2018)

Objektivi specifik 3.2: Aftësimi në informacion i përdoruesit tradicional të bibliotekës:

Me implementimine teknologjive të reja në shërbimet bibliotekare, si: anëtarësim/kërkesë për lexim nëpërmjet portalit e-Albania; krijimin e ñKëndit Digjital të Leximitò etj., përdoruesit janë aftësuar në çdo rast për tô orientuar në kërkimin e tyre specifik.

Objektivi specifik 3.3: Aftësimi në informacion i grupmoshave 10-15 vjeç; i grupmoshës rinore; i grupmoshës së nivelit universitar:
Në seminaret/programet e Aftësimit në Informacion janë përfshirë grup-mosha të ndryshme.

4. Qëllimi i strategjisë: Jeta kulturore e shkencore

Objektivi specifik 4.1: Ekspozita.
Objektivi specifik 4.2: Konferenca, ligjërata, forume kulturore.

5. Qëllimi i strategjisë: Proceset standarde në vijueshmëri: Ushtrimi i funksioneve dhe detyrave të përhershme.
Objektivi specifik 5.1: Qasje të barabartë për të gjithë përdoruesit në burime informacioni, koleksioneve dhe shërbimeve bibliotekare:

Shërbime bibliotekare me prani fizike:
Qasje e lirë në sallat e leximit
Shërbim referues (fjalorë, enciklopedi)
Informacion
Qasje në katalogët manualë e të digjituar
Qasje në katalogun elektronik
Qasje në trashëgiminë kulturore: Bibliotekë Digjitale
Qasje në bibliografi dhe e-bibliografi
Internet
Fotokopje
Informim nëpërmjet ëebsite-it të BKSH-së

Shërbime bibliotekare online:
Qasje në katalogun elektronik
Qasje ne trashëgiminë kulturore: Bibliotekë Digjitale
Qasje në e-bibliografi
Qasje në katalogët e digjituar
Anëtarësim
Kërkesë dhe rezervim materiali bibliotekar
Pyetje/Përgjigje
Informim nëpërmjet -it të BKSH-së

Objektivi specifik 5.2: Shërbim ndaj përdoruesve nëpërmjet koleksioneve të veta bibliotekare, mjeteve elektronike të informacionit, veprimtarive të organizuara prej saj ose në bashkëpunim me institucione apo organizma të tjerë

Shërbim i kufizuar për përdoruesit

Shërbimi i kufizuar për anëtarët e Bibliotekës Kombëtare lidhet jo vetëm me situatën e krijuar pas dy incidenteve të sipërpërmendura, por dhe me **krizën e theksuar të hapësirave për** depozitimin e fondeve (në tre katet e nëndheshme) të materialeve bibliotekare, si libra, revista, gazeta etj., (aktualisht për këtë qëllim sipërfaqja është 1,560 m² kur në fakt sipas perimetrave të sigurisë asaj i nevojitet një sipërfaqe prej rreth 12,000 m²: 8 herë më shumë).

Gjithashtu, prej vitit 2017 e në vijim, librat e rinj që vijnë në bibliotekë nuk përcillen në mjediset e hapësirave depozituese të materialeve bibliotekare, por janë vendosur në ambientet që më parë shërbenin për lexuesit.

Edhe në kushtet e sigurisë në fushën e mbrojtjes nga zjarri në Bibliotekën Kombëtare, veçanërisht në sallat e fondeve (katet e nëndheshme) vazhdojnë të mos jenë plotësisht në përputhje me parametrat dhe normat teknike të përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e mbrojtjes nga zjarr.
Sipas Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë e Tiranës *"Për të pasur një aktivitet normal të bibliotekës si dhe nga rasti i mëparshëm i rënies së zjarrit duhen përmirësime të masave mbrojtëse kundra zjarrit dhe shpëtimit për vijimin e një aktiviteti normal të bibliotekës".* Kjo situatë mund të zgjidhet vetëm me ndërtimin e një biblioteke të re.

Objektivi specifik 5.3 Formimi bibliotekar: Shkolla Kombëtare e Bibliotekonomisë
Për të përmbushur nevojat e sistemit kombëtar bibliotekar janë hapur 2 (dy) programe të Shkollës Kombëtare të Bibliotekonomisë (2016-2018; 2017-2019), shoqëruar për herë të parë edhe me programe të standardizuara të mbështetura në zhvillimet e fundit të bibliotekonomisë dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. Zhvillimi i programeve mësimore u ndikua ndjeshëm edhe nga moria e zhvillimeve teknologjike, duke bërë të domosdoshme praninë e moduleve universale bazë, si: organizimi i informacionit, organizimi i dijes, mjetet e kërkimit të informacionit në epokën digjitale, biblioteka Digjitale, aftësimi në media e informacion, teknologjia e informacionit dhe komunikimit në arenën digjitale, të cilat zunë një vend të konsiderueshëm në të.

Tabela 2: *Numri i pjesëmarrësve në shkollën kombëtare të Bibliotekonomisë*

Shkolla Kombëtare e Bibliotekonomisë	Numri i pjesëmarrësve
Programi 2016-2018	**43**
Programi 2017-2019	**39**

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

6. Qëllimi i strategjisë: Fuqizimi i Qendrës së Trajnimit Bibliotekar

Objektivi specifik 6.1: Aftësimi maksimal i bibliotekarëve për implementimin e teknologjive të reja në bibliotekë, përdorimin e burimeve të informacionit elektronik, katalogut elektronik, Internetit, kërkimin e burimeve digjitale etj.
Qendra e Trajnimit Bibliotekar ka përfshirë në programet e saj, si përvojat më të përparuara/më të mira në shërbimet bibliotekare, ashtu edhe prezantimin e standardeve profesionale shoqëruar me praktikat përkatëse. Në programet e kualifikimit të vijueshëm profesional **prej vitit 2002** pjesa më e madhe e moduleve lidhen me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit dhe Aftësimin në Informacion. Pjesëmarrësve, - nga i të gjithë sistemi bibliotekar kombëtar, -iu janë shpërndarë materialeve dhe/ose standarde profesionale të përkthyera në shqip.

***Tabela 3**: Numri i pjesëmarrësve në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit dhe Aftësimin në Informacion.*

VITI	PJESËMARRËS	TEMAT
2018	**84**	**24**
2019	**109**	**17**
2020	**59**	**24 (online)**

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Objektivi specifik 6.2: Përfshirja e aftësimit të nxënësve e studentëve në forma e mënyra të ndryshme, si: kurse orientuese për përdorimin e bibliotekës, burimeve të informacionit, katalogut elektronik.
Në strategjinë institucionale i është kushtuar vëmendje e veçantë Aftësimit në Informacion të nxënësve të shkollave të mesme e nëntëvjeçare dhe studentëve në forma e mënyra të ndryshme, si: kurse orientuese për përdorimin e bibliotekës, burimeve të informacionit etj. duke u përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në njohjen dhe edukimin e përdoruesve të rinj të bibliotekës me organizimin e informacionit bibliografik të koleksioneve të BKSH-së duke u fokusuar te integrimi me risitë që sjell ri konfigurimi i infrastrukturës së informacionit. Programi i ñAftësimit në Informacionò realizohet në bashkëpunim me institucionet arsimore të nivelit 9-vjeçar dhe të mesëm; pjesë e këtij programi janë edhe studentë të Universitetit të Tiranës të nivelit Bachelor dhe Master apo të institucioneve private arsimore të Tiranës.

***Tabela 4**: Numri i pjesëmarrësve në programet e Aftësimit në Informacion nga institucionet arsimore .*

VITI	Veprimtari	Pjesëmarrës
2018	9	432
2019	7	143
2020	2	53

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

7. Qëllimi i strategjisë: Hapësira të reja leximi

Objektivi specifik7.1: Çelja e Sallës Franceze të Leximit.
Në Mars të vitin 2018 u çel *Salla Franceze e Leximit*, një mjedis i ri bashkëkohor në ndihmë të gjithë studiuesve, studentëve dhe lexuesve të kryeqytetit, si edhe një hapësirë e re për veprimtari të shumta kulturore në shërbim të shkëmbimit të dijes dhe informacionit (realizuar me mbështetjen e Ambasadës Franceze, Aleancës Franceze në Tiranë, si dhe Ministrisë së Kulturës).

Objektivat/Prioritetet e BKSH për vitet 2020-2021

Më poshtë janë renditur objektivat/prioritetet kryesore të Bibliotekës Kombëtare (miratuar nga Këshilli Shkencor i BKSH, si dhe Ministria e Kulturës, në Dhjetor 2019).
Përcaktimi i disa prej objektivave është i kushtëzuar prej faktit se viti 2020 ishte viti i 100- vjetorit të BKSH. Fatkeqësisht në disa raste, pandemia që karakterizoi vitin 2020 dhe fillimin e vitit 2021, qe një faktor kushtëzues e pengues për disa prej nismave të parashikuara.

Objektivat/prioritet kryesore në strategjinë e BKSH për dyvjeçarin 2020/2021, janë:

1. Festimi i 100-vjetorit të krijimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

BKSH hartoi një program të detajuar veprimtarish: ekspozita, konferenca shkencore, konferenca jubilare, forume, ligjërata etj., për festimin e 100-vjetorit të krijimit të saj. Për fat të keq një pjesë e këtij programi, në ato komponentë që parashikonin pjesëmarrjen e publikut, nuk mundi të realizohej për shkak të pandemisë.

Megjithatë u realizuan me sukses dy prej ngjarjeve më të rëndësishme të parashikuara:

- Ekspozita **"Librat e ndaluar në kohën e komunizmit"** (e organizuar në bashkëpunim me Arkivin e Lartë të Shtetit), shkurt 2020.
- Ekspozita **"Verba volant, Scripta manent – Thesare të Biliotekës Kombëtare",** e organizuar me rastin e 100-vjetorit të krijimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, nga data 22 Tetor deri më 11 Nëntor 2020, nga BKSH dhe COD (Qendra për Hapje dhe Dialog) e Kryeministrisë.

Me rastin e hapjes së kësaj ekspozite u zhvillua ceremonia zyrtare për kremtimin e 100- vjetorit, me pjesëmarrjen e Kryeministrit.

2. Për një Vizibilitet publik më të madh nga ana e BKSH.

Ky vazhdon të mbetet një ndër objektivat kryesore të BKSH-së, nëpërmjet të cilit synohet që përmes një kalendari të pasur veprimtarish dhe një bashkëpunimi intensiv me median, të maksimizohet vizibiliteti i vlerave, i pasurisë dhe potencialit të madh që ka Biblioteka Kombëtare, si një nga institucionet kryesore kulturore, jo vetëm si mbartëse e kujtesës kombëtare, por para së gjithash, i jetës kulturore e intelektuale në vend.

Pavarësisht pengesave të krijuara nga pandemia, gjykojmë se vetë numri i madh i vizitorëve, por sidomos mbulimi i jashtëzakonshëm nga ana e medias, sidomos i ekspozitës kushtuar thesareve të BKSH-së, më e madhja e organizuar ndonjëherë nga BKSH, kanë shërbyer për përmbushjen e këtij objektivi, që megjithatë vazhdon të mbetet një ndër objektivat më të rëndësishëm edhe për vitin në vazhdim.

3. Hapja ndaj publikut.

Hapja ndaj Publikut përbën për Vitet 2020/21 një ndër prioritetet kryesore.

Realizimi i këtij objektivi lidhet para së gjithash më vënien në jetë të programit të krijimit të Bibliotekës Digjitale, e cila ka potencialin të krijojë një revolucionarizim të vërtetë të raporteve me lexuesin. Qëllimi është që pasuria e madhe që mban kjo bibliotekë të bëhet pronë e lexuesit dhe e studiuesit. Nëpërmjet Bibliotekës Digjitale lexuesi do ketë mundësi të ketë në dispozicion librat dhe materialet bibliotekare kudo që të ndodhet, pa qenë nevoja që të vijë fizikisht në bibliotekë.

Për më tepër, në kushtet e mungesës së hapësirës nga e cila vuan aktualisht BKSH, kjo përbën mënyrën më efikase për tâu vënë në shërbim të lexuesit. Për më shumë informacion lidhur me këtë objektiv, që do vazhdojë të përbëjë prioritetin kryesor të BKSH edhe në vitin e ardhshëm shih raportimet nga ana e Sektorit të Bibliografisë, prej të cilit varet digjitimi.

Gjykojmë se është bërë deri diku një punë e mirë, e shoqëruar dhe me një fushatë të vazhdueshme tëinformimit të publikut, por për arsye që do të trajtohen hollësisht në pyetjen 4.2.1 të piramidës së pyetjeve, ky proces nuk është i matshëm nga grupi i auditimit pasi mungojnë planifikimet vjetore të listave të digjitimit si dhe normat ditore të kapacitetit skanues të materialeve bibliotekare. Gjykojmë se për shkak të prioritetit që ka marrë ky objektiv, Sektori i digjitimit, ka nevojë të fuqizohet, gjë që do pasqyrohet në propozimin për një organikë të re, që BKSH do tâi paraqesë Ministrisë së Kulturës për miratim në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021.

Në vijim paraqesim treguesit e përdoruesve online dhe interesit të leximit/shfletimit online në BKSH.

Tabela 5: Treguesit për shërbimet online dhe në mjediset e BKSH

VITI	Anëtarë	Frekuentues fizikë brenda mjediseve	Shërbimi i materialeve brenda mjediseve	Përdorues online të faqes së BKSH-së	Vizita online në faqen BKSH-së	Përdorimi i rubrikave të faqes online	Shënime
2018	1.731	82.414	89.212	65.181	173.913	251.905	Shërbimi i kufizuar brenda mjediseve
2019	2.347	132.462	104.741	60.925	173.124	254.649	Shërbimi i kufizuar brenda mjediseve
2020	1.586	30.002	20.306	62.057	259.314	434.979	Pandemia COVID -19

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

4. Ri konceptimi i Aneksit të BKSH (Biblioteka e Vjetër)

Ri konceptimi dhe ristrukturimi i ñaneksitò të BKSH-së, ose e quajtur ndryshe **Biblioteka e Vjetër,** është një proces me rëndësi për të cilën ka filluar puna me intensitet që gjatë pjesës së dytë të vitit 2020. Qëllimi është shndërrimi i kësaj pjese të BKSH-së në një strukturë moderne me ñfonde të hapuraò, ku publiku të ketë mundësi të shohë dhe të përdorë atë koleksion aq të pasur me libra e dorëshkrime që për dekada të tëra ka mbetur i panjohur, i mbyllur pas dyerve të kyçura.
Objektivi konkret është që, krahas punës për ri konceptimin arkitekturor të gjithë godinës për ta bërë atë sa më funksionale e tërheqëse për lexuesin, të mund të hapen për publikun një sërë sallash të reja, krahas Sallës ñFrancezeò dhe asaj ñGjermaneò që tashmë funksionojnë. Fjala është për hapjen e Sallës ñHerbertò, në të cilën do të rindërtohet një ndër bibliotekat e para publike të ngritura në Shqipëri nga personaliteti i njohur anglez Aubrey Herbert, mik i madh i Shqipërisë.
Po ashtu, duhet të përfundojë Salla e ñGjuhëve të Rrallaò (librat në greqishten e vjetër dhe në latinisht), si dhe Salla e ñBibliofilisëò.
Ndërkohë do të vazhdojë puna për krijimin e Sallës ñItalianeò dhe asaj ñOrientaleò (të librave dhe dorëshkrimeve osmane, arabe dhe persiane).
Në datën 07.02.2020, në mbledhjen e parë të Këshillit të ri Shkencor të BKSH-së, për vitin 2020, ky projekt u miratua si një ndër prioritetet më të rëndësishme ku do të përqendrohet puna e Bibliotekës Kombëtare.
Ky projekt synon krijimin e kushteve për sistemimin, ruajtjen dhe krijimin e një sistemi modern informimi për këtë pasuri e cila deri më sot ka mbetur në një pjesë të madhe e paaksesueshme për publikun.
Rikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare) u finalizua me lidhjen e kontratës publike të shërbimit në datën 03.12.2020 ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ñXò ShPK i përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së

Kulturës, z.X dhe nga përfaqësuesi i operatorit nga Administratori z.X në shumën prej 44,636,849 lekë me TVSh ***me afat përfundimi deri në Dhjetor të 2022***.

5. Sektori i restaurimit të BKSH.

Ky sektor jetik për BKSH-në ka nevojë për tâu fuqizuar e modernizuar që të mundë të përballojë kërkesat. Duke pasur parasysh gjendjen problematike në të cilën ndodhet ky sektor në BKSH, si dhe rëndësinë që ka restaurimi profesional kur bëhet fjalë për libra e dorëshkrime të vjetra, fuqizimi dhe modernizimi i këtij sektori përbën tashmë një domosdoshmëri.

Objektivi është krijimi i një laboratori modern për restaurimin e librave dhe të dorëshkrimeve, gjë që deri më sot mungon. Në këtë drejtim është filluar bashkëpunimi me Bibliotekën e Strasburgut, Francë, me të cilën është planifikuar të lidhet një marrëveshje që parashikon një program të përgatitjes profesionale të restauratorëve të rinj, si dhe identifikimin e nevojave. Gjatë vitit 2020 u zhvillua në këtë drejtim me ndihmën e tyre një kurs formimi 2-javor në ambientet e BKSH-së.

Ndërkohë i është bërë kërkesa Ministrisë së Kulturës nga BK, për akordimin e fondeve për krijimin e një laboratori, e shoqëruar me specifikimet teknike për pajisje bashkëkohore.

6. Rritja e bashkëpunimit me jashtë.

*Rritja e bashkëpunimit me jashtë,*përbën një prioritet, duke qenë një domosdoshmëri për funksionimin e BKSH në përputhje me standardet bashkëkohore ndërkombëtare. Deri pak kohë më parë kontaktet e BKSH me simotrat e saj në Evropë, e aq më shumë me institucionet ndërkombëtare që mbështesin përgjithësisht bibliotekat kombëtare, kanë qenë minimale. Ky bashkëpunim parashikohet të zhvillohet në disa plane:

a.Bashkëpunimi me simotrat e BKSH-së në Rajon, në Evropë e më tej, për të kërkuar ndihmën e tyre profesionale, si dhe duke bashkëpunuar me to në projekte të përbashkëta. Vitin që shkoi ne filluam bashkëpunimin me Bibliotekën e Strasburgut, Francë, sidomos në fushën e restaurimit. Jemi duke punuar për të pasur marrëveshje bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare të Italisë,atë të Greqisë, të Turqisë si dhe me Library of Congress, SHBA.

b. Përpjekje për të siguruar financimin nga jashtë të projekteve të BKSH-së, sidomos nga ana e Bashkimit Evropian. Gjykojmë se kjo është plotësisht e mundur dhe do të sillte mjaft avantazhe, por kërkon disa ndryshime në kuadrin ligjor të BKSH.

c. Bashkëpunimi me ambasadat e huaja të vendosura në Tiranë, si dhe me institucione të tjera ndërkombëtare, për të bërë të mundur ardhjen në BKSH të një sërë figurash të njohura të jetës kulturore evropiane.

d. Prioritet do jetë gjithashtu gjetja e mënyrës për të afruar pranë BKSH-së figurat kryesore ndërkombëtare në fushën e studimeve shqiptare.

Në këtë drejtim deri tani janë realizuar:

a) Bashkëpunimi me simotrat e BKSH në Rajon;
b) Biblioteka Kombëtare u angazhua që të ishte pjesë e projektit rajonal ñEvropian Cities Cultural Bridge Over Time and Spaceò, por për shkak të pandemisë projekti nuk mundi të zhvillohej më tej;
c) Protokolli i bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës *Pjetër Bogdani,* nuk mundi të zhvillohej sipas kalendarit të përbashkët kulturor Shqipëri-Kosovë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.
d) Ndërkohë janë zhvilluar takime me disa përfaqësi diplomatike në Tiranë (Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadën Franceze, Ambasadën Turke, Ambasadën

Suedeze, Ambasadën Greke, Ambasadën e Azerbajxhanit, Ambasadën Italiane etj.), duke diskutuar për një sërë nismash konkrete.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: Menaxhimi i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare ka hasur vështirësi të cilat kanë ardhur si rezultat:
-I mungesës ndër vite të hartimit të politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, dhe mos funksionimit prej vitesh të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave si organ këshillimor për MK për përmirësimin e aktivitetit të BKSH-së.
-Në Draft Strategjinëpër vitet 2016-2021, një pjesë e objektivave të saj nuk kanë mbështetje financiare sikurse është problematika afatgjatë e krizës së krijuar nga mungesa e hapësirave depozituese, të cilat sollën ndërprerje të shërbimeve ndaj përdoruesve nga viti 2017, si dhe problematika në sigurinë e koleksioneve që janë pjesë e trashëgimisë kulturore ndër vite gjë që ka ndikuar në mbylljen e një sërë aktiviteteve të saj. Këtë e dëshmon fakti që dhe në strategjinë e MK për vitin 2019-2025, miratuar me VKM nr.903, datë 24.12.2019, megjithëse në zbatim të misionit të saj ka të parashikuar pas shumë vitesh hartimin e projekt idesë për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore ku përfshihet dhe projekti për ngritjen e një Biblioteke të re Kombëtare, nuk ka gjetur zbatim dhe BKSH vazhdon të zhvillojë aktivitetin e saj në një godinë të amortizuar dhe me shumë risqe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
-Mungesës së planeve strategjikë e operacionale vjetorë dhe mujorë nga BKSH, për periudhën në auditim, të cilat janë vendimtare për të vlerësimin dhe arritjen e rezultateve të parashikuara, si dhe për të evidentuar shmangiet nga objektivat e vendosura me prioritet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, pika 6.1.3, ku citohet se: Njësitë publike për të ushtruar funksionin e kontrollit duhet që aktivitetet strategjike të markohen me treguesit e performancës dhe objektiva të matshëm/targeta. .*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 27-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1. Konkluzioni:
Mos hartimi i një strategjie kombëtare për BKSH-në nga MK, mos funksionimi i Këshillit Kombëtar të Bibliotekave si organ këshillimor dhe mbështetës në hartimin e politikave, analiza e dobët e gjendjes së sistemit bibliotekar nga struktura drejtuese në MK, si dhemungesae planeve strategjikë operacionale vjetorë dhe mujorë, kanë sjellë një performancë të dobët në tërësi të Bibliotekës Kombëtare. Këto veprime dhe mosveprime kanë ndikuar negativisht në veprimtarinë e sistemit bibliotekar dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò.

1.1.Rekomandimi:Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, si organ këshillimor pranë MK, të rrisë përgjegjësinë dhe të forcojë rolin e tij në drejtimin menaxherial nëpërmjet autoritetit që i jep ligji gjatë marrjes dhe shqyrtimit të problematikave në fushën e zhvillimit të bibliotekave duke dhënë orientime të duhura dhe ndikuar në përmbushjen e objektivave strategjike 2019-2025, si dhe në rritjen e performancës të institucionit të BK dhe të sistemit bibliotekar në vend.

Janar2022 e në vijimësi

1.2. Rekomandimi:BKSH në hartimin e strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë së saj, të përcaktojë qartë hartimin e këtij dokumenti që tô shërbejë krijimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese, duke përcaktuar drejt dhe saktë politikat e pasurimit, të zhvillimit dhe të arkivimit të koleksioneve bazuar në standardet bashkëkohore por dhe sigurimin me mbështetjen financiare të këtyre projekteve në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Janar2022 e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Referuar funksioneve dhe detyrave të BK rezulton se në Draft Strategji nuk janë trajtuar me prioritet problematikat e administrimit dhe inventarizimit të materialeve bibliotekare e në veçanti verifikimi i tyre duke përcaktuar politika të qarta për pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve të mbështetura në akte nënligjore si hartimi i një Udhëzimi specifik kryesisht në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e fondeve të BK në kushtet e instalimit të sistemit informatik në BK (Dixhitalizimit të Fondeve të BK), i cili filloi nga viti 1999..*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 27-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Konkluzioni:
BKSH nga rëndësia dhe funksioni që ka: në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore për koleksionet që BK ka të depozituara ndër vite, prej 1920, duhej tõ kushtonte një rëndësi të veçantë dhe të trajtonte me prioritet në objektivat strategjikë të saj administrimin e koleksioneve që përbëjnë fondin e rrallë të BK, për ruajtjen dhe administrimin e tyre. Në kushtet e digjitimit të aktivitetit të BK do të ishte domosdoshmëri, informatizimi i procesit të inventarizimit, për të mbrojtur dhe siguruar pasurinë e trashëgimisë kulturore, që sot rezulton në kushte të vështira depozitimi dhe jashtë çdo standardi ndërkombëtar.

2.1. Rekomandimi: BKSH gjatë hartimit të strategjisë së zhvillimit të institucionit për vitet 2022 e në vazhdim të ketë një nga prioritet kryesore në objektivat e saj, administrimin e materialeve bibliotekare dhe inventarizimin e tyre, duke përcaktuar politika të qarta në lidhje me pasurimin, zhvillimin dhe verifikimin e koleksioneve dhe duke i dhënë një rëndësi të veçantë informatizimit të këtij procesi në kushtet e standardizimit dhe modernizimit të BK sipas standardeve bashkëkohore.

Janar 2022 e në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se një nga objektivat strategjikë të BKSH është modernizimi i Sektorit të restaurimit të BKSH-së, i cili për periudhën në auditim ka punuar në kushte tejet primitive, me pajisje të viteve 30 e 50 të shekullit të kaluar, si rezultat i mos alokimit të fondeve për investime nga MK për periudhën 2018-2019-2020. Gjatë vitit 2020 u zhvillua në këtë drejtim me ndihmën e Bibliotekës së Strasburgut, Francë një kurs formimi 2-javor në ambientet e BKSH-së, për përmbushjen e një nga detyrave kryesore të tij: atë të ruajtjes dhe konservimit fizik të objekteve të trashëgimisë kulturore. Megjithatë krijimi i një laboratori modern me pajisje të specializuara bashkëkohore për realizimin me sukses të detyrave funksionale dhe me rëndësi që ky sektor ka në efektivitetin e performancës së BK-së përbën tashmë një domosdoshmëri dhe nevojë urgjente.*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 27-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3. Konkluzioni: Mungesa e një laboratori modern me pajisje të specializuara bashkëkohore në sektorin e restaurimit të BKSH-së, si rezultat i mosalokimit të fondeve për investime nga MK ka sjellë vështirësi në punën shumë voluminoze dhe të rëndësishme që ky sektor ka në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
3.1. Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masa të menjëhershme për akordimin e fondeve për krijimin e një laboratori modern të shoqëruar me pajisje të specializuara bashkëkohore për realizimin e detyrave në Sektorin e restaurimit të BKSH-së.

Brenda vitit 2022

4.1.1. A ka siguruar BK zbatimin e kuadrit ligjor/rregullator?

Auditimi për këtë qëllim u mbështet në :
-Ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
-Ligjin nr.9616, datë 27.09.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò;
-Ligjinnr.35/2016 ñPër të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me toò;
-Ligjin nr.27/2018, datë 17.5.2018 ñPër Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetëò;
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
-Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò;
-Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò;
-Urdhri i Kryeministrit nr.139, datë 28.03.2014 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò;
-Urdhri Kryeministrit nr.122, datë 17.09.2019 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò;
- Rregullorja e Brendshme e miratuar nga ish Titullari i BK me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010;
- Statuti i BK i miratuar me Urdhrin nr.77, datë 13.02.2015 i ish Titulluarit së Ministrisë së Kulturës;
- Udhëzues i MKRS nr.1, datë 22.09.1992 ñPër seleksionimin e fondit të librave në Bibliotekaò;
- Udhëzues nr. 126prot. , datë 16.08.2011 të Sektorit të Kualifikimit të BKSh-së.
-Draft Strategjinë e BK për vitet 2016-2021 miratuar më 14 Dhjetor 2015 në BK.

Biblioteka Kombëtare është institucioni kryesor i rrjetit kombëtar të bibliotekave në Shqipëri dhe qendra e arkivit të botimeve shqip, e depozitimit të dorëshkrimeve dhe të antikuarit, e veprave të albanologjisë dhe të Ballkanologjisë, materialeve të tjera bibliotekare, dhe si e tillë dhe qendra më e rëndësishme e vendit për grumbullimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e botimeve të huaja, institucioni kryesor bibliografik në shkallë kombëtare. Koleksionet e bibliotekave që përbëjnë trashëgiminë kulturore dokumentare, janë pjesë e pasurisë kulturore kombëtare.
Nisur nga çfarë cituam më lart, struktura përgjegjëse për administrimin, ruajtjen, qarkullimin dhe e spastrimit të fondeve të BK, është ***Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve***, i cili realizon veprimtarinë e tij nëpërmjet mbajtjes, regjistrimit të dokumentacionit përkatës mbi gjendjen dhe lëvizjet e materialeve bibliotekare, kryerjes së inventarit fizik të fondit të Bibliotekës Kombëtare. Gjendja më 31.12.2020 e fondit të BK e cila administrohet nga ky sektor është gjithsej 1,155,557 koleksione bibliotekare të hyra ndër vite.
Sektori ka në organikë të tij, 10 punonjës të ndarë sipas proceseve të punës që kryejnë:
-1 përgjegjës sektori;
-Zyra e pasurimit, shkëmbimit, ekzemplarit të detyruar me 3 punonjës në organikë;
-Komisioni i inventarizimit të koleksioneve me 4 punonjës në organikë;
-Komisioni i spastrimit të koleksioneve me 2 punonjës në organikë.
Sipas Urdhrit nr.139, datë 28.03.2014, ndryshuar me Urdhrin nr.122, datë 17.09.2019 të Kryeministrit ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò, të dhënat sipas organikës, pozicioneve dhe proceseve të punë që kryejnë, diplomës dhe kualifikimeve aktualisht, paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr.6**:** Të dhënat sipas organikës, pozicioneve dhe proceseve të punë që kryejnë.

Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve	**Sipas Organikës dhe proceseve të punës**	**Arsimi**	**Trajnimet**
X	Përgjegjës Sektori	Inxhiniere mekanike	Shkollë dy vjeçare e Bibliotekonomisë, dhe kurs 1 vjeçar në Bibliotekonomi
Zyra e pasurimit, shkëmbimit,			

ekzemplarit të detyruar			
X	Klasifikator	Histori gjeografi	Shkollë dyvjeçare e Bibliotekonomisë, dhe kurs 1 vjeçar në bibliotekonomi.
X	Bibliotekar	Histori- Gjuhë Shqipe gjeografi	Shkollë dyvjeçare në Bibliotekonomi.
X	Bibliotekar	Ekonomiste	Shkollë dy vjeçare në Bibliotekonomi.
Komisioni i inventarizimit të koleksioneve			
X	Bibliotekar	Histori-Gjuhë Shqipe	Shkollë dyvjeçare në Bibliotekonomi.
X	Bibliotekar	Histori Gjeografi	Shkollë dyvjeçare në Bibliotekonomi.
X	Bibliotekar	Histori Gjeografi	Shkollë dyvjeçare në Bibliotekonomi.
X	Bibliotekar	Letërsi	
Komisioni i spastrimit të koleksioneve			
X	Bibliotekar	Gjuhë ï Letërsi Shqipe	Shkollë dyvjeçare e Bibliotekonomi.
X	Ndihmës/bibliotekar	Gjuhë ï Letërsi	
Totali në organikë	**10 punonjës**		

Burimi i të dhënave: Sektori i Burimeve Njerëzore, dhe Shërbimeve Mbështetëse. Përpunoi: Grupi i auditimit

Auditimi i veprimtarisë së këtij sektori u bazua në detyrat funksionale të përcaktuara në Rregulloren Brendshme miratuar në datën 15.09.2010, miratuar nga ish Titullari X, në programet vjetore të punës së tij, si dhe ne dokumentacionin e paraqitur të datës 24.03.2021 nga përgjegjësja e sektorit në përgjigje të pyetësorit të hartuar nga grupi i auditimit si dhe të intervistave të kryera me punonjës të këtij sektori dhe me të tjerë sektorë mbi bazën e të cilit qarkullojnë koleksionet e konkretisht: me Sektorin e Katalogimit, Sektorin e Albano-Balkanologjisë, Sektorin e Koleksioneve dhe me Sektori i Buxhetit dhe i Financës për verifikimin e kontabilizimit në llogaritë financiare të fondit të BK, e konkretisht të dhënave të llog.218 (inventari ekonomik) bazuar në të dhënat e Pasqyrave Financiare për vitet 2018-2020.

Për një gjykim profesional në lidhje me veprimtarinë e këtij sektori në kuadrin e menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, auditimi u fokusua në :

-Politikat e ndjekura në drejtim të organizimit, evidentimit dhe mbajtja e dokumentacionit të administrimit dhe në veçanti të verifikimit të materialeve bibliotekare në BK si në vendet e depozitimit(fond) në godinën qendrore dhe në aneksin e saj.

Si sektor me rëndësi në tërësinë e veprimtarisë së BK, auditimi u përqendrua kryesisht në zbatimin e akteve ligjore për administrimin, dokumentimin e arkivimit dhe ruajtjes të materialeve bibliotekare, politikat e ndërmarra në institucion në drejtim të organizimit të pasurimit dhe të zhvillimit të

koleksioneve, si dhe mbajtja e dokumentacionit përkatës për lëvizjen dhe depozitimin e materialeve bibliotekare si në fondin arkivor dhe nëpër salla.
-Arsimimi dhe trajnimet.
Struktura e ngritur për Zhvillimin e Koleksioneve, veçanërisht komisioni i inventarizimit të koleksioneve, referuar të dhënave të Sektorit i Burimeve Njerëzore dhe Funksioneve Mbështetëse në lidhje me arsimin për punonjësit, dhe ndikimi në rezultatet e punës së sektorit.
-Politikat që ndiqen në institucion për hapjen e sallave të leximit në shërbim të lexuesit që njëkohësisht janë dhe vende depozitimi të librave dhe materialeve të tjera bibliotekare, sa ndikon në organizimin dhe mbajtjen e dokumentacionit në sektor.
-Procedurat e ndjekura për verifikimin(inventarizimin) e librave dhe materialeve të tjera bibliotekare, bazuar në rregulla dhe standarde të përcaktuara ligjore.

Nga auditimi u konstatua se nga Ministria e Kulturës në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, nuk është miratuar asnjë udhëzim specifik në vite ñPër menaxhimin e fondit të sistemit kombëtar të bibliotekave përfshirë këtu kryesisht Bibliotekën Kombëtareò, për vetë specifikën që paraqet procesi i inventarizimit në BK, ku të përcaktohen procedura standarde dhe të ketë gjurmë auditimi për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe spastrimin e materialeve bibliotekare e konkretisht të librit apo dhe të materialeve të tjera bibliotekare si një aktiv me veçori të veçanta (i cili nuk ka afate përdorimi dhe nuk vlerësohet) sikurse aktivet e tjera të cilat kanë afate kohore përdorimi, amortizohen (mbi bazën normave përkatëse të amortizimit), dhe i nënshtrohen, një procesi rivlerësimi në bazë të rregullave dhe të standardeve të kontabilitetit të përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; në ligjin nr.25/2018 datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò; në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Mungesa e politikave dhe udhëzimeve në ndihmë të procesit, mangësia e planeve operacionale dhe strategjikë të sektorit të zhvillimit të koleksioneve dhe moskryerja e monitorimit nga strukturat drejtuese të BK-së, ka sjellë mos realizimin e detyrave funksionale që janë: verifikimi dhe inventarizimi i koleksioneve, proces i cili rezulton i pa kryer ndër vite duke ndikuar në performancën e dobët të këtij sektori. (*Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1. Konkluzioni: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, si strukturë me rëndësi të veçantë në institucion pasi administron, dokumenton dhe kryen verifikimin e materialeve bibliotekare, rezulton se nuk ka menaxhuar me efektivitet dhe efiçensë aktivitetin e tij për faktin e mungesave të politikave afatgjata në drejtim të pasurimit e zhvillimit të koleksioneve të pashqyrtuara nga Këshilli Shkencor dhe rrjedhimisht të pa miratuara nga Titullarët e BK-së. Këto politika jo efektive kanë ndikuar veçanërisht në performancën e dobët të Komisionit të Inventarizimit të Koleksioneve, sektor që në përbërjen e tij nuk ka punonjës *me profil financier*, të cilët janë të domosdoshëm për përpilimin e dokumenteve dhe mbajtjen e regjistrave e verifikimin e koleksioneve dhe do të kishin njohuritë bazë zbatojnë nga kontabiliteti duke kryer njëkohësisht trajnime në fushën e bibliotekonomisë në zbatim të kërkesave të ligjit nr.25/2018, datë 15.05.2018 ñ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, si dhe në Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 ñ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, dhe në ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar. Planet e punës rezultojnë të pa protokolluara, pa analiza të detajuara, pa tregues të matshëm dhe të arritshëm të mbështetura në norma teknike profesionale, duke sjellë mos realizimin e detyrave funksionale në sektorin e zhvillimit të koleksioneve.
1.1. Rekomandimi : BKSH të hartojë planin vjetor të veprimtarisë së institucionit, të përbërë nga planet vjetore të sektorëve të BK-së, në bazë të funksioneve dhe specifikave që ata kanë, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë mbështetjes në akte nënligjore si udhëzimeve specifike për

Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve, të cilat të shqyrtohen nga Këshilli Shkencor për një gjykim më profesional me qëllim që objektivat të jenë të realizueshme dhe të monitorueshme.

Janar 2022 e në vijimësi

Si është organizuar procesi i mbajtjes së të dhënave, ruajtja e spastrimi i fondit të BK, pasurimi i tijnga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve?

Ky proces bazohet në:

-Tekstin shkollor ñKoleksionet e bibliotekësò, të përgatitur nga ish punonjës të Sektorit të Studimeve dhe të Kualifikimit në vitin 2002, dhe të pa miratuara në institucion;

-Udhëzimine MKRS me nr.1, datë 22.09.1992 ñPër seleksionimin e fondit të librave në bibliotekaò;

-Udhëzimi i BK datë 16.08.2011 ñMbi spastrimin e koleksioneve të bibliotekësò;

-Rregulloren e Brendshme të funksionimit të BKSH-së, e miratuar nga ish Titullari i BK me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010, ku janë përcaktuar përmbajtja dhe organizimi i punës së Sektorit të zhvillimit të koleksioneve e detajuar me modele të dokumenteve të administrimit të koleksioneve;

-Udhëzime dhe standarde të IFLA-së, dhe ISBD (The International Federation of Library Associations and Institutions, International Standard Bibliographic Discription), për referenca të standardeve në procesin e zhvillimit dhe të përshkrimin bibliografik të koleksioneve;

-Rregullore e verifikimit të fondeve, përgatitur nga BK viti 1986.

1.Dokumentimi dhe regjistrimi në libra i të dhënave të lëvizjes së Fondit të BK;

Bibliotekashërben si koleksion librash, periodikësh, bazë të dhënash të materialeve të tjera bartëse të informacionit të organizuara dhe që vihen në shërbim të përdoruesve. Koleksionet e bibliotekës janë burime informacioni dinamike.

Burimete hyrjes së materialeve bibliotekare janë:

a-Dorëzimi i detyruar i5 kopjeve pa shpërblim për çdo botim nga të gjithë botuesit dhe entet botuese që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, në bazë të nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr.9616, datë 27.09.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar .

b-Në bazë të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 27/pika 11, neni 4, neni 19, institucioni për zhvillimin e koleksioneve kryen dhe:

- Blerje nga institucioni;
- Shkëmbim ndërmjet Bibliotekave;
- Dhurimi fizik ose OJQ etj.

*Referuar të dhënave nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve dhe evidencave të Sektorit të Financës dhe Buxhetit rezulton se nga BKSH **nuk janë kryer blerje të libraveprej vitit 2012** (urdhër pagesanr.217, datë 07.12.2012 nga buxheti i shtetit), e në vazhdim si rezultat i mos akordimit të fondeve buxhetore nga Ministria e Kulturës, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për fonde të bëra nga BK si më poshtë:

-Kërkesë buxhetie BK drejtuar MK, për vitin 2018 me nr. 140/3 datë 08.08.2017;

-Kërkesë buxhetie BK drejtuar MK, për vitin 2019, me shkresën nr.431/1, datë 20.08.2018;

-Kërkesë buxhetie BK drejtuar MK, për vitin 2020 me shkresën nr.276/1, datë 18.04.2019;

Kryesisht hyrjet e librave dhe pasurimi i fondit bibliotekar, për periudhën në auditim ka ardhur nga dorëzimi i kopjeve të detyruara në bazë të nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr.9616, datë 27.09.2006ò, i ndryshuar.

-Nga të dhënat e Sektorit e Zhvillimit të Koleksioneve dhe Sektorit të Katalogimit rezultojnë se për periudhën 2018-2020, nuk janëdepozituar 5 kopje të detyruara nga shtëpitë botuese në zbatim të bazë të nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr.9616, datë 27.09.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, të cilët janë si më poshtë :

Dituria=109 tituj; Bota Shqiptare =98 tituj; Argeta –LMG=67 tituj; Enja =84 tituj; Akademia e Shkencave e Shqipërisë=5 tituj; Akademia e Studimeve Albanologjike=21 tituj; Ombra –GVG=75 tituj; Albjuris=33 tituj; Jupiter=2 tituj; Aleph=1 titull; ëestprint=19 tituj.

Në total janë 514 tituj librash me tematikë të ndryshme artistike, akademike, histori etj., të pa dorëzuara në fondin e BK, referuar të dhënave nga Sektori i Katalogimit dhe Zyra e Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Numrave Ndërkombëtare të Standardizuar (ISBN). Nga ana e institucionit janë dërguar kërkesa për depozitim të kopjeve të detyruara referuar të dhënave të email-it zyrtar të institucionit, për periudhën objekt auditimi por pa përgjigje të subjekteve botues.

-Gjithashtu referuar situacionit të shpenzimeve të mbajtur nga Sektori i Financës dhe i Buxhetit në BK, me përfaqësues të Degës së Thesarit Tiranë për vitin 2020 të realizuara nga BK, në bazë të fondeve të vëna në dispozicion nga Ministria e Kulturës, rezultoi se: për llogari të institucionit janë depozituar fonde për BK për blerje librash Albano-Balkanologjik nga z. X, shtetase shqiptare me banim në SHBA në shumën 40 mijë dollarë ose 3,704,573 lekë, në Gusht të vitit 2009. Sot aktualisht në thesar gjenden në shumën prej 3,624,573 lekë, fonde të pa përdorura nga kjo shumë, pasi nuk realizohen blerje librash për Albano-Balkanologjinë jashtë vendit, nga BK, si pasojë e pengesës ligjore në zbatim të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006ò Për prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar me ligjin nr.10238, datë18.02.2010, kreu IX.

Konkretisht në zbatim të Ligji nr. 8576, datë 3.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenit 27, paragrafi i dytë i pikës 11, citohet se: *Biblioteka Kombëtare bën blerje dhe huazime ndërkombëtare të materialit bibliotekar me fondin e veçantë buxhetor;*

-Biblioteka Kombëtare për të realizuar pasurimin e koleksioneve me karakter albano-balkanologjik kryen blerje materialesh bibliotekare të botuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të mbështetura në Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Mbështetur në ligjin Nr. 9616 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar me ligjin Nr. 10238, datë 18.02.2010, Kreu VII ñIdentifikimi i libritò, neni 21, **"***Në çdo libër të botuar dhe të shtypshkruar në Republikën e Shqipërisë duhet të shënohen dëftuesit e mëposhtëm*ò, ku ndërmjet 15 elementëve identifikues të librit, në germën ñgjò të po këtij neni është përcaktuar edhe ñçmimi**",** ndërkohë që si mbas Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, **librat i nënshtrohet prokurimit publik**.

Mbështetur po në ligjin Nr. 9616 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar me ligjin Nr. 10238, datë 18.02.2010, *Kreu IX "Çmimi i shitjes së librit në publik": citohet se:*

ñ*Çdo person fizik ose juridik, që boton ose importon libra, duhet të caktojë një çmim për shitjen e tij" (nenin 31);*

"Çmimi i shitjes në publik bëhet i njohur publikisht, duke u shënuar në mbulesën e jashtme të librit me shtyp ose mbi etiketim. Në rast të mbi etiketimit, etiketa duhet të mbajë edhe emrin e botuesit. Në rastin e botimeve me "këmishë" çmimi shtypet ose mbi etiketohet edhe në të" (nenin 33);

"Shënimi fillestar i çmimit të shitjes në publik të librit është detyrë e botuesit dhe e importuesit" (nenin 34).

Në mbështetje të neneve të parashtruara në Ligjin e Parlamentit Shqiptar (Ligjin Nr. 9616 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar), ñBlerja e librit/libraveò duhet të përjashtohet nga procedurat e prokurimit publik, pasi përderisa çmimi i njësuar vendoset/shënohet nga botuesit në çdo botim, del qartë që blerja e librit nuk ka përse tô nënshtrohet prokurimit publik. Në këtë rast procedurat e prokurimit janë fiktive. Për këtë është bërë edhe kërkesë nga ish Titullari i BKSH z. X me nr.184. prot. datë 09.09.2015, drejtuar Ministrit të Kulturës, për zgjidhje ligjore të problemit dhe konkretisht për lejimin e Bibliotekës kombëtare në kryerjen e procedurave të prokurimeve të drejtpërdrejta për ñBlerje librashò, jashtë Shqipërisë në fushën e Albano- Ballkanologjisë. Kjo kërkesë nuk ka marrë zgjidhje ende në ditët e sotme, megjithëse nga Ministria e Kulturësështë

trajtuar në projekt-ligjin e vitit 2018, ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. Nr. 9616 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, konkretisht neni 23, pika 4, citohet se:
Në kuptim të pikës 3 të nenit 17, të këtij ligji, përjashtimi i blerjes së librit nga procedurat e prokurimit publik, do të bëhet pasi të hyjnë në fuqi ndryshimet e nevojshme në ligjin 9643/2006 "Për prokurimin publik në RSH".

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për periudhën në auditim, BKSH nuk ka kryer pasurim të fondit bibliotekar, si rezultat i mungesës së fondeve të alokuara nga Ministria e Kulturës për BK, në kundërshtim me nenin 27, paragrafi i dytë i pikës 11, të Ligjit 8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në RSHò, ku përcaktohet se: *Për të realizuar pasurimin e koleksioneve me vlerë kombëtare, Biblioteka Kombëtare kryen blerje me fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit*. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të institucionit, të dokumentuara në PBA-të përkatëse të BK-së, ku Ministria e Kulturës për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor, teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në bazë të rekomandimeve të Këshillit Kombëtar të Librit dhe të Nxitjes së Leximit, të përcjella nga ministri*, duhet të kishte krijuar fondet përkatëse në buxhetet respektive për blerjen e një minimumi të titujve të botuar dhe të shtypshkruar në vend*, veprime në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò. Ky minimum përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Konkluzioni:
Si pasojë e mungesës së fondeve nga Ministria e Kulturëspër blerje librash albanologjikë prej vitit 2012, si dhe rezultat i pengesave ligjore të rrjedhura nga zbatimi i ligjit 9643, dt. 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, ku procedurat e prokurimit janë fiktive, në pamundësi edhe të përdorimit të donacioneve të dhëna nga shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë, pikërisht për arsyet e cituara, nuk është arritur të bëhet pasurimi i koleksioneve bibliotekare me libra albano-balkanologjikë, duke sjellë një performancë të dobët të institucionit kryesor kulturor në Shqipëri, BKSH-së, në pasurimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.
Shtimi i fondit të materialeve bibliotekare për periudhën në auditim ka ardhur nga dhurata individuale apo institucionale vendase apo të huaja, dhe nga depozitimet e kopjeve të detyruara të shtëpive botuese në bazë të marrëveshjeve të lidhura me BK, në zbatim të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò, neni 41, 42 marrëveshje që kanë rezultuara pa penalitete në mbrojtje të interesave të BK, për rastet e mosdorëzimit të kopjeve të detyruara nga entet botuese.

2.1. Rekomandimi: Ministria e Kulturës në vijim të marrë masa dhe të miratojë në bazë të kërkesave vjetore për buxhet të Bibliotekës Kombëtare, fonde për investime, duke vendosur me prioritet fondet për blerje ndërkombëtare librash për Albano-Balkanologjinë që do tô shërbejnë pasurimit të koleksioneve bibliotekare duke kontribuar në shtimin e vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Janar 2022 dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në mbështetje të neneve të parashtruara në Ligjin nr. 9616 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar ñBlerja e librit/libraveò duhet të përjashtohet nga procedurat e prokurimit publik, përderisa çmimi i njësuar vendoset/shënohet në ì do botim nga botuesit/entet botuese që zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Meqenëse çmimi i shitjes në publik bëhet i njohur publikisht, duke u shënuar në mbulesën e jashtme të librit me shtyp ose mbi etiketim (edhe në rastet e importimit ì do person fizik

ose juridik që importon libra duhet të caktojë një çmim për shitjen e tij; nuk ka libër në librari pa etiketim të çmimit) del qartë që blerja e librit nuk ka përse tëi nënshtrohet prokurimit publik. Në këtë rast procedurat e prokurimit do të rezultonin fiktive. Për këtë është bërë kërkesë nga ish ï Titullari i BKSH-së z. X me nr. 184. prot., datë 09.09.2015, drejtuar Ministrit të Kulturës, për zgjidhje ligjore të problemit të blerjes së librave në Shqipëri. Kjo kërkesë nuk ka marrë ende zgjidhje në ditët e sotme, megjithëse nga Ministria e Kulturës është trajtuar në projekt-ligjin e vitit 2018 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9616 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, konkretisht neni 14 dhe nenin 23, pika 4. Gjithashtu për BK paraqet pengesë juridike edhe pasurimi i koleksioneve bibliotekare nëpërmjet ñblerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekarò (parashtruar në paragrafin e dytë të pikës 11 të nenit 27 të Ligjit nr. 8576, datë 3.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar): librave me karakter albano-balkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë nga botues të ndryshëm në vende të ndryshme, si dhe veprat e autorëve shqiptarë të botuar jashtë vendit, të cilat nuk gjenden në rrjetin e librarive në vend. (Legjislacioni në fushën e prokurimit publik në fuqi nuk lejon Bibliotekën Kombëtare në kryerjen e procedurave të prokurimeve të drejtpërdrejta për ñBlerje librashò jashtë Shqipërisë në fushën e Albano-Balkanologjisë).
-Pasurimi i koleksionit bibliotekar për periudhën në auditim ka ardhur nga dhuratat individuale e institucionale dhe nga dorëzimi i detyrueshëm i (5 pesë) kopjeve për çdo botim që duhet të bëjnë të gjithë botuesit apo entet botuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, pa shpërblim, në zbatim të bazë nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9616, datë27.09.2006 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëê, proces i cili ka rezultuar i mangët pasi u konstatua se mungojnë 514 tituj librash me karakter artistik, akademik e historik, të pa dorëzuara në fondin e BK dhe me mungesë penalitetesh - detyrë kjo e Ministrisë së Kulturës, dhe veprime në kundërshtim me nenin 48, pika 1, b, të Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar me Ligjin Nr.10238, datë 18.02.2010ò. Gjithashtu, dorëzimi i kopjeve të detyruara nga entet botuese është ndërprerë përkohësisht nga BK me një njoftim zyrtar të kryer në 10.03.2020 për periudhën 10.03.2020 ï 11.05.2020 si rezultat i situatës pandemike Covid-19. Në vijim dorëzimi i kopjes së detyruar ka vijuar normalisht. (*Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1. faqe 47-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3. Konkluzioni: Meqenëse çmimi i shitjes së librit në publik bëhet i njohur publikisht, duke u shënuar në mbulesën e jashtme të librit me shtyp ose mbi etiketim (edhe në rastet e importimit ì do person fizik ose juridik që importon libra duhet të caktojë një çmim për shitjen e tij; nuk ka libër në librari pa etiketim të çmimit) del qartë që blerja e librit nuk ka përse tëi nënshtrohet prokurimit publik.Në këtë rast procedurat e prokurimit publik për blerjen e librave do të rezultonin fiktive.Gjithashtu për BK paraqet pengesë juridike edhe pasurimi i koleksioneve bibliotekare nëpërmjet ñblerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekarò (parashtruar në paragrafin e dytë të pikës 11 të nenit 27 të Ligjit nr. 8576, datë 3.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar): librave me karakter albano-balkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë nga botues të ndryshëm në vende të ndryshme, si dhe veprat e autorëve shqiptarë të botuar jashtë vendit, të cilat nuk gjenden në rrjetin e librarive në vend.Legjislacioni në fushën e prokurimit publik në fuqi nuk lejon Bibliotekën Kombëtare në kryerjen e procedurave të prokurimeve të drejtpërdrejta për ñBlerje librashò jashtë Shqipërisë në fushën e Albano-Balkanologjisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në varfërimin e fondit të koleksionit bibliotekar

3.1. Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masa për përcjelljen për miratim të projekt-ligjit të vitit 2018 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9616 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò, ku parashtrohet përjashtimi i blerjes së librit në Shqipëri nga procedurat e prokurimit publik.

Janar 2022 dhe në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masa për hartimin e kuadrit ligjor që të mundësojë pasurimin e koleksioneve bibliotekare të BK nëpërmjet ñblerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekarò të librave me karakter albano-balkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë.

Janar 2022 dhe në vijimësi

3.3. Rekomandimi: BKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të kryejnë përmirësimet e nevojshme në kontratën tip të lidhur mes Zyrës së Agjencisë së Numrit Ndërkombëtar Standard për Librin (ISBN) dhe enteve botuese/botuesit; në bazë të Urdhrit nr. 433, datë 30.10.2020 ñPër miratimin e rregullores së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Libritò duke shtuar: masën e penalitetit për mos depozitim të kopjeve të detyruara brenda afateve ligjore deri në ndërprerje dhëniesh të ISBN dhe CIP enteve botuese/ botuesit, nga BK, si dhe të miratohet struktura e cila do të ndjekë dhe arkëtojë detyrimet për subjektet që rezultojnë debitorë.

Janar 2022 dhe në vijimësi

3.4. Rekomandimi: BKSH të përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës 2 (dy) herë në vit informacion për botuesit/entet botuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk kanë depozituar pranë saj 5 (pesë) kopjet e detyruara në zbatim të bazë nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9616, datë27.09.2006 ñPër Librin në Republikën e Shqipërisëò.

Janar 2022 dhe në vijimësi

Sipas burimit të hyrjes dhe llojit të materialeve bibliotekare për vitet 2018,2019,2020 në BK paraqiten si më poshtë vijon

Tabela.nr.7. **në lekë**

Viti	Kopje e detyruar Libër shqip		Disertacione		Libër dhuratë		Periodik shqip		Periodik i huaj		Totali	
	Njësi	Vlerë	Njësi	Vlerë	Njësi	Vlerë	Njësi	Vlerë	Njësi	Vlerë	Njësi	Vlerë
2018	11,652	895,6953.65	465	930,000	2,009	3,032,938.12	1,358	1,839,473	124	75,900	15,608	14,835,264.77
2019	12,490	10,018,965.05	347	684,000	1230	1,313,125	983	1,407,984	251	127,700	15,301	13,551,774.05
2020	10,288	8,077,100.05	151	300,000	767	1,100,900	776	1,041,853	176	105,200	12,158	10,625,053.05
Totali	34,430	27,053,018.75	963	1,914,000	4,006	5,446,963.12	3,117	4,289,310	551	308,800	43,067	39,012,091.87

Burimi i të dhënave: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve. Përpunuarnga grupi i auditimit.

Të dhënat e materialeve bibliotekare aktualisht në institucion mbahen ndër vite sipas dy lloj evidencash të cilat realizojnë evidentimin e tyre për çdo njësi fondi.

Dy llojet e evidencave janë:evidenca përmbledhëse ose libri i lëvizjes dhe evidenca individuale ose libri i inventarit.

Për të ruajtur dhe menaxhuar materialet bibliotekare me rëndësi të veçantë ka unifikimi i evidencave dhe përdorimi i njësive të njëjta në të gjithë rrjetin e bibliotekave të vendit.

Njësi bibliotekare quhet çdo njësi fizike pavarësisht nga përmasat dhe çmimi.Në rastin e veprave me vëllime, çdo vëllim është njësi më vete.

Materialet bibliotekare nuk përbëjnë vetëm vlera kulturore por janë dhe materiale të cilat duhet të mbahen dhe evidentohen saktë për çdo njësi .

Libri i lëvizjes ose (evidenca e përgjithshme e të dhënave), jep të dhëna për të gjitha materialet që hyjnë në BK, pra numrin e përgjithshëm, përbërjen sipas degëve të shkencës, dhe sipas llojit të botimeve. Ky libër përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa e parë , përmban libra dhe materiale të tjera që hyjnë në fondin e bibliotekës ;

Pjesa e dytë, përmban libra e materiale të tjera që dalin nga fondi i bibliotekës.

Libri i inventarit pasqyron në mënyrë kronologjike të gjithë materialet bibliotekare të hyra ndër vite në BK, me të dhëna të hollësishme si autori, titulli, numri i vëllimeve, emri i vendit të botimit, viti i botimit, çmimi.

-Në institucion,regjistri themeltar i inventarit të Bibliotekës Kombëtarendër vite përbëhet nga *222 libra inventari* të cilët përmbajnë të dhëna për të gjitha materialet bibliotekare (libër, koleksion periodiku, revistë, gazetë,broshurë,hartë,material audio vizual,etj.) që hyjnënë sasi dhe vlerë dhe vendit ku ato depozitohen të cilët mund të jenë në fondin arkivor, në salla pranë godinës qendrore të BK dhe tek godina e bibliotekës së vjetër(aneksi) tek rruga e Elbasanit.

Librat e inventarit të Bibliotekës Kombëtare sipas llojit të materialeve bibliotekarembahen dhe janë të organizuar si më poshtë :

Fondi arkivit shqip (libër & periodik, material jolibra) *23 libra*. Në librin e parë të fondit të Arkivit është i përfshirë edhe fondi i Antikuarit (pjesërisht). Pjesa tjetër e Antikuarëve është i inventarizuar në libra të tjerë të huaj.

Fondi shqip (libër shqip periodik shqip, material jo libra shqip, si dhe disertacione shqip) *99libra* inventari.

Fondi i huaj (antikuarët dhe dorëshkrimet, sallat me fonde të hapura, libri i huaj, material jolibra, mikrofilmat, antikuarët dhe dorëshkrimet, fondi al-ba i huaj, fondi i standardeve) *100 libra* inventari.

Çdo grup librash i përcaktuar sipas burimit të ardhjes (kopje të detyruar; dhuratë, shkëmbim, blerje), merr një numër lëvizje që fillon në fillim të çdo viti dhe mbyllet në fund të vitit kalendarik (kjo është evidence përmbledhëse që tregon materialet që hyjnë në bibliotekë).

Çdo grup librash merr një numër rendor të caktuar në librin e lëvizjes, i cili pasqyrohet në inventar, në kolonën numri i regjistrimit në librin e lëvizjes, ky numër shënohet në inventar për çdo libër të këtij grupi.

Grupi i njësive bibliotekare të përpunuara nga sektori, përcillet me qëllim përshkrimin bibliografik (sipas standardeve ISBD) në sektorët përkatës (Sektorin e Katalogimit ose në Sektorin e Albano-Balkanologjisë),kundrejt dokumentit shoqërues të libër lëvizjes, e cila përmban numrin e copëve, numrin e inventarëve, dokument i cili mbahet në tri kopje, i firmosur nga përgjegjëset e dy sektorëve. Një kopje e këtij dokumenti qëndron në sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve,një në sektorin e Katalogimit; apo/dhe në sektorin e Albano-Balkanologjisëdhe kopja e tretë e firmosur e dokumentit të libërlëvizjes shoqëron marrjen në dorëzim të grupit (të përpunuar) nga sektori i Koleksioneve, ku dhe depozitohet ky grup.Në rastin e sallave me fonde të hapura kryhet e njëjta procedurë, me të njëjtin dokumentacion dhe marrja në dorëzim e grupit të përpunuar bëhet nga punonjësi i sallës respektive.

-Të dhënat e librave të librave përdoren gjatë verifikimit të materialeve bibliotekare(inventarët).

Librat janë të organizuara që të evidentojnë kopjen e detyruar copë 1 (një), që shkon në arkivin e fondit të BK dhe regjistrohet në librin e inventarit me sigël Ar e cila përfshin botimet në Shqipëri nga shtëpi botuese, si dhe dhurata të librave Shqip që vijnë jashtë territorit të Shqipërisë si nga Kosova, Maqedoni e Mali i Zi dhe 4 kopjet e tjera evidentohen në librin e fondit të përgjithshëm(S)copë 4e cila qarkullon për përdoruesin e ndarë kjo në (Albanologjia, Ballkanologji, fjalor dhe libra të botuar në Shqipëri dhe që pajisen me ISBN nga BK dhe ISBN e vendeve të cituara më lart për Libra Shqip) dhe kur janë materiale bibliotekare si CD, harta etj. pra jo libra e fjalorë regjistrohen në libra të posaçëm me sigël ARJL dhe ARJLS) sipas numrit njësive të depozituara.

Libri i huaj mbahet në regjistrin e librit të huaj (Sigla P), ku përfshihen dhe librat Albano - Ballkanologjikë të botuar në gjuhë të huaj për Shqipërinë; e në librat sipas sallave ku vendosen (libri i huaj i cili vendoset bazuar në gjuhën e shkruar të librit dhe përmbajtjen e tij) sikurse janë aktualisht të shpërndara në BK e konkretisht në atëshkruar nëfrëngjisht tek salla franceze, gjermanisht tek salla gjermane, anglisht tek salla amerikane. Për këto libra nuk ka arkivi pra njëkopje e detyruar për tu dorëzuar në fond.

Periodiku është i regjistruar në libra të posaçëm e konkretisht për tre kopje regjistrimi për materialet për revista dhe gazeta të botuara në Shqipëri veprohet: kur është periodik Shqip kalon një kopje në arkiv i detyruar tek fondi i arkivës (me siglënARP qëështë revista) dhe ARG (qëështë gazeta) dy të tjerat tek fondi i përgjithshëm (SHG dhe SHP).

Pra dy Libra mbahen në sektorin e zhvillimit të koleksioneve të cilat janë një libër arkivi dhe tjetri libri i fondit të përgjithshëm (vetëm për librin Shqip).

Tek fondi i përgjithshëm mbahen revista dhe gazeta me natyrë Albanologjike të cilat mbahen tek libri i inventarit të përgjithshëm. Këto janë libra ku evidentohen hyrjet dhe daljet e materialeve bibliotekare.

Regjistrimi në librat e inventarit bëhet në bazë të standardeve ndërkombëtare të inventarizimit ISO dhe udhëzimeve të IFLA-s, ISBD (standardi ndërkombëtar i përshkrimit bibliografik). Në regjistrin e inventarit përshkrimi bibliografik përmban: datën e regjistrimit, numrin i inventarit, autorin, titullin, kolonën e botimit (cili botim)/ volumi, vendine botimit, viti i botimit, çmimi, numri i vendit si dhe numri i lëvizjes që shoqëron grupin e materialeve që regjistrohen brenda së njëjtës datë. Krahas këtyre të dhënave, libri i inventarit përmban zonën e shënimeve për akt-daljet, procesverbalet e kalimeve të fondeve, zonën e shënimeve për verifikimin e fondeve si dhe zonën e vërejtjeve.

Në sektor bëhet përpunimi fizik dhe një pjesë e përshkrimit bibliografik në mënyrë elektronike të njësive e ndarë sipas fondeve me libra përkatës inventari. Të dhënat që regjistrohen në libra inventari përfshijnë elemente thelbësore që identifikojnë njësinë bibliotekare, e konkretisht për çdo libër vendoset çmimi në njësi dhe në sasi të ndarë, 1(një)kopje e detyruar e cila depozitohet në arkiv (AR) dhe kopjet e tjera të librave sipas fondit bibliotekar me emërtesa në sasi dhe në vlerë në total të grupit sipas burimit të hyrjes por **regjistrohen pa dokumentin shoqërues (justifikues) si fatura,** e cila për çdo material bibliotekar **vërteton** marrjen në dorëzim të tyre, dokumente të cilat duhet të mbahen në dosje në sektor për çdo hyrje.

4. Gjetje nga auditimi: Organizimi dhe mbajtja e librave të inventarit të fondit të BK ndër vite në sektorin e zhvillimit të koleksioneve është bërë sipas standardeve IFLA, rregullave dhe dokumenteve të përshkruara në një tekst shkollor ñKoleksionet e bibliotekësò, të përgatitur nga ish punonjës të Sektorit të Studimeve dhe të Kualifikimit viti 2002, por të pa miratuara në institucion nga Titullari, të pa përfshira dhe përditësuara në Rregulloren e Brendshme të BK-së, të miratuar me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010, si dhe të paazhurnuar me kërkesat e ligjit nr.25/2018 datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.

-Në sektorin e zhvillimit të koleksioneve nuk është organizuar ndër vite mbajtje e veçantë e kartelave të inventarit për materialet bibliotekare sipas vendit të depozitimit dhe personave përgjegjës, referuar kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 26, pika 35/pika c.

-Nga auditimi u konstatuan se në librat e inventarit janë regjistruar sipas evidencave të paraqitura nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, progresivisht *1,155,557 njësi bibliotekare (deri me 31.12.2020).* Procesi i skanimit të librave të inventarit vazhdon dhe deri më tani rezulton të jenë skanuar vetëm 82 libra inventari. Procesi i inventarizimit paraqitet me mangësi të theksuara në përpilimin e dokumenteve që evidentojnë hyrjen e materialeve bibliotekare të cilat regjistrohen në librat përkatës sikurse është Akti i hyrjes, i mbajtur nga Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve, përveç periodikut që mbahet nga Sektori i Shërbimit dhe i Informacionit. Në këto dokumente vendoset sasia në numër, datë dhe me emër botuesi, ose me emër dhuruesi në sasi, çmim dhe vlerë duke vendosur emrin subjektit botues *por pa vendosur numrin e faturës bashkangjitur*, akte të cilat përpilohen në dy kopje dhe si pasojë në regjistër në inventarin e akt- hyrjeve rezulton e pa evidentuar tek kopja e detyruar burimi i ardhjes së librit dhe fatura si dokument justifikues. E njëjta procedurë me mangësi ndiqet edhe nga sektori i Shërbimit dhe Informacionit për materialet periodike të

mbërritura në BK ku në Akt Hyrje nuk vendoset burimi i ardhjes dhe çdo dokument tjetër justifikues e shoqërues. Mangësitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi sektorin e zhvillimit të koleksioneve dhe përgjegjësen e sektorit të Shërbimit dhe Informacionit.

4. Konkluzioni:

Procesi i dokumentimit të hyrjeve e daljeve dhe regjistrimi i njësive bibliotekare në librat e inventarit pa dokumente justifikues si në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve ashtu edhe dhe në Sektorin e Shërbimit e të Informacionit, mos mbajtja e kartelave të inventarit për materialet bibliotekare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, ka sjellë mangësi dhe përdorim të burimeve njerëzore pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë për sektorin e zhvillimit të koleksioneve. Informacioni që prodhon kjo mënyrë dokumentimi është *"i cunguar"* në lidhje me verifikimin e burimit të ardhjes së koleksioneve, kërkimin e materialeve bibliotekare sipas vendit të depozitimit nga personat përgjegjës gjatë procesit të verifikimit në fond të koleksioneve duke sjellë vështirësi, mungesë transparence dhe vonesë në realizimin e objektivave bibliotekarë.

4.1. Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve dhe Sektori i Shërbimit të Informacionit gjatë përpilimit të dokumenteve të hyrjes së materialeve bibliotekare, të marrin masa për pasqyrimin në aktin e hyrjeve të gjithë elementët përkatës që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, e konkretisht përveç treguesve sasiore dhe ato të vlerës të bashkëlidhin dokumentin vërtetues sikurse është fatura bashkëlidhur dhe çdo dokument tjetër justifikues.

-Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, në bazë të dokumenteve të hyrjes dhe daljes në vendet e depozitimit të materialeve bibliotekare të organizojë mbajtjen e kartelave të inventarit të koleksioneve sipas vendit të depozitimit dhe personave përgjegjës referuar kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 26, pika 35/pika c.

-Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në bashkëpunim me sektorin e Bibliografisë të marrin masa që të vazhdojë skanimi i librave të inventarit të pa depozituar, duke përcaktuar afate konkrete, me qëllim përfundimin e monitorimin e këtij procesi të rëndësishëm.

Janar 2022 dhe në vijimësi

Lëvizjet e materialeve bibliotekare :

Akt Dalja (apo Fletë shoqëruese të grupeve të librave dhe periodikut)mbahen në tre kopje nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, por duhet të hartohet në katër, me qëllim dokumentimin e veprimeve sipas lëvizjes së koleksioneve në sektorët që kryejnë përshkrimin bibliografik të tyre deri në dorëzimin në vendin e depozitimit të tyre, pasi regjistrimi në regjistër inventari do të kryhet me akt-dalje përfundimtare të firmosura nga personat përgjegjës që ngarkohen me depozitimin e koleksioneve.

Ky proces do tø shërbejë Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve për të hartuar kartelat inventariale sipas vendit ku janë vendosur koleksionet dhe personave në ngarkim me qëllim që regjistri i inventarit të koleksioneve të mbahet me analiza në sasi, çmim dhe vlerë për ti shërbyer komisioneve të verifikimit apo inventarizimit të materialeve bibliotekare.

Lëvizja e materialeve bibliotekare në BK sipas fazave të përpilimit të përshkrimit bibliografik deri në depozitimin e tyre, paraqitet grafikisht në vijim në skemën nr. 1:

Skema nr.1. Lëvizja e materialeve bibliotekare sipas sektorëve



Sallat ku depozitohen koleksionet e BK janë si më poshtë vijon:

- Depozitohen tek Fondi i BK (Sektori i Koleksioneve);
- Salla Paolo Petta;
- Salla Amerikane;
- Salla Gjermane, (aneksi i BK)
- Salla Franceze), (Aneksi i BK);

Lëvizja e materialeve bibliotekare deri në dorëzimin në fondin arkivor pasi i bëhet përshkrimi bibliografik i tyre, përfshin sektorët:

- ✓ Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve;
- ✓ Sektorin e Katalogimit
- ✓ Sektorin e Albano-Balkanologjisë;

Dorëzimi në fund i koleksioneve në Sektorin e Koleksioneve përmban kopjen e detyruar, libër të huaj, dhurata, gazeta, disertacione, antikuarët, harta dhe CD etj.

Libri i huaj i specifikuar sipas gjuhës së shkruar dhe përmbajtjes dorëzohet në sallat përkatëse të cituara më lart.

Materialet bibliotekare të ardhura në sektor me dokument hyrës, përpunohen topografikisht (u përcaktohet numri i vendit), inventarizohen manualisht, regjistrohen elektronikisht sipas protokollit dhe me dokumentin shoqërues të libër lëvizjes në tri kopje (dokumenti përmban numrat e inventarit të copëve dhe firmat e 3 sektorëve; sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, sektori i katalogimit dhe sektori i Albano-Balkanologjisë) si dhe në fund fondi apo punonjësi i sallës që e merr në dorëzim.

Regjistrimi në librat e inventarit bëhet në bazë të standardeve ndërkombëtare të inventarizimit ISO dhe udhëzimeve të IFLA-s. Në regjistrin e inventarit shënohet data e regjistrimit, numri i inventarit,

autori, titulli, kolona e botimit (cili botim)/ volumi, vendi i botimit, viti i botimit, çmimi, numri i vendit si dhe numri i lëvizjes që shoqëron grupin e materialeve që regjistrohen brenda së njëjtës datë. Krahas këtyre të dhënave, libri i inventarit përmban zonën e shënimeve për akt-daljet, procesverbalet e kalimeve të fondeve, zonën e shënimeve për verifikimin e fondeve si dhe zonën e vërejtjeve.
Për hyrjen e materialeve bibliotekare në sektor përpilohet dokumentacioni i akt hyrjes.
Në sektor bëhet përpunimi fizik dhe elektronik i njësive të ndara sipas fondeve me librat përkatës të inventarit, për fondin e Bibliotekës.
Në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve, në librat e inventarit regjistrimi i hyrjeve rezulton me problematika pasi nuk shkruhet numrii Akt Hyrjes, por mbahet vetëm në sasi dhe çmim dhe me të dhënat që përmban libri si për kopjen e detyruar në regjistërashtu edhe për 1 kopje të detyruar në arkiv, me sigël (AR).Në regjistrin e inventarit tek fondi i përgjithshëm nuk evidentohen koleksionet sipas llojit me analiza dhe kjo vështirëson përpilimin e evidencave të hyrjeve sipas llojit të fondit të BK.
Gjithashtu në regjistrin e fondit të përgjithshëm të dhënat regjistrohen sipas Akt Hyrjeve për sasitë e dorëzuara (katër kopje në sasi dhe çmim analitike sipas autorit, titulli për çdo material bibliotekar dhe në vlerë mbahen në total për çdo grup materiali bibliotekar të ardhur në një datë të caktuar në BK bazuar në aktine hyrjes por pa vendosur në të dhe numrin dhe datën e faturës e cila normalisht do të detajonte dhe vlerën e produktit apo ndonjë si dokument tjetër justifikues në regjistër dhe në vlerë.
Akti i daljes regjistrohet në libër inventari pas përpunimit fillestar të koleksionit, proces i cili vazhdon me dorëzimin për përshkrimin bibliografik në sektorët përkatës, dhe jo në bazë të dokumentit përfundimtar (akt dalje përfundimtare) që duhet të firmosen nga marrësi në ngarkim i koleksioneve.

Në vitin 1999 në BK u instalua sistemi i parë i integruar bibliotekar(sistemi informatik) i quajtur Adlib. Aktualisht procesi i mbajtjes së dokumentimit të hyrjeve dhe daljeve dhe i regjistrimi në librat përkatës të inventarëve aktualisht mbahet në mënyrë manuale me dore përveç hedhjes së të dhënave bibliografike të cilat hidhen në sistemin informatik të BK, i emërtuar ALIS në Prill të vitit 2021, e konkretisht për librat, disertacionet, materiale jo libra të cilat përfshijnë numër vendi, numër inventari, çmimin, në sasi për kopjen e detyruar kurse për dhuratat nuk ka filluar.
Ky sistem është instaluar në BK, me fondet e MK sipas kontratës me nr. 7442/prot. datë 27.12.2018 të lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI) dhe operatorëve ñXò ShPK me përfitues Biblioteka Kombëtare e Shqipërisëò, me objekt: ñNgritja e Sistemit të Digjitalizimit të BK-sëò me vlerë 122,724,000 lekë me TVSh, me afat zbatimi 57 muaj, 9 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje. Për këtë kontratë është kërkuar shtesë afati nga operatori ñXò ShPK prej 60 ditësh. Më datën 04.09.2019 është lidhur amendamenti duke vendosur afatin përfundimtar, datën 27 Nëntor 2019. Më hollësisht paraqesim proceset e punës të hedhur nga ky sektor në katalogun elektronik:
Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve përveç inventarizimit fizik të materialeve bibliotekare kryen dhe regjistrimin në katalogun elektronik të këtyre materialeve, i cili bëhet sipas protokollit të punës, nëpërmjet *Moduli i Pasurimit, i cili në përbërje ka:*
1)kopjen e detyruar, 2) dhuratën, 3) shkëmbimet, 4) blerjet.
**Tek <u>kopja e detyruar</u> Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve hedh këto të dhëna bibliografike:*
-Nr. Akt hyrje, nr. inventari *(i cili bashkëlidhet dhe në fletën shoqëruese që i dërgohet Sektorit të Katalogimit dhe Sektorit të Albano-Balkanologjisë)*, Nr. i vendit *(i cili është përcaktues për fondin ku do shkojë materiali bibliotekar)*, nr. e dokumentit të librit të lëvizjes, çmimi dhe lloji i huazimit.
**Tek <u>dhuratat dhe disertacionet,</u> Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve hedh këto të dhëna bibliografike:*

-Nr. akt-hyrje, dhuruesi dhe botuesi, titulli, vendi dhe viti i botimit, nr. e dokumentit të librit të lëvizjes, nr. i vendit, nr. i inventarit, çmimi dhe lloji i huazimit.
Këto të dhëna bibliografike që hidhen në regjistrimin e katalogimit elektronik pasqyrohen për librat dhe për materialet jo libra.
Këto të dhëna nuk pasqyrohen akoma për koleksionet e periodikut.
Me sistemin e ri parashikohet që të regjistrohen të dhënat bibliografike edhe për koleksionet e periodikut, njësoj sikurse ndodh për librat dhe materialet e tjera bibliotekare.
Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve ka filluar me regjistrimin në protokollin përkatës në sistemin e ri informatik Alis më **datë *19.04.2021.***

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se lëvizja e materialeve bibliotekare brenda BKSH-së, dokumentohet me fletë shoqëruese e cila përbën akt-daljen e materialeve bibliotekare dhe përpilohet nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve aktualisht vetëm në tre kopje, cilësuar në sasi e çmim, por **pa vendosur vlerën totale sipas materialeve** përkatëse bibliotekare. Sektori i zhvillimit të koleksioneve nuk mban të depozituar një fletë shoqëruese apo akt-daljen origjinale të firmosur nga të gjithë personat përgjegjës duke krijuar mungesë të gjurmës së auditimit.
-Mungesa e gjurmës së auditimit konstatohet edhe në regjistrin e inventarit tek fondi i përgjithshëm ku nuk evidentohen koleksionet sipas llojit me analiza specifike, duke sjellë mangësi në përpilimin e evidencave të hyrjeve sipas llojit të fondit të BK, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, pika 30.
Këto veprime në organizimin dhe mbajtjen e dokumentimit të lëvizjeve të koleksioneve sjellin që informacioni në lidhje me hyrjet dhe daljet sipas viteve nuk jepet në mënyrë analitike pra sipas llojit të fondit në sasi dhe vlerë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, në lidhje me procedurat standarde dhe gjurmën e auditimit me qëllim mbrojtjen e aktiveve që në rastin konkret janë materialet bibliotekare.

5. Konkluzioni: Procesi i dokumentimit të hyrjeve e daljeve dhe regjistrimi i njësive bibliotekare në librat e inventarit pa dokumente justifikues si në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve ashtu edhe dhe në Sektorin e Shërbimit e të Informacionit, mos mbajtja e kartelave të inventarit për materialet bibliotekare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, ka sjellë mangësi dhe përdorim të burimeve njerëzore pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë për sektorin e zhvillimit të koleksioneve. Mungesa e gjurmës së auditimit konstatohet edhe në regjistrin e inventarit tek fondi i përgjithshëm ku nuk evidentohen koleksionet sipas llojit me analiza specifike, duke sjellë mangësi në përpilimin e evidencave të hyrjeve sipas llojit të fondit të BK, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, pika 30.

5.1. Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në BKSH, të marrë masa për të përgatitur në katër kopje Fletë Shoqërimin e materialeve në sektorët përkatës për përpunim (përshkrimin bibliografik të koleksioneve) dhe në fund të këtij procesi me depozitimin e tyre në fondin arkivor, në sasi, çmim dhe vlerë të nënshkruar nga sektorët përkatës, të regjistrojë fletë daljen në librin e inventarit duke hartuar kështu dhe kartelat inventariale sipas personave ku janë depozituar koleksionet në mënyrë analitike.

Janar 2022 dhe në vijimësi

5.2. Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në BKSH, të marrë masa dhe të organizojë mbajtjen e regjistrave të inventarëve sipas llojit të tyre dhe veprimet që kryhen në librat e inventarëve të bazohen në dokumente origjinale si për hyrjet dhe dalje, sipas llojit me analiza.

-Në këtë sektor të organizohet kryerja e mbajtjes së kartelave sipas vendndodhjes së materialeve bibliotekare dhe sipas personave përgjegjës me analiza sipas llojit të materialeve bibliotekare. Në sektor të mundësohet mbajtja origjinale e akteve si për hyrjet dhe për lëvizjet e koleksioneve nëpërmjet akt-daljeve (apo fletë shoqërimit) të koleksioneve duke u shtuar në katër kopjet e hartuara për këtë qëllim.

Janar 2022 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua senë BK, procesi i mbajtjes së dokumentacioneve hyrëse dhe lëvizjes së materialeve bibliotekare e regjistrimi i tyre në librat e inventarit dhe të lëvizjes bëhet në mënyrë manuale, pavarësisht se në institucion është instaluar sistemi i përpunimit të përshkrimit bibliografik referuar kontratës së lidhur nga AKSHI me nr. 7442/prot. datë 27.12.2018.
Si rezultat i vonesave të trajnimeve të specialistëve të sektorit të zhvillimit të koleksioneve në lidhje me modulin e pasurimit, nga sektori i studimeve dhe kualifikimit dhe sektori i IT, përgjegjës për këtë funksion në sistemin e ri informatik ALIS, instaluar më 27.12.2018, ka sjellë që procesi i përpunimit fizik të hyrjes dhe lëvizjes së koleksioneve, kryerjes së verifikimit të koleksioneve (apo inventarizimit fizik të tyre), i pa informatizuar, të përbëjë një volum të madh pune duke kërkuar shumë kohë dhe burime njerëzore dhe duke ndikuar në një proces joefektiv dhe eficient. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6. Konkluzioni:

Në kuadrin e digjitalizimit të veprimtarisë së BK, rezulton se Sektori i zhvillimit të Koleksioneve, aktivitetin e tij në lidhje me dokumentimin e hyrjeve, lëvizjeve dhe depozitimin e Fondit e kryen në mënyrë manuale, gjë e cila ka vështirësuar punën për tëju përgjigjur në kohë menaxhimit me efektivitet të administrimit të fondeve bibliotekare, dhe në veçanti kryerjes së verifikimit të tyre, megjithëse sistemi informatik Alis me modulin e pasurimit në institucion është instaluar më 27.12.2018. Kjo ka ardhur edhe për faktin e volumit të madh të përmbajtjes që kanë 222 librat (regjistrat) me informacion në lidhje me materialet bibliotekare ndër vite dhe i vonesave të trajnimeve të specialistëve të sektorit në lidhje me këtë modul pasurimi, gjë e cila ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve dhe Sektorin e Studimeve dhe të Kualifikimit.

6.1. Rekomandimi:BK si institucion i shërbimit publik, të marrë masa për qasje informacioni për të gjithë përdoruesit, për koleksionet që arkivohen ndër vite dhe që përbëjnë vlera të rralla për kulturën tonë, si dhe të parashtrohet në objektivat strategjike të BKSH-së, për vitin 2022 e në vijim, mundësia e digjitalizimit në sistemin informatik Alis të modulit të pasurimit të gjithë informacionit që përmbajnë 222 librat, mbi hyrjet dhe lëvizjet e fondit ndër vite me qëllim azhurnimin e këtyre të dhënave me të dhënat dhe gjendjen aktuale të Fondit në institucion.

Janar 2022 e në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në bashkëpunim me Sektorin e Studimeve dhe Kualifikimit, strukturën drejtuese të BKSH-së dhe asistencën e sistemit të IT-së, të informatizojë të gjithë procesin e punës të Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve, i cili fillon nëpërmjet përpilimit të dokumenteve hyrës dhe lëvizës (akt daljet) sipas burimit dhe regjistrimi i tyre në regjistrat përkatës të inventarëve sipas rregullave dhe standardeve përkatëse. E rëndësishme është hartimi i një data bazë për të gjithë pasurinë e koleksioneve ndër vite, sipas llojit, me analiza në sasi e vlerë dhe vendit të depozitimit, duke krijuar kështu mundësinë në çdo kohë të kontrollit dhe të evidentimit të gjendjes së materialeve bibliotekare sipas hyrjeve dhe vendit të depozitimit, e duke garantuar kështu

dokumentimin, arkivimin, ruajtjen dhe qarkullimin e koleksioneve sipas procedurave dhe rregullave standarde bashkëkohore.

Janar 2022 e në vijimësi

6.3. Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve të hartojë periodikisht evidencat për materialet bibliotekare drejtuar Sektorit të financës dhe të buxhetit, për të kryer kontabilizimet në llogaritë përkatëse, të cilat të jenë me analiza sipas llojit të fondit në sasi dhe vlerë të shoqëruar me informacion të hollësishëm mbi gjendjen e koleksioneve sipas hyrjes dhe verifikimit të tyre.

Janar 2022 e në vijimësi

Në institucion mbahen dhe Libra statistikore (ose lëvizëse), të cilat janë dy dhe bazohen në të dhënat e librit të inventarit. Këto libra mbajnë të dhëna : regjistrojnë datën e hyrjes së materialeve bibliotekare, burimin e ardhjes (kopje e detyruar që është 1+4; dhuratë , shkëmbime dhe blerje në sasi sipas numrit
përfundimisht në tituj dhe sipas degëve të shkencës, me qellim dhe për të dhëna statistikore gjatë hartimit të evidencave përkatëse.
1 Titull = 1Njësi

Libri i parë statistikor mban titujt = me 1Njësi, dhe regjistrimi kryhet në sasi dhe vlerë dhe ndarjes sipas fondeve dhe sipas degëve të shkencës të marra nga pasqyra përmbledhëse e hyrjeve të kryera në një datë të caktuar referuar përmbledhëses në librin e lëvizjes .
Libri i dytë mban të dhëna sipas datave të hyrjes së materialeve bibliotekare sipas burimit të ardhjes dhe degëve të shkencës. Ndryshimi me librin e parë qëndron se këtu të dhënat janë në copë e në vlerë totale pra për një njësi që i përket arkivës +katër njësi që i përket fondit të përgjithshëm sipas llojit të fondit të ndarë (Arkive Ar, Fondi i Përgjithshëm S, Albano-Balkanologjik Al ose Ba, periodiku(Shqip është Arp, gazetë që ka siglën Arg,Shp dhe Shg), periodiku i huaj me siglën R), materiale jo libra që janë me siglën CD etjme siglën Jls dhe Arjl dhe Jlu dhe disertacionet me Siglën Os, mbahet dhe libri i huaj me sigël P dhe librat sipas sallave e konkretisht:

- Paolo Petta me sigël Pp,
- Salla amerikane me sigël Ac,
- Salla Franceze me sigël Sfr,
- Salla Gjermane me sigël Sgj.

Siglat vendosen sipas protokolleve të përcaktuara në institucion nga sektori i studimeve dhe e kualifikimit.
Arkivi dhe fondi i përgjithshëm i përket librit shqip(4+1) dhe ISBN Shqiptare mbahen tek sektori i koleksioneve .
Ndërsa materialet sipas gjuhëve dhe përmbajtjes mbahen nëpër 4 salla .
-Politikat e pasurimit, zhvillimit të koleksioneve, dhe kryerjes së inventarëve(verifikimit) të materialeve bibliotekare, si dhe baza ligjore ku mbështetet kryerja e inventarizimit deri në nxjerrjen e rezultateve përfundimtare.

Objektivi kryesor i një biblioteke është jo vetëm të krijojë, pasurojë dhe ti zhvillojë koleksionet mbi bazën e një gjykimi profesional të mbështetur në politika të qarta, të zbatueshme dhe të arrira bazuar në burimet e saj të sigurta e të disponueshme për tu përdorur sikurse janë fondet e buxhetit të shtetit që duhet të zënë peshën kryesore etj. si dhe në nevojat e përdoruesve, por dhe të hartojë politika për spastrimin e tyre. Një vend të rëndësishëm në këtë proces zë dhe **inventarizimi i materialeve bibliotekare (verifikimi).**

Auditimi në lidhje me verifikimin e koleksioneve ose materialeve bibliotekare ka një rëndësi të veçantë pasi verifikohen materiale bibliotekare që janë pjesë e trashëgimisë kulturore të depozituara ndër vite që duan vëmendje dhe ruajtje të veçantë. E theksojmë se inventari (verifikimi) në fondin e BK ka vështirësi pasi koleksionet përbëjnë një volum të madh të njësive të depozituara në BK, dhe gjithashtu krahasimi me të dhënat e librave të inventarëve, skedave të kontrollit, verifikimi me skedarin topografik është një proces i gjatë në kohë. Ky proces në institucion kryhet nga 4 punonjës të caktuar në strukturën e institucionit sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.122, datë 17.09.2019.

Komisioni i ngritur brenda Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve për inventarizimin e koleksioneve dokumenton materialet bibliotekare nga hyrjet dhe depozitimin e tyre në fond e salla, si dhe dokumenton në regjistrat e sektorit edhe informacionin e rezultateve të inventarizimit ose të verifikimit të fondit. Raportimet për rezultatet e nxjerra si për inventarët, për seleksionimin dhe daljet e fondeve nga spastrimet e koleksioneve përgatiten nga përgjegjësja e Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve për Titullarin. Ponga përgjegjësja e sektorit referuar detyrave funksionale nënshkruhen hyrjet dhe daljet e koleksioneve, veprime që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005òPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, neni 4, pika2, germa c, dhe të UMF nr.30, datë ñ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 82.

Në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve, referuar evidencave sipas llojit të fondeve në njësi dhe në vlerë totale për të gjithë fondin e depozituar në BK sipas viteve paraqitet si më poshtë vijon:

Për vitin 2018, janë bërë hyrje gjithsej material bibliotekare gjithsej 15,608 njësi dhe në vlerë totale 14,835,264,77 lekë.

Për vitin 2019, janë bërë hyrje gjithsej material bibliotekare gjithsej 15,301 njësi dhe në vlerë totale 13,551,774,05 lekë.

Për vitin 2020,janë bërë hyrje gjithsej material bibliotekare gjithsej 12,158 njësi dhe në vlerë totale 10,625,053,05 lekë.

Në fund të vitit 2020 në institucion gjenden 1,155,557 njësi sipas llojit të fondit dhe në vlerë totale 245,163,908 lekë.

Më hollësisht hyrjet sipas llojit të fondit dhe në mënyrë progresive të ndarë sipas viteve të në njësi dhe në vlerë totale paraqiten në tabelën nr.2.

Tabela nr. 8: **Hyrjet sipas llojit të fondit dhe në mënyrë progresive**

Nr.	Lloji i fondit	2018	2019	2020
1	Fondi arkivit shqip/ tituj	103,464	10,6275	108,460
2	Arkivi periodikut shqip/ koleksione	21,280	21,658	21,906
3	Albano-Balkanologji/ njësi shqip	49,793	50,184	50,569
4	Antikuarë/ njësi	2,466	2,466	2,491
5	Dorëshkrime/ njësi	1,194	1,197	1,199
6	Libri shqip/ njësi (S+Fe)	440,533	437,269	445,418
7	Periodiku shqip/ koleksione	45,815	42,882	43,410
8	Libri i huaj/ njësi (Fe+P+PP+AC+SFr, SGj, Al-Ba)	372,908	370,969	371,266
9	Periodiku i huaj/ koleksione	93,275	93,529	93,705
10	Mikrofilma/ njësi	6,302	6,302	6,302
11	Materiale jo libra	382	409	409
12	CD	321	348	361

13	Harta Al-Ba/ njësi	1,066	1,067	1,067
14	Disertacione shqip/ njësi	8,190	8,464	8,570
15	Disertacione të huaja/ njësi	307	380	424
16	Aktdalje	19,142		
	Totali progresiv i njësive	1,128,098	1,143,399	1,155,557
	Vlera totale progresive	220,987,080.9	234,538,854.95	245,163,908

Burimi i të dhënave: Nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve. Përpunimi : Nga grupi i auditimit.

Vlen të theksohet të dhënat në tabelë janë paraqitur sipas njësive dhe në vlerë totale **pasi nuk mbahen evidenca sipas llojit në mënyrëanalitike dhe në vlerë.**
Të dhënat progresive për hyrjet dhe daljet sipas viteve objekt auditimi, dhe sipas njësive duke përfshirë dhe daljet e kryera nga djegia e ndodhur në vitin 2017 dhe kalimet e fondeve sipas një procedure të miratuar nga Titullari paraqiten në tabelën nr.9, në vijim:

***Tabela nr. 9**: Të dhënat e gjendjes së fondeve në BK sipas Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve.*

Nr.	Lloji i fondit	Progresivi i vitit 2017	Hyrjet për vitin 2018	Daljet e 2018 (djegia dhe kontaminimi)	Progresivi i vitit 2018	Hyrjet për vitin 2019	Progresivi i vitit 2019	Hyrjet për vitin 2020	Kalime fondi në vitin 2020	Progresivi i vitit 2020
1	Fondi arkivit shqip/ tituj	100,810	*2,654*		103,464	*2,811*	106,275	*2,185*		108,460
2	Arkivi periodikut shqip/ koleksione	20,774	*506*		21,280	*378*	21,658	*248*		21,906
3	Albano-Balkanologji / njësi shqip	49,415	*378*		49,793	*391*	50,184	*385*		50,569
4	Antikuarë/ njësi	2,466	*0*		2,466	*0*	2,466	*2*	*(+23 An)*	2,491
5	Dorëshkrime/ njësi	1,194	*0*		1,194	*3*	1,197	*0*	*(+2 Dr)*	1,199
6	Libri shqip/ njësi (S+Fe)	430,893	*9,640*	*13,376(13,328 libër shqip dhe 48 fjalor shqip)+56 aktdalje lexuesi*	42,7101	*10,168*	437,269	*8,149*		445,418
7	Periodiku shqip/ koleksione	44,963	*852*	*3,535*	42,280	*602*	42,882	*528*		43,410
8	Libri i huaj/ njësi (Fe+P+PP+AC+SFr, SGj, Al-Ba)	372,021	*887*	*2,231 (1,632 fjalor i huaj dhe 599 libër i huaj)*	370,677	*292*	370,969	*322*	*(-25 libër i huaj)*	371,266
9	Periodiku i huaj / koleksione	93,149	*126*		93,275	*254*	93,529	*176*		93,705
10	Mikrofilma/ njësi	6,302	*0*		6,302	*0*	6,302	*0*		6,302
11	Materiale jo libra	333	*49*		382	*27*	409	*0*		409
12	CD	309	*12*		321	*27*	348	*13*		361
13	Harta Al-Ba/ njësi	1,027	*39*		1,066	*1*	1,067	*0*		1,067
14	Disertacione shqip/ njësi	7,752	*438*		8,190	*274*	8,464	*106*		8,570
15	Disertacione të huaja/ njësi	280	*27*		307	*73*	380	*44*		424
16	Aktdalje	*54*	*2*	19,142						
	Totali progresiv i njësive (njësi)	1,131,634	*15,608 (njësi)*	19,142	1,128,098	*15,301*	1,143,399	*12,158*		1,155,557
	Vlera totale progresive (në lekë)	214,254,172.96	*14,835,264.77*	8,102,146.83	220,987,080.9	*13,551,774.05*	234,538,854.95	*10,625,053.05*		245,163,908

Burimi i të dhënave: Nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve. Përpunimi: Nga grupi i auditimit.

Të dhënat për kryerjen e inventarizimi të fondeve në BK

Në tabelën e mëposhtme (tabela nr.10) jepen të dhënat për inventarin e fundit në fondin e Bibliotekës të nxjerra nga librat e inventarit dhe jo sipas dokumenteve duke filluar nga urdhrat e Titullarëve dhe raporteve të hartuara sipas fondeve përkatës.

Tabela nr.10: *Të dhëna inventariale.*

Nr	Lloji i Fondit	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Inventari i fundit i kryer		
		Njësi	Vleftë në lekë	Njësi	Vleftë në lekë	Njësi	Vleftë në lekë	Viti	Njësi	Vleftë në lekë
1	Fondi i arkivit shqip/tituj	-		-		-		2007 2008		
2	Arkivi i periodikut shqip/koleksione	-		-				2007 2008		
3	Albano-Balkanologji/ njësi shqip	-		-				2007 2008		
4	Antikuarë/njësi	-		-				2006 2016		
5	Dorëshkrime/njësi	-		-				2006 2016		
6	Libri shqip/(S+Fe)	-		-				2008 2010(pjesërisht)		
7	Libri i huaj/m njësi(Fe+P+PP+AC+ SFR+Al-Ba	-		-				2004 2006		
8	Periodiku i huaj /koleksione	-		-				1995		
9	Mikrofilma/njësi	-		-				1996		
10	Materiale jo libra	-		-				-		
11	CD	-		-				-		
12	Harta Al-Ba/njësi	-		-				2017 u ndërpre nga zjarri		
13	Disertacione të huaja /njësi	-		-				1995		
14	Periodiku shqip/koleksione	-		-				2007 2008		
15	Disertacione shqip/njësi	-		-				1995		
	Totali									

Burimi i të dhënave BK, përpunuar nga grupi i auditimit.

-Nga dokumentet e paraqitura referuar të dhënave të librave të inventarit të sektorit të zhvillimit të koleksioneve evidentohet se kryerja e verifikimit të fondeve në koleksionet si LibriShqip është e pa përfunduar plotësisht prej 2010, në Albanoï Ballkanologji është kryer në periudhën 2007-2008, në librin e huaj /koleksione nga viti 1995, në harta AL-Ba /njësi i papërfunduar si proces dhe i filluar që në vitin 2017. Sipas shkresës me nr.548. prot. datë 17.09.2019 të Titullarit aktual të BK ka dalë Urdhër nr.99, datë 17.09.2019 ñPër vënien në

shërbim të publikut të sallave të leximit, që gjenden në aneksin e Bibliotekës Kombëtareò, drejtuar Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve për të kryer procesin e seleksionimit të koleksioneve bibliotekare sipas gjuhëve, që qëndrojnë në salla në kuti dhe në thasë, proces i cili vijon i pa mbyllur.

-Në Draft Strategjinë 2016-2021,të hartuar nga një grup prej 13 anëtarësh punonjës të Bibliotekës Kombëtare, referuar shkresës nr.19/prot. datë 19.01.2015 të ish Titullarit së BK, z. X rezultoi se:

-Gjatë hartimit të Draft Strategjisë,nga grupi i punës në BK nuk është trajtuar si objektiv me rëndësi të veçantë, procesi i inventarizimit, referuar gjendjes së rënduar aktuale të mbajtjes së koleksioneve jashtë çdo standardi, në kuti kartoni dhe thasë; *problemi i verifikimit të tyre* ndër vite që janë pjesëe trashëgimisë kulturore në vend, të cilët rrezikojnë humbjen nga dëmtimet dhe keqpërdorimet nga e mossigurimittë depozitimit *në fond* dhe verifikimit në kohë të tyre.

-Administrimi, verifikimi i fondit arkivor në institucion duhej trajtuar me përparësi dhe vëmendje të veçantë duke e përfshirë si objektiv specifik në draft strategjinë 2016-2021.

*Nga auditimi referuar dhe përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave të kryera me specialistë të Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve ka rezultuar se nga MK nuk është miratuar ndonjë Udhëzim Specifik ñ Për menaxhimin e fondit të sistemit kombëtar të bibliotekave përfshirë dhe Bibliotekën Kombëtareò, udhëzim ky që do i shërbente gjithë sistemit bibliotekar në Shqipëri.

Nga ana e BK nëpërmjet strukturës së saj e cila është Sektori i Studimeve dhe Kualifikimit gjithashtu nuk janë ndërmarrë iniciativa ligjore për hartimin e një udhëzuesi për menaxhimin dhe administrimin e fondit të BK përfshirë dhe procedurat që duhen ndjekur në kryerjen e inventarizimit të tyre, referuar detyrave të këtij sektori të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të BK e miratuar nga Ministri i Kulturës me Urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtare".

Në *Rekomandimet e Rishikuara në lidhje me Standardizimin Ndërkombëtar të Statistikave mbi Prodhimin dhe Shpërndarjen e Librave, Gazetave dhe Periodikëve,* miratuar në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën), mbajtur ne Sofje të Bullgarisë me 8 Tetor deri më 9 Nëntor 1985, në Pikën 11(a) jepet përkufizimi i librit sa më poshtë:

"Një libër është një botim/publikim jo-periodik me së paku me 49 faqe, pa kopertinat, i botuar në vend dhe i vënë në dispozicion të publikut".

Domosdoshmëria e një udhëzimi specifik për këto Aktive (Libri) e përbën fakti se ñLibratò janë aktive të cilat nuk vlerësohen, nuk janë objekt i përllogaritjes së amortizimit vjetor, dhe afate kohore të përdorimit, sikurse janë aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale, aktive afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave që trajtohen sipas rregullave të vendosura në SKK, në ligjin nr.25, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar dhe në UMF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

Sipas të dhënave të evidencave të përgatitura nga grupi i auditimit rezultojnë se në fund të vitit 2020 Fondi Bibliotekar në total në vlerë është *245,163,908 lekë* që i përket 1,155,567 njësi bibliotekare. Pra në institucion gjatë viteve depozitohen njësi libra e materiale të tjera bibliotekare në sasi të konsiderueshme, të cilat me kalimin e viteve përbëjnë vlera pasurore në fushën e trashëgimisë kulturore sikurse janë antikuarët (botime para viteve 1800).

Problematikat e vazhdueshme të mungesave të hapësirave në BK, për depozitimin e materialeve bibliotekare rrezikojnë dokumentimin, verifikimin si dhe ruajtjen e tyre pavarësisht masave të marra nga institucioni, të cilat janë zgjidhje provizore por që nuk

garantojnë ruajtjen dhe sigurinë e tyre sipas standardeve ndërkombëtare në zbatim dhe të kërkesave të UMF nr.30, datë 27.12.2011, pika 2 i ndryshuar.
Referuar Urdhrit nr.286, datë 05.05.2017 nga ish Titullari i BK z. X rezultojnë se nuk janë depozituar materialet bibliotekare në Sektorin e Koleksioneve, për faktin e mungesës së hapësirave të cilat mbahen në kuti kartoni të pa shoqëruara me akt-dalje përfundimtare(pra të marrjes në dorëzim të tyre nga Sektori i Koleksioneve, të cilat janë:
Për vitin 2017, 1,213 tituj= 6,065 njësi;
Për vitin 2018, 2,330 tituj= 11,650 njësi;
Për vitin 2019, 2,498 tituj=12,490 njësi;
Për vitin 2020, 2,057 tituj=10,285 njësi.
Totali i titujve kopje e detyruar e pa depozituar në fond nga viti 2017 deri më 31.12.2020 është:
8,098 tituj =40,490 njësi
Totali i njësive dhuratë 1,785 tituj=5,098 njësi
Totali i titujve nga viti 2017 deri më 31.12.2020 (kopje e detyruar + dhuratë), 9,883 tituj .
Theksojmë se këto njësi që janë libri Shqip, kopje e detyruar për në Fond (Sektori Koleksioneve), qëndrojnë në ambientet e bibliotekës pa kryer procedurat e daljes nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, pa kushte sigurie dhe jashtë standardeve të mbajtjes, duke vënë në rrezik ekzistencën e tyre në shërbim të përdoruesve si dhe paraqitet një risk i madh në ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, sipas ligjit nr. 8576 datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat kombëtareò, i ndryshuar neni.16/pika1, neni 27/pika2.
E njëjtë paraqitet situata problematika edhe në ñaneksinò e BK ose e quajtur Biblioteka e Vjetër në godinën pranë rrugës George. Ë. Bush dhe **në ambientet e Alba Film (ish Kinostudio),**
ku thasët e librave janë pa fund dhe rreziku i dëmtimit është gjithmonë prezent.

Pamjet e depozitimit të fondeve të BK në ambientet e Alba Film (ish Kinostudio)

Pamjet nga depozitimet e fondeve të BK nga ambientet e aneksit të BK në rrugën G. Ë. Bush

-Njësi bibliotekare quhet çdo material bibliotekar i identifikueshëm me numër inventari dhe me numër vendi.
-Në fondin e arkivit të librit dhe të periodikut shqip përdoret emërtimi *titull* që është i njëjtë dhe i barabartë me njësinë bibliotekare (pra materialin bibliotekar).
-Koleksion periodiku quhet njësia bibliotekare (revistë, gazetë) që përmban një/disa numra periodiku e identifikueshme si një njësi bibliotekare me numër inventari dhe me numër vendi.
Problematikat/ecuria e procesit të inventarit të fundit të vlerave të rralla të kryer në vitin 2016, janë trajtuar në relacionin e përgatitur nga grupi i inventarizimit më datë *30.09.2016*. Inventari i hartave të fondit Al- Ba të këtij fondi u ndërpre për shkak të emergjencës së krijuar nga rënia e zjarrit dhe punës për normalizimin e situatës.
Sipas protokollit të punës në sektor gjatë vitit 2020 në institucion rezultojnë se janë bërë 25 kalime fondi nga libri i huaj mbajtur në aneksin e bibliotekës (Rruga e Elbasanit) në fondin e BK (me sigël An dhe Dr) që i përkasin viteve para vitit 1800 sipas tabelës së mëposhtme për fondin e vlerave të rralla (albano-balkanologjik).

Tabela nr.11: (Lëvizjet e fondeve) Viti 2020.

Nga fondi(Aneksi i BK)(Libri i huaj)	Në Fondi i Antikuarit	Në Fondi i Dorëshkrimit
23 njësi	23 njësi	
2 njësi		2 njësi

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gjatë periudhës 2018-2020 në institucion, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të rënies së zjarrit në sallën P.300 të BK-së, më datë 15.03.2017dhe shuarjes së tij të detyruar me ujë, në mungesë të përdorimit nga Shërbimi Zjarrfikës të aerosolit, gazit CO2, gazit IG 55 (50 % azot dhe 50 % argon) apo pluhurit zjarrshuarës, lëndë të cilat nuk dëmtojnë materialet bibliotekare), ndodhi dëmtimi dhe kontaminimi/infektimi i materialeve bibliotekare. Dëmtimi nga djegia dhe kontaminim/infektimi i materialeve bibliotekare, në institucioni ndërmorën hapat e nevojshme duke i bërë akt-dalje njësive të sipërcituara. Akt-daljet janë ekzekutuar në librat themeltarë të inventarit sipas fondeve të përcaktuara.Po ashtu janë pasqyruar dhe në dokumentacionet statistikorë dhe në relacionet përmbledhëse drejtuar titullarëve të institucionit në shifra dhe vlera financiare.

Tabela nr.12*:Tabela përmbledhëse e materialeve bibliotekare të kontaminuar/infektuara e të pa përdorshme.*

koleksion	**njësi**	**shuma në lekë**
revista	2,129	944,597.7
fjalorë	646	240,095.2
libër shqip	12,539	5,808,798.8
gazeta	462	144,433.9
libër i huaj	309	4,921.15
TOTALI	**16,085**	**7,142846.75**

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.13: *Tabela përmbledhëse e materialeve bibliotekare të djegura tërësisht nga zjarri*

koleksion	**njësi**	**shuma në lekë**
REVISTA	201	69,386.00
FJALORË	1,034	300,670.9
LIBËR SHQIP	789	424,825.00
GAZETA	743	160,266.53
LIBËR I HUAJ	290	4,151.65
TOTALI	**3,057**	**959,300.08**

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.14: *Tabela në total të humbura (djegie dhe kontaminim/infektimi)si më poshtë:*

koleksion	**njësi**	**shuma në lekë**
Libër shqip	13,328	6,233,623,8
Koleksion gazetash	1,205	304,700,43
Libri i huaj	599	9,072,8
Koleksione revistash	2,330	1,013,983,7
Fjalorë	1,680	540,766,1
TOTALI	19,142	8,102,146,83

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit

Spastrimi i koleksioneve

Auditimi i procesit të spastrimit si pjesë e zhvillimit të koleksioneve u bazua në:
-Ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, neni18;

-Udhëzues e MKRS nr.1, datë 22.09.1992 ñPër seleksionimin e fondit të librave në Bibliotekaò;
-Udhëzues të datës 16.08.2011 me nr. prot., 126 të Sektorit të Kualifikimit të BKSH-së;
-Shkresa e datës 31.10.2014 për njoftimin për ofrimin e literaturës së BKSH -së mbas procesit të spastrimit drejtuar bibliotekave të vendit;
-Lista e bibliotekave të njoftuara për listat e spastrimit të BKSH -së.
-Përgjigjet e bibliotekave për njoftimin e BKSH -së për literaturën e spastruar.
- Udhëzues të datës 16.08.2011 me nr. prot. 126 të Sektorit të Kualifikimit të BKSH -së.
-Kritere specifike për spastrimin e literaturës në gjuhën ruse të aneksit të Bibliotekës së Vjetër.
-Kritere specifike për spastrimin e periodikut në gjuhë të huaja (përfshirë atë rusisht) të Bibliotekës së Vjetër.
-Urdhri nr.50, dt. 05.03.2014 ish Titullarit të BKSH-së, z. X.
-Urdhri nr.56, dt. 25.03.2014 i ish Titullarit të BKSH-së, z. X.
-Urdhri nr.136, dt.07.07.2014 i Titullarit të BKSH-së, z.X.
-Urdhri nr.176, dt.13.10.2014 ish Titullarit të BKSH-së z. X.

Procesi i spastrimit të literaturës rus - sovjetike zgjati në vitet 2014-2018,u krye në koleksionet e depozituara në ambientet e godinës së Bibliotekës së Vjetër, nga grupi i komisionit të inventarizimit dhe grupi i komisionit të spastrimit. Ky proces u realizua sipas urdhrave përkatës të Ish Titullarëve bazuar në kriteret specifike dhe teknike të hartuar nga sektori i studimeve dhe i kualifikimit të datës 05.02.2014 dhe 06.02.2014 dhe rezultatet përfundimtare të këtij procesi janë të miratuara nga ish Titullari i BK-së referuar shkresës nr.241/1prot. datë 07.07.2017, z. X. Ecuria e këtij procesit është e dokumentuar dhe miratuar nga ish Titullari i BK-së dhe në përfundim të tij *rezultojnë 76.136 njësi me vlerë 6,115,102.39 lekë të bëra aktdalje,* referuar shkresës nr.232prot. datë 19.03.2018 me objekt : Memo ñMbi përfundimin e procesit të shkarkimit nga libri i inventarit të njësive të spastruara të literaturës ruse-sovjetikeò, drejtuar ish Titullarit së BK, nga përgjegjësja e Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve .

Tabela nr.15: *Tabela e njësive të spastruara të literaturës Ruse-Sovjetike*

koleksioni	njësi	shuma në lekë
Libër	70,226	5,377,801.74
Periodik	5,910	737,300.65
TOTALI	76,136	6,115, 102.39

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa i përket gjendjes në thasë të librave të mbajtura në salla te aneksi i BK me Urdhrin nr.38, datë 10.05.2021 me objekt: ñNgritjen e grupit të punës për vijimin e proceseve të punës në librin e vendosur në thasë në sallën Francezeò,nga ana e institucionit janë ngritur grupe pune për sistemimin e fondeve të mbajtura ndër vite në thasë duke kryer dhe seleksionimin e tyre.
në lekë, dhënë në tabelën në vijim:

Tabela nr. 16: Tabelë përmbledhëse e materialeve bibliotekare të seleksionuara për vitet 2018-2020

Nr	Lloji i Fondit	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Progresive ne fund të 2020	
		Njësi	Vleftë	Njësi	Vleftë	Njësi	Vleftë	Njësi	Vleftë

1	Fondi i arkivit shqip/tituj	2,654		2,811		2,185		108,460	
2	Arkivi i periodikut shqip/koleksione	506		378		248		21,906	
3	Albano-Balkanologji/ njësi shqip	378		391		385		50,569	
4	Antikuarë/njësi	0		0		(2)		2,491	
5	Dorëshkrime/njësi	0		3		0		1,199	
6	Libri shqip/(S+Fe)	9,640		10,168		8,149		445,418	
7	Libri i huaj/m njësi(Fe+P+PP+AC+SFR +Al-Ba	887		258		273		371,266	
8	Periodiku i huaj /koleksione	126		254		176		93,705	
9	Mikrofilma/njësi	0		0		0		6,302	
10	Materiale jo libra	49		27		0		409	
11	CD	12		19		0		361	
12	Harta Al-Ba/njësi	39		1		0		1,067	
13	Disertacione të huaja /njësi	27		73		44		424	
14	Periodiku shqip/koleksione	852		573		414		43,410	
15	Disertacione shqip/njësi	438		274		106		8,570	
	Totali	15,608	14,835,264.77	15,301	13,551,774.05	12,158	10,625,053.05	1,155,557	245,163,908

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në përfundim të çdo tremujori, dërgon pranë sektorit të buxhetit dhe financës hyrjet e reja të dhëna në sasi (njësi/bibliotekare dhe në vlerë totale) Në fund të çdo viti del dhe progresivi vjetor në sasi dhe në vlerë totale (bashkëlidhur tabela për këtë qëllim.) sipas burimit të ardhjes *(bashkangjitur gjeni dhe dokumentacionin shoqërues për vitin 2018-2020 për Sektorin e Financës).*

Dosja e plotë në lidhje me nxjerrjen e materialeve bibliotekare jashtë funksionit të tyre në aneksin tek rruga e Elbasanit (libra Rus etj.), procedurat e ndjekura nga komisioni i ngritur deri në heqjen nga inventari i BK-së.

Procesi i spastrimit të literaturës ruse - sovjetike zgjati në vitet 2014-2018 dhe u krye në ambientet e godinës së Bibliotekës së Vjetër. Procesi i mësipërm u krye sipas urdhrave përkatës të Drejtorisë së BK-së si dhe udhëzimeve teknikë për këtë proces nga grupi i punës. Për ecurinë e procesit është informuar në vijimësi Drejtoria e BK-së dhe në përfundim të tij rezultojnë***76,136 njësi*** **me vlerë*****6,115,102.39 lekë*** **të bëra aktdalje**:

Tabela nr.17: *Tabela e vlerave totale të njësive të spastruara të literaturës ruse-sovjetike*

koleksion	njësi	shuma në lekë

Libër	7,0226	5,377,801,74
Periodik	5,910	737,300.65
TOTALI	***76,136***	***6,115, 102.39***

Burimi i të dhënave nga BK, përpunuar nga grupi i auditimit

Praktika e plotë e dosjes përkatëse përmban:
Baza ligjore dhe profesionale:

- ✓ Ligji për Biblioteka Nr.8576, datë 03.02.2000, neni 18/1
- ✓ Ligji Nr.9217, datë 08.04.2004 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8576, dt.03.02.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò
- ✓ Udhëzues Nr.1, datë 22.09.1992 ñPër seleksionimin e fondit të librave në Bibliotekaò
- ✓ Shkresa e datë.31.10.2014 për njoftimin për ofrimin e literaturës së BKSH-së mbas procesit të spastrimit drejtuar bibliotekave të vendit.
- ✓ Lista e bibliotekave të njoftuara për listat e spastrimit të BKSH -së.
- ✓ Përgjigjet e bibliotekave për njoftimin e BKSH -së për literaturën e spastruar. Udhëzues Datë 16.08.2011 me nr. Prot.126, të Sektorit të Kualifikimit të BKSH -së.
- ✓ Kritere specifike për spastrimin e librit rus në gjuhen ruse të Bibliotekës se Vjetër.
- ✓ Kritere specifike për spastrimin e periodikut në gjuhë të huaja (përfshirë atë rusisht) të Bibliotekës së Vjetër.
- ✓ Urdhri 9 Nr.50, dt. 05.03.2014 i Drejtorisë së BKSH -së.
- ✓ Urdhri Nr.56, dt. 25.03.2014 i Drejtorisë së BKSH -së.
- ✓ Urdhri Nr.136, dt.07.07.2014 i Drejtorisë së BKSH -së.
- ✓ Urdhri Nr.176, dt.13.10.2014 I Drejtorisë së BKSH -së.

Dokumentacioni në dosje:
1.Shkresa për informacionin e spastrimit të literaturës ruse-sovjetike.
2.Pasqyra me të dhëna të detajuara të procesit të spastrimit.
3.Formulari i akt-daljes përpiluar sipas modelit të miratuar nga Drejtoria e BKSH-së bashkëlidhur formular libër; bashkëlidhur formular periodik
4.Shkresa e akt-daljes përpiluar sipas modelit të miratuar nga Drejtoria e BKSH -së
5.Formular vete deklarimi për saktësinë e aktdaljes miratuar nga Drejtoria e BKSH -së

Vlen të theksohet fakti se në bazë të Urdhrit nr.216, datë 27.03.2017 të ish Drejtorit pas rënies së zjarrit në fondin ku ishin të depozituara materialet bibliotekare u pezullua shërbimi i dhënies së librave jashtë institucionit por vetëm në sallat e leximit me fonde të hapura, shërbim i pezulluar dhe aktualisht.
Urdhri nr.729, datë 18.12.2019 të Titullarit të MK ñ Për zbatimin e urdhrit të Kryeministrit nr.153, datë 25.11.2019 ñPër marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve on-line nga data 01.01.2020.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga sektori i zhvillimit të koleksioneve për inventarizimin e fondit bibliotekar, rezultoi se:
Në sektorin e zhvillimit të koleksioneve në BK, nuk ka pasur një udhëzues pune të miratuar dhe të shqyrtuar në Këshillin Administrativ të BK-së, për organizimin e dokumentacionin përkatës shoqërues, norma teknike të përllogaritura sipas llojit të fondit dhe përcaktimi i afateve kohore sipas njësive të kryerjes së inventarëve që duhen mbajtur. Në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohet e kryer procedura e inventarizimit sipas rregullave në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pasi inventarizimi është një element shumë i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, gjendjen fizike si

dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efiçensë të tyre. (*Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7. Konkluzioni:

Në veprimtarinë e përditshme të kryer nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve u konstatuan parregullsi administrative të cilat lidhen me Komisionin e Inventarizimit të Koleksioneve i cili përfshihet brenda sektorit të sipërcituar, funksion i cili nuk duhet të mbikëqyret nga përgjegjësja e Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve pasi pengon kryerjen me objektivitet të këtij procesi të rëndësishëm, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, neni 4/pika.2, germa. C, si dhe të UMF nr.30, datë ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 82. Në institucion administrimi i koleksioneve, pasuri të grumbulluara ndër vite janë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe burime të rëndësishme informacioni shkencor, edukativ për përdorues brenda dhe jashtë vendit, proces i cili paraqitet me probleme organizative, me mungesë të akteve nënligjore për mënyrën e administrimit të tyre të pa iniciuara nga institucioni dhe të miratuara nga MK, të pa verifikuara e të mbajtura në thasë dhe në ambiente jashtë standardeve të depozitimit si pasojë e mos mbështetjes financiare nga ana e MK, për krijimin e hapësirave të reja për depozitim, duke ndikuar negativisht në dokumentimin dhe ruajtjen e këtyre aktiveve, në zbatim të kërkesave të UMF nr.30, datë27.12.2011, me qëllim menaxhimin me efektivitet të materialeve bibliotekare nga dëmtimet dhe keqpërdorimet.

-Rezulton mbajtje e koleksioneve ndër vite nëpër thasë **të pa inventarizuar** sidomos në bibliotekën e vjetër apo të quajtur ndryshe ñ*në aneksin e sajò*, dhe në ambientet e godinës së BK, fenomen i cili vazhdon edhe sot duke vështirësuar kryerjen e verifikimit të koleksioneve (inventarizimin e tyre). Një problematikë e konstatuar është dhe mungesa e mbajtjes së kartelave të materialeve bibliotekare sipas vendit të depozitimit, kryesisht në sallat e ñaneksitò të BK, si rezultat i lëvizjeve të vazhdueshme të koleksioneve gjatë ri organizimit të sallave dhe të rikonstruksioneve të kryera në ambientet e BK-së, gjë që e bën të vështirë finalizimin e inventarizimit të tyre.

Hartimi i këtij Udhëzimi specifik, nga BKSH dhe MK duhet të bazohet në ligjin nr.25, datë 10.05.2018 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 ñ Për menaxhimin e aktiveve ë njësitë e sektorit publikò, në standardet ndërkombëtare për përshkrimin bibliografik të librit e të materialeve të tjera, në ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, ligjin nr.9616, datë 27.09.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò, si dhe në Statutin e Bibliotekës Kombëtare miratuar me Urdhër nr.70, datë 13.02.2015, neni 5, neni 8 i saj.

7.1. Rekomandimi:BKSH të marrë masa të menjëhershme për inicimin e hartimit të një udhëzimi specifik për administrim, menaxhim dhe inventarizim të Fondit Bibliotekar, i cili pasi të shqyrtohet në Këshillin Administrativ të BK duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të menaxhimit bibliotekar, tõ përcillet Ministrisë së Kulturës për miratim.

Në udhëzim duhet të përcaktohet saktë dhe qartë:

-Përkufizimi i aktiveve që përbëjnë materialet bibliotekare pra Fondin e BK. Në tërësinë e materialeve bibliotekare libri zë vend kryesor e të rëndësishëm.

-Marrëdhëniet ndërmjet Sektorit të Buxhetit dhe të Financës dhe Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me shkëmbimin e informacioneve, me qëllim evidentimin në kontabilitet pra në pasqyrat financiare të gjendjes së Fondit Bibliotekar në BK. Kryerja e inventarizimit, duhet të shoqërohet me Urdhrin e Titullarit i cili duhet të përmbajë, përbërjen

e komisionit, afatet kohore, listën e materialeve bibliotekare, proces verbalet me informacion e duhur si dhe hartimin e raportit përmbledhës për rezultatet e inventarizimit sipas një formati të caktuar.

Janar 2022 e në vijimësi

7.2. Rekomandimi: Titullari i BKSH-së të ngrejë një grup punemespecialistë të fushës së bibliotekonomisë brenda dhe jashtë institucionit për seleksionimin dhe më pas spastrimin e materialeve bibliotekare kriteret e përzgjedhjes së të cilave do të shqyrtohen më parë në Këshillin Shkencor dhe të miratohen nga Titullari.

Janar 2022 e në vijimësi

7.3. Rekomandimi:BKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të marrë masa konkrete që të sigurohet depozitimi i materialeve bibliotekare në ambiente me kushte të përshtatshme depozitimi dhe sigurie afatgjatë, për ruajtje nga uji, zjarri apo vjedhja, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 ñ Për librin në Republikën e Shqipërisëò, në ligjin nr.8576, datë 03.02.200 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar si dhe në dispozita ligjore për ruajtjen dhe sigurinë e trashëgimisë kulturore në vite

Janar 2022 e në vijimësi

Observacionet e paraqitura nga Biblioteka Kombëtare sipas shkresës me nr.185/15 datë 24.09.2021 dhe protokolluar ne KLSH me numër 203/6 datë 27.09.2021 , u shqyrtuan dhe u konkludua se :

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacionet e paraqitura në. lidhje me relacionin shpjegues /sqarues / argumentues për përjashtimin e njësive/koleksioneve bibliotekare nga Udhëzimi nr.30, datë 27.11.2021 "Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik ", i ndryshuar (Parashtrime profesionale dhe juridike për pamundësinë e zbatimit të këtij udhëzimi u shqyrtua me kujdes dhe u konkludua:

Nga ana e grupit të auditimit argumentet e paraqitura për përjashtim të materialeve bibliotekare nga aktet nënligjore të dala nga MFE nuk qëndrojnë, për faktin se Biblioteka Kombëtare objekt të veprimtarisë, së saj si Njësi Publike nuk përjashtohet nga rregullat dhe procedura standarde për menaxhimin e aktiveve që jepen në UMF nr.30, datë 27.12.2011,pasi ato janë aktive që ruhen dhe administrohen nga një sija por e veçante për këto aktive janë se nuk amortizohen prandaj lind i domosdoshëm hartimi i një udhëzimi specifik qe të vendosi procedura për administrimin e tyre si asete me vlera të veçanta të cilat përbëjnë trashëgiminë e kulturës sonë kombëtare. Miratimi i këtij udhëzimi do bëhet sipas rregullave dhe procedurat ligjore sikurse çdo akt ligjor deri në miratim. Është reflektuar në Projekt Raport një shpjegim për domosdoshmërinë e këtij akti duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse. Nuk merren parasysh shpjegimet e dhëna nga institucioni.

Observacionet e paraqitura nga përgjegjësja e Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve meobjekt shpjegime, sqarime, saktësime, plotësime, kundërshtime u shqyrtuan me kujdes dhe u konkludua se:

-Referuar shkresës përcjellëse të observacioneve theksohet se rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit pothuajse janë të vlefshme dhe në veçanti për sa i përket domosdoshmërisë së rekomandimeve për sa i përket administrimit të fondit bibliotekar e cila nga ana e grupit të auditimit u trajtua me vëmendje të veçantë . Për faktin se administrimi i fondit bibliotekar referuar pyetësorëve të përgatitur dhe përgjigjeve të ardhura nga specialistë të institucionit u konstatuan problematika të cilat të cilat e bënë të domosdoshëm hartimin e një udhëzimi specifik referuar vlerave që përmbajnë aktivet (librat, antikuarët , dorëshkrimet etj materiale bibliotekare) në trashëgiminë kulturore dhe historike për vendin tonë . Domosdoshmëria e

një administrimi më të mirë e bën fakti i mungesës ndër vite të kryerjes së inventarizimit të koleksioneve dhe në përgjithësi të fondit bibliotekar si pjesë e pasurisë kombëtare të cilit duhet kushtuar ruajtje dhe përgjegjësi profesionale në dokumentimin e tyre referuar dispozitave ligjore në fuqi për administrimin e aktiveve pjesë të cilat janë dhe materialet bibliotekare (aktiva të veçantë dhe specifike sikurse dhe në botë që ruhet, vlerësohen dhe jo sepse janë të veçanta. Gjithashtu në institucion funksionon dhe Këshilli Shkencor i cili duhet të kishte dhëne kontribute në lidhje me ruajtjen dhe administrimin sa më të mirë të kësaj pasurie ndër vite të trashëgimisë kulturore . Si rrjedhojë domosdoshmëria e këtij udhëzimi reflektohet se çdo hyrje në institucion duhet dokumentuar dhe vlerësuar dhe ruajtur në bazëtë rregullave të caktuara financiare të përcaktuara në Udhëzime apo Ligje. Domosdoshmëria e hartimit të këtij udhëzimi specifik ka lindur sepse nga auditimi rezultoi se pasqyrimi në kontabilitet i të dhënave , mbajtja e kartelave të këtyre aktive i shërben ruajtjes dhe dokumentimit ndër vite të këtyre si aktive specifike duke iu referuar Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Që jeni dhe Ju, duke respektuar hierarkinë e miratimit të tij . Prandaj mendojmë se dhe rekomandimet e lëna , kanë si qëllim përmirësimin e punës për një administrim sa më të mirë të materialeve bibliotekare.
Observacioni i paraqitur nga sektori nuk reflekton, se çfarë janë përmirësuar nga rekomandimet e lëna, sidomos në drejtim të kryerjes së inventarizimeve të koleksioneve dhe gjurmëve të dokumentimit të lëvizjes së materialeve bibliotekare deri në depozitimin e tyre. Nuk merren parasysh kundërshtimet e bëra në drejtim të rekomandimeve për qarkullimin dhe dokumentimin e gjurmëve të materialeve bibliotekare si dhe në drejtim të mos hartimit të një udhëzimi për menaxhimin e materialeve bibliotekare si aktive me rëndësi të veçantë.
Observacioni i paraqitur nga z. X me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Studimeve dhe të Kualifikimit , u shqyrtua me kujdes dhe u konkludua se nuk merret parasysh pretendimet për informatizimin e praktikave dokumentare në sektorin e zhvillimit të koleksioneve pasi janë të pa dokumentuara dhe të specifikuara konkretisht. Ky sektor nuk nxjerr akoma të dhëna për sektorin e financë , në mënyrë analitike, hyrjet, daljet e materialeve bibliotekare dhe vendine depozitimit të tyre.
Observacioni i znj.X me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe të informacionit , u shqyrtua dhe u konkludua se nuk merret parasysh pasi pretendimet që provojnë dokumentimin e burimit të ardhjes së materialeve që përpunon paraprakisht në këtë sektor nuk shoqërohen për në sektorin e zhvillimit të koleksioneve i cili regjistron dokumentet pra dhe sipas burimit të ardhjes, prandaj duhen vendosur sepse i shërben një administrimi më të mirë të tyre.

4.1.2. Ajanë të mjaftueshme hapësirat bibliotekare për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj përdoruesve të librit?

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacionnëcilëndoformëqëaitëjetëdepozituar.Veprimtariaetyrerealizohetnëpërmjetpërpuni mitstandard të materialeve bibliotekare; përgatitjes dhe shpërndarjes së informacionit bibliotekar-bibliografik; krijimit dhe mirëmbajtjes së katalogëve përmbledhës të pasurisë bibliotekarekombëtaredheasajtëhuaj;shkëmbimitdhehuazimitndër-bibliotekar.Gjithashtubibliotekatjanë dhe institucione kulturore dhe informuese, që nxisin të mësuarit, zgjerimin e dijeve dheinteresinpërleximnërajoninkuatozhvillojnëveprimtarinëetyre.

-Auditimi për këtë qëllim u realizua në bazë të pyetësorëve të hartuar nga grupi i auditimit dhe të intervistave me përgjegjës dhe specialistë të sektorëve përkatëses me të dhëna për

këtëqëllim, e konkretisht nisur dhe nga rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm ku konstatohet se nuk ka ecuri të rekomandimit lidhur me hapësirat bibliotekare në BKSH.
-Nga sa më sipër u shqyrtua me shumë kujdes zbatimi i rekomandimeve të lëna nga raporti i auditimit të KLSH-së, me nr.prot 100/26, datë 26.12.2014, dhe u evidentua se:
1-Referuar rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja ishte jo vetëm mungesa e një strategjie afatmesme apo afatgjatë mbarëkombëtare për bibliotekat publike dhe kryesisht për Bibliotekën Kombëtare por problematikat serioze në lidhje me hapësirat, sipërfaqet e domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë së BKSH.
-Në institucion në lidhje me hapësirat e munguara ndër vite referuar dhe kërkesave institucionale të kryera nga ish Titullarët drejtuar MK aktualisht rezultojnë pa zgjidhje të problemit.
-E konkretisht në institucion nuk ka një përgjigje nga MK për statusin juridik të pronës, gjithashtu nga ana e MK në lidhje me ndërtimin e një godine të re për BK megjithëse është pranuar nga ana e saj hartimi i një projekti, nuk janë dhënë afate kohore dhe fonde për realizimin e saj. Aktualisht gjendja e sipërfaqeve si depozituese të fondeve të BK ashtu edhe ambientet që përdoren nga lexuesit janë pothuajse të mbyllura pasi ato përdoren si vende depozitimi librash.
-Nga viti 2017 në institucion nuk funksionon shërbimi jashtë BK për lexuesit, për faktin e gjendjes së rënduar të koleksioneve në vendet e depozitimit, referuar urdhrit të ish titullarit të BKSH-së, z. X me nr.286. prot, dt.05.05.2017 drejtuar sektorit të koleksioneve dhe sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse. Ky urdhër kryesisht është për sallat e fondeve (katet e nëndheshme) të godinës pasi situata është jashtë standardeve për sa i përket sigurisë nga zjarri.
-Një problematikë e konstatuar nga grupi i auditimit janë dhe ndryshimet e vazhdueshme të veprimtarisë së sallave të hapura për lexuesin sidomos tek aneksi i BK në rrugën George Ë Bush, ku dhe depozitohen libra sipas gjuhëve dhe sallave përkatëse, referuar strukturës dhe organikës të BK nr.139, datë 28.03.2014, ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.122, datë 17.09.2019, ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò, e cila vjen nga mungesat e politikave afatgjata të shërbimeve ndaj lexuesve. Ndryshimet e vazhdueshme të politikave ndaj hapjes së sallave ndikojnë direkt në ruajtjen dhe dokumentimin e fondeve të BK, të cilat dhe sot aktualisht mbahen në thasë jashtë hapësirave të përshtatshme depozituese referuar standardeve ndërkombëtareIFLA, për këtë qëllim.
Në fund të vitit 2020, MK ka lidhur kontratë me nr. 4246/10. prot., datë03.12.2020 për fillimin e rikonstruksionit të ambienteve të aneksit të BK ose ish ï Bibliotekës së vjetër, me fondet e MK. Kontrata është parashikuar të përfundojë në një periudhë dy vjeçare, brenda datës. 31.12.2022.

- **Standardet ndërkombëtare për hapësirat e Bibliotekave.**

NjëfenomentjetërqëduhetpërmendurnëfushëneshërbimitbibliotekarjanëstandardetndërkombëtareqëpunonsotshërbimibibliotekardhenëmënyrëtëveçantëBKSHkukryesisht, veprimtariaetyrembështetnëstandardetndërkombëtaretëIFLA-skuBibliotekaKombëtare është anëtarësuar në vitin 1977. Vijimi i shërbimit bibliotekar drejt plotësimit të standardevendërkombëtarëduhettëbëhetkrahaspërpjekjevepërnxitjeneMinistrisëKulturëssiorgan epror dhe më lart, që ato të bëhen pjesë e legjislacionit bibliotekar për ti dhënë atyre një fuqi mëtë madhe, si dhe detyrimi ligjor duke i kthyer të gjitha instancat më të përgjegjshme dhe mëdetyruese për zbatimin e standardeve, ose drejt ecjes se tyre si qasja më e mirë. Nëse standardetndërkombëtare në bazë të cilave punon shërbimi bibliotekar dhe BKSH mbeten

vetëmbrenda këtij shërbimi atëherë instancat më të larta nuk do të përgjigjeshin ñligjërishtò përreflektim ndaj tyre për ta ngritur këtë shërbim në standardet ndërkombëtare dhe jo ta lënë në gjendjen qëndodhet aktualisht.

Çfarëjanëstandardet?

Standardet janëdokumenteteknike,vullnetare,tëmiratuara,tëcilët:

- ✓ përmbajnëspecifikimeteknikepërprodukteaposhërbimetëfushavetëndryshme;
- ✓ përgatitenmepropoziminepalëvetëinteresuara,pjesëmarrësosejonëKomitetetTekniket ëndryshme;
- ✓ bazohennërezultatetezhvillimitbashkëkohor;
- ✓ miratohenmekonsensus;
- ✓ vihennëdispozicióntëkujtdo.

Standardetebëjnëveprimtarinëmëtëthjeshtëdherrisinbesimindheefikasitetineshërbimit.Standar dizimiibënpërdoruesittëkenëbesimnëcilësinëdhebesueshmërinëeshërbimit.Ngastandardetpërfit ojnëtëgjithë,sepsedukepunuarmestandarde:

- ✓ ulkoston;
- ✓ kaefektepozitivenëkomunikiminndërmjetsektorëve;
- ✓ siguronniveletëulëtatëproblematikaveemosmarrëveshjeve;
- ✓ rritbesueshmërinënësigurinëeshërbimit;
- ✓ përfitonpërdoruesi;
- ✓ ndikojnënësistemetedrejtimit;
- ✓ ndikojnënësistemetecilësisë;

Në bazë të standardeve IFLA-s (International Federation Library Asociacion and Institucion) duhet që BKSH të ketë në dispozicion 45 deri në 50,000m2 hapësira për funksionimin e plotë të saj si në ruajtjen, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimit për lexuesit e interesuar.
Bibliotekës Kombëtare aktualisht i mungon: e

- Sipërfaqja e mjaftueshme për depozitimin dhe vendosjen e koleksioneve bibliotekare
- Hapësira për vendosjen e librave të rinj që hyjnë çdo ditë në Fondet e BKSH-se sipas legjislacionit në fuqi:
- Hapësira e përshtatshme për të mundësuar përdorimin e shërbimeve bibliotekare.
- Hapësira e mjaftueshme për punonjësit dhe sektorët, përdoruesit, veprimtaritë etj.
- Mjedise për njerëzit me aftësi të kufizuara etj.;
- Hapësirat e vendosjes së pajisjeve elektronike, kompjuterike dhe audio vizuale;
- Mjediset për organizimin e veprimtarive (promovime, ekspozita, konferenca, seminare etj.
- Hapësirat për shërbimet mekanike: ngrohje, ventilim, mirëmbajtje etj.
- Hapësira pushimi të lexuesve.
- Hapësira të tjera.

Në një përllogaritje standarde duhet përfshirë edhe **rritja progresive**e nevojës së hapësirës depozituese. Mesatarisht, ndërtesat e Bibliotekave Kombëtare përllogariten në një perspektivë ***50 deri 100 vjeçare,*** duke shmangur përsëritjen e shpeshtë të mungesës së hapësirës si dhe investimeve të shpeshta për zgjerim.
Tabela e mëposhtme janë një studim i kryer nga stafi i BK-së që sjellin të dhëna aktuale dhe krahasuese me standardet e IFLA-s (Internacional Federation Library Asociacion and

Institucion) për hapësirat në BKSH. IFLA është autoriteti i unifikuar botëror në fushën e bibliotekonomisë, standardet e së cilës janë të detyrueshme për të gjitha Bibliotekat Kombëtare e më gjerë.

Tabela nr.18: *Krahasim mes gjendjes aktuale dhe standardeve tekniko-profesionale në një perspektivë afatgjatë* ***(50 vjeçare)***

Lloji i hapësirës	Sipërfaqja aktuale	Sipërfaqja e nevojshme	Diferenca mes tyre
Hapësira depozituese për koleksionet aktuale	1560 m²	12.000m²	8 herë më pak
Hapësira për lexuesit	532 m²(rreth 700 frekuentues në ditë)	2000 m²	3.75 herë më pak
Hapësira për personelin	500 m²	1700 m²	3.4herë më pak
Hapësira për mjedise higjiene-sanitare, mekanike etj.)	250 m²	2800 m²	11 herë më pak
Hapësira për libra të rinj që hyjnë çdo vit	0 m²	300 - 500 m² në vit	
Hapësira depozituese e nevojshme për së paku 50 vitet e ardhshme	0 m²	25 000 + 12 000 = 37 000 m²	
Hapësira, ekspozimi, trajnimi etj.		Në funksion të projektit	
Hapësira afatgjatë në total (me përafërsi)		45 000-50 000 m²	12 herë më pak

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.19: *Krahasuese mes gjendjes aktuale dhe standardeve tekniko-profesionale në një perspektivë afatmesme* ***(25 vjeçare).***

Lloji i hapësirës	Sipërfaqja aktuale	Sipërfaqja e nevojshme
Hapësira depozituese për koleksionet aktuale	1,560 m²	10,000 m²- 12,000 m²
Hapësira për lexuesit	532 m²(sipas frekuentimit mesatar me rreth 700 frekuentues në ditë)	1000 m²
Hapësira për personelin	500 m²	1,500 m²
Hapësira për mjedise higjiene-sanitare, mekanike, etj.)	250 m²	2,000 m²
Hapësira për librat e rinj që hyjnë çdo vit	0 m²	400 m² në vit
Hapësira depozituese për 25 vitet e ardhshme	0 m²	20,000 m²ï 22 000 m²
Hapësira ekspozimi, formimi e trajnimi, edukimi, etj.		100 m²
Hapësira në total	2,850 m² (aktuale)	Rreth 25,000 m² (edomosdoshme)

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Një Bibliotekë Kombëtare e re me sipërfaqe vetëm 12,000 m² është ñmision i pamundurò

Pra edhe Biblioteka e re Kombëtare do të vijonte të ishte në një krizë hapësirash.

Gjithashtu pa mundur të vijojë akumulimin e përvitshëm të librave të rinj, për arsyet e mëposhtme:
Pjesa e mbetur në dispozicion të depozitimit të librit mbasi nga sipërfaqja e përgjithshme zbresim sipërfaqe rreth 5,000 m² për poste leximi, poste pune për stafin aktual dhe hapësira të paracaktuara + shërbimi: 12,000 m² ï 5,000 m² = 7,000 m²
-Edhe nga ndarja e koleksioneve për themelimin e Bibliotekës së Qytetit të Tiranës me rreth 400,000 njësi, BKSH i mbeten gjithsesi jo më pak se 800,000 njësi:
1,200,000 njësi në total (libra, gazeta, revista etj.) ï 400,000 njësi = 800,000 njësi.
-Për 800,000 njësitë aktuale do të duhej të depozitoheshin në se paku 8,000 m², ndërsa sipërfaqja depozituese do të ishte vetëm 7,000 m².
-Nga sa më sipër Biblioteka Kombëtare, sugjeron konceptimin e një projekti më afatgjatë, i cili do të parashikonte në të ardhmen shtesa anësore apo ngritje të kateve të mësipërme, për të rritur potencialin e kësaj ndërtese në vitet e mëtejshme.
-Vazhdimisht nga ky institucion janë ngritur këto shqetësime, sidomos në lidhje me infrastrukturën, dhe fakti është i pamohueshëm:

Ndërtesa e BK është lënë jashtë vëmendjes së MK duke e "harruar" dhe duke e lënë atë si përpara 60 vjetësh.
Mungesa e ambienteve ka vështirësuar kryerjen e verifikimeve te materialeve bibliotekare (libra, koleksione te rralla) si dhe ruajtjen e tyre sipas standardeve ndërkombëtare IFLA.
-Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit të KLSH, në ambientet e institucionit, për mungesë fondesh dhe hapësirash nuk janë realizuar detyrat më kryesore të lëna nga Inspektoriati i PMZSH-së në fushën e sigurisë për mbrojtjen nga zjarri.
Biblioteka Kombëtare, veçanërisht në sallat e fondeve (katet e nëndheshme) vazhdon të ketë të njëjtat pajisje dhe sisteme elektronike për mbrojtjen nga zjarri të cilat janë në përdorim prej me shumë se 20 ï 25 vjetësh dhe të amortizuara.
Edhe pse me fonde të pamjaftueshme në artikullin 602 (shpenzime korrente) të buxhetit, i është kushtuar çdo vit rëndësia e duhur e kryerjes së shërbimit për mirëmbajtjen e tyre, ku janë kryer të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve/impianteve/sistemeve elektronike për mbrojtjen nga zjarri, të rimbushjes dhe kolaudimit të fikseve të zjarrit etj.
Në sallat e fondeve (katet e nëndheshme) të BK-së sa i përket masave të PMZSH-së dhe Institutittë Ndërtimit është cilësuar se këto pajisje nuk plotësojnë normat e sigurisë teknike për mbrojtjen nga zjarri.
Aktualisht me shërbimet e kryera situata paraqitet si më poshtë:
Janë në gjendje të rregullt dhe funksionale

- Sistemet elektronike të diktim sinjalizimit të zjarrit, vetëm nëpërmjet dhënies së alarmit me Sirena (dhe jo nëpërmjet centralit telefonik);

- Janë në funksion fikset e zjarrit automatike vetë shpërthyese dhe të dorës (me pluhur



dhe CO2);
- Janë në funksion sistemi i impiantit hidrant i shuarjes së zjarrit në sallat e fondeve.

Foto të fondit në katin e nëndheshëm.

Foto të hapësirave të rafteve depozituese.

Ne ambientin e depozitimit të fondeve fikset e zjarrit nga mbingarkesa e rafteve me libra në rast zjarri nuk arrijnë të mbulojnë deri në lartësinë e rafteve të sipërme të cilat janë të mbushura me libra deri në tavanin e ambientit depozitues, çka përbën një risk potencial në rast të ndonjë shkëndije elektrike apo zjarri pasi dhe instalimet elektrike në disa vende u evidentuan jashtë parametrave teknik të cilat po jua paraqesim në fotot e mëposhtme.

Gjithashtu mungesa e hapësirave në fond është një problem i kahershëm. Hapësirat e fondeve janë të mbingarkuara me materiale bibliotekare. Nga viti 1989 ka filluar vendosja e librave në raft imagjinar, që nënkupton:

- Vendosje të materialeve bibliotekare të shtrirë përtokë ose të vendosura deri në tavan.
- Vendosje të materialeve bibliotekare në raft tresh

-Vendosje të materialeve bibliotekare stivë.

Të tria këto vendosje janë jashtë standardeve dhe teknikës bibliotekare, pasi:

1. Dëmtohet materiali bibliotekar;
2. Nuk lejon shërbimin e shpejtë dhe të rregullt ndaj përdoruesit;
3. Pengon punën për inventarizim.

Hapësirat e korridoreve të ambienteve të fondit janë të zëna nga materiale periodike të vendosura në stivë. Vitet e fundit mbi stivën e gazetave janë vendosur edhe libra.

Të zëna janë edhe hapësirat mes raftesh, të cilat kanë të shtrira përtokë libra.
Ka humbur konceptimin e sallës së ndërtuar siç janë: salla e librit shqip, salla e librit të huaja, salla e gazetave apo salla e Arkivit, pasi kemi ndërfutje të materialeve bibliotekare të ndryshme.
Në sallën e librit të huaj (P1) janë të vendosura materiale si: libër i huaj, periodik revistë e huaj, periodik gazetë arkiv, hartë, libër arkiv dhe në këtë ambient është krijuar hapësirë për të ruajtur disertacionin shqip dhe të huaj.

Në sallën e librit të huaj (P400) janë të vendosura libër i huaj, në raft tresh është futur libër shqip, përtokë në hapësirat mes raftesh është shtruar periodik gazetë.
Salla e arkivit ka një mbingarkesë pasi janë vendosur arkivi i librit të vjetër, arkivi i librit koherent, arkivi i periodikut (gazetë dhe revistë), materiale albano-balkanologjike, librat me vlerë, antikuarë dhe dorëshkrime.

Problematikat për ambientin e arkivit janë:

- Nuk ka hapësirë të veçantë dhe kushte për ruajtjen e librit të rrallë si antikuarë dhe dorëshkrime (cilësojmë që janë të vendosura në arka metalike).
- Arkivi është i vendosur në rafte tresh ose përtokë.
- Periodiku (gazetë) arkiv është i vendosur në stivë dhe ka pushtuar hapësirat e korridoreve të fondit duke vështirësuar kalimin gjatë shërbimit dhe kalimin në rastet e



emergjencës.

- Periodiku (revistë) arkiv është i shtrirë përtokë në hapësirat mes raftesh.
- Që nga viti 2017 është stopuar hyrja e librit të ri për shkak të mungesave të hapësirës dhe ngjarjeve të ndodhura (rënia e zjarrit dhe përmbytja nga uji).
- Problematikë tjetër është edhe prezenca e lagështirës që ka në muret ndarës, me pjesën kufizuese me institucionet e tjera të Pallatit të Kulturës.

Më poshtë ju paraqesim foto të instalimeve elektrike dhe gjendjen e tyre aktuale të cilat paraqesin risk serioz në katet e nëndheshme aty ku ndodhen dhe fondet bibliotekare dhe

koleksionet e rralla dhe antikuarë.







1. Gjetje nga auditimi: Shërbimi i BKSH, me gjithë hapat e ndërmarra, ka mungesatë theksuara; në hapësira për depozitimin, shërbimin ndaj përdoruesit dhe personelin; të kushteve në shërbim tëpërdoruesitmeaftësitëkufizuar;mungesa e hapësirave të pushimit dhe shërbimit; hapësirave për ekspozita; mungesa e kushteve tëpërshtatshme mjedisore e klimaterike, si dhe të pajisjeve si: tavolina, karrige, kompjuterë;mungesa e orareve të përshtatshme për lexuesin; mungesa të materialeve bibliotekare; etj., në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të IFLA, UNESCO etj., tëcilatvazhdojnëtëjenëgjithmonë nërëniemerritjenenumrittëlexuesvedhetëpërdoruesve.
(*Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.2 faqe 73-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1. Konkluzion: Mungesa e hapësirave për depozitim e shërbim ndaj përdoruesve, kushteve të veprimtarisëka bërë që ky shërbim të jetë jo në përputhje të standardeve të IFLA-s në plotësimin eqëllimittësaj,iciliështëplotësimiinevojavebibliotekaredheinformuesetëkomunitetit dhepërdoruesvetëcilit ishërben.
Ajo që është shqetësuese është se edhe sot pas 6-vitesh nga auditimi i fundit situata vazhdon e njëjtë dhe më problematike pasi sa më shumë kalojnë vitet, aq më shumë amortizohet ndërtesa, duke sjellë një risk të lartë si në rënien e zjarrit ashtu edhe në përmbytjen e katit të parë, ku ruhet edhe fondi i vlerave të rralla, që për vetë rëndësinë që ai ka do të ishte "katastrofë kombëtare" humbja e tij .
Që prej vitit 1986 është ndjerë mungesa e hapësirës për të vendosur materialet bibliotekare në fond, çfarë ka detyruar që jashtë çdo standardi botëror të gjenden zgjidhje provizore të natyrave të ndryshme:

- Materialet bibliotekare nuk vendosen në rafte, por në dysheme;
- Fondi i vlerave të rralla (antikuar dhe dorëshkrime) vendoset pjesërisht në arka metalike jashtë çdo normative e standardi ndërkombëtar;

1.1. Rekomandimi: Ministria e Kulturës në bashkëpunim me BKSH-në dhe Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, të analizojnë gjendjen aktuale të hapësirave të BK-së, dhe të hartojnë një plan konkret emergjent për zgjidhjen e krizës së ambienteve në bibliotekë.

Brenda Vitit 2022

1.2. Rekomandimi: MinistriaeKulturësdheQeveriaShqiptaretëmendojnë,përpunojnëeimplementoj nënjë plan konkret e afatgjatë për ri konceptimin e shërbimit bibliotekar, për vënien në dispozicion të mjediseve shtesë për Bibliotekën Kombëtare, nëpërputhjemestandardet botërore të IFLA-s, për ofrimin eshërbimitcilësorndajlexuesvedhenëpërmbushjetëkërkesavepër arkivim të librit dhe koleksioneve, për më shumëqasje në informacion dhe edukimpërmesartitdhekulturës.

Brenda Vitit 2022

Ndarja e funksioneve të Bibliotekës Kombëtare.
Për shkak të mungesës së një Biblioteke të qytetit të Tiranës, ndërkohë që edhe popullsia shumëfishohet çdo ditë, BKSH nuk mund të kryejë funksionet e një biblioteke publike të Tiranës. Në kushtet kur parimet dhe funksionet e një biblioteke publike janë në thelb të ndryshme nga ato të një biblioteke kombëtare (përcaktuar sipas standardeve të IFLA-s) etj., është përfituar një Institucion ñhibridò, i cili punon i sforcuar për të kryer dy funksione tepër të ndryshme nga njëri tjetri duke vështirësuar dhe rënduar çdo ditë e më tepër proceset funksionale tip të BKSH, prandaj del imediate kjo ndarje e cila për momentin nuk ka

ñshpresëò të kryhet. (*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.2 faqe 73-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2. Konkluzion: Për shkak të mungesës së një Biblioteke të qytetit të Tiranës, BKSH ka detyrë ligjërisht dhe kryen praktikisht funksionet edhe të një biblioteke publike për Tiranën. Në kushtet kur parimet dhe funksionet e një biblioteke publike janë në thelb të ndryshme nga ato të një biblioteke kombëtare (përcaktuar sipas standardeve të IFLA-s)

etj., është përfituar një Institucion ñhibridò, i cili punon i sforcuar për të kryer dy funksione tepër të ndryshme nga njëri tjetri. Menaxhimi i kësaj veprimtarie ku ka mbivendosje të funksioneve dhe mungesë të kapaciteteve si në burime njerëzore dhe në hapësira sjell jo efikasitet në aktivitetin e Bibliotekës Kombëtare.

2.1. Rekomandimi: Ministria e Kulturës dhe QeveriaShqiptaretë shikojë mundësinë e ndarjes së funksionit publik të BKSH-së nga ai kombëtar sipas modeleve/praktikave botërore, pasi krijimi i një biblioteke për kryeqytetin është një domosdoshmëri dhe kërkesë imediate e kohës.

Brenda Vitit 2022

4.1.3 A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare në përmirësimin e infrastrukturës së BK?

Auditimi në lidhje me burimet financiare të BK për realizimin e funksioneve të saj si qendër studimore e shkencore në fushën bibliotekonomisë dhe të shërbimit bibliotekar, dhe qendra e arkivit të botimeve Shqip, u mbështet në ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 ñ Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar neni 21, neni 25, neni 27; në Statutin e Bibliotekës Kombëtare të miratuar me Urdhër nr,70, datë 13.02.2015 të ish Titullarit së MK, neni. 20 dhe Rregulloren e Bibliotekës Kombëtare, miratuar me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010 të ish Titullarit të BK, neni.17.

Biblioteka Kombëtare si institucion buxhetor për realizimin e veprimtarisë së saj financohet nga Ministria e Kulturës si institucion i varësisë.

Në mungesë të Strategjisë Kombëtare për Kulturën nga MK, dhe të fondeve buxhetore kryesisht në drejtim të investimeve si rikonstruksione në godinën qendrore ekzistuese si dhe në sigurinë e saj, ndër vite ka ndikuar direkt si në arkivimin dhe sigurinë e koleksioneve sidomos atyre të rralla por dhe në pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve pasi blerje librash Shqip nuk kryhen ndër vite, referuar urdhërpagesës nr. 221, datë 24.11.2010 në vlerë prej 72,000 lekë dhe urdhërpagesës nr.228, datë 01.12.2010 në vlerën prej 8,000 lekë gjë që tregon se blerja e fundit të librave i takon vitit 2010.

BK, sipas ligjit nr. Nr.8576, datë 3.2.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 27, citohet se:

-Për të realizuar pasurimin e koleksioneve me vlerë kombëtare, Biblioteka Kombëtare kryen blerje me fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Biblioteka Kombëtare e ushtron veprimtarinë e saj në 2 (dy) objekte, përkatësisht në :

1. *Ndërtesën qendrorë (Pallati i Kulturës), sheshi "Skënderbe", Tiranë, Monument Kulture i kategorisë së dytë;*
2. *Në ndërtesën e aneksit të BK-së (biblioteka e vjetër), rruga "G.Ë.Bush", Tiranë, Monument Kulture i kategorisë së dytë;*

Institucioni për dy objektet që disponon të cituara më lart nuk disponon asnjë dokument (akt pronësie/ akt administrimi), ku zhvillon veprimtarinë e saj, **referuar** kërkesës së BK drejtuar MK me shkresën nr. 273. prot. datë 03.03.2021 me objekt ñKërkesë për vënie në dispozicion të akteve të pronësisë/akt administrimit për të dy ndërtesave të Bibliotekës Kombëtareò, dhe

aktualisht nga MK nuk ka kthim përgjigje. Institucioni ka bërë aplikim për dhënie informacioni mbi gjendjen juridike të pronës në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me datë 09.03.2021, por nuk rezulton asnjë përgjigje mbi gjendjen juridike të 2 objekteve.

Situata aktuale tregon për trajtimin nga MK e institucionit unik bibliotekar kombëtar për Shqipërinë, jo me vëmendje dhe me një qasje të veçantë por e lënë në harresë referuar situatës të rënduar të ambienteve të ndërtesës shumë të amortizuar pa hapësira të depozitimit të arkivit të koleksioneve dhe pa standarde sigurie, gjë që evidentohet nga mos financimi ndër vite për një ndërtesë të re me standarde bashkëkohore referuar së fundmi shkresës me nr.618. prot. datë 25.11.2019 me objekt ñ Kriza e hapësirësò, drejtuar Ministres së Kulturës, nga Titullari aktual i BK.

Edhe në Strategjinë Kombëtare për Kulturën e hartuar nga MK për vitin 2019-2025 e miratuar me VKM nr.903, datë 24.12.2019, përcjellë në formë elektronike Drejtorit të BKSH-së më 22 Prill 2020, megjithëse është parashikuar hartimi i projekt ideve për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore ku përfshihet dhe projekti për ngritjen e Bibliotekës Kombëtare, është i pa shoqëruar me afate kohore dhe mbështetur me fonde buxhetore për realizimin e tij.

Referuar Raporteve Vjetore të Bibliotekës Kombëtare, si institucion varësie i MK, rezulton se:

-Biblioteka Kombëtare për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2020, është financuar me fonde buxhetore nga Ministria e Kulturës:

- ✓ për vitin 2018 në shumën prej 102,459 mijë lekë ose 4,4 % të totalit të fondeve të MK,
- ✓ për vitin 2019 në shumën prej 99,011 mijë lekë ose 4,3% të totalit të fondeve të MK,
- ✓ për vitin 2020 në shumën 99,894 mijë lekë ose 4% të totalit të fondeve të MK,

fonde të cilat kanë pësuar ulje ndër vite dhe në mungesë totale të fondeve për investime të kërkuara në PBA e Bibliotekës Kombëtare drejtuar MK.

-Fondet për investime për Bibliotekën Kombëtare janëdhënë për vitin 2018 dhe për vitin 2020 vetëm si fonde për rastet emergjente, si rezultat i dy ngjarjeve të rënda të ndodhura, zjarri dhe përmbytja në sallën P300.

Për këtë arsye jashtë planifikimit të buxhetit (pra jo sipas kërkesave vjetore në PBA-së BK drejtuar MK) u alo kuan fonde nga MK për rikonstruksione (punime elektrike, ndërtime etj.) në Gusht të vitit 2018 dhe në Shtator 2020, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në katet e nëndheshme në 15 Mars 2017 dhe përmbytja në datë23.06.2018 në P.300.

Për vitin 2019 nuk janë dhënë fonde për investime pavarësisht kërkesave të paraqitura nga institucioni në PBA e vitit.

Për sa më sipër po paraqesim sipas tabelës nr.21, fondet buxhetore në total të akorduara si për MK dhe BK dhe në veçanti fondet për investime të BK dhe ato të MK për periudhën objekt auditimi.

Ministria e Kulturës/ Biblioteka Kombëtare

Tabela nr.20*:Fondet për shpenzimet buxhetore / kapitale për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Në 000/ lekë*

Institucioni	Shpenzimet	Viti		
		2018	2019	2020
Ministria e Kulturës	Totali i fondeve për shpenzime kapitale	853,000	785,000	1,097,950
	Totali i fondeve për shpenzime buxhetore	2,282,153	2,275,687	2,526,331
Biblioteka Kombëtare	Totali i fondeve për shpenzimeve kapitale	1,956	- - -	2,400
	Totali i fondeve për shpenzimeve	102,459	99,011	99,894

	buxhetore			

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Grafikisht paraqitja e fondeve për shpenzimet buxhetore të kryera nga MK dhe Biblioteka Kombëtare referuar akt rakordimeve të planit të buxhetit, situacioneve të shpenzimeve vjetore të konfirmuara nga MF dhe Dega e Thesarit Tiranë si dhe totalin e fondeve për shpenzime për investime si për MK dhe BK të konfirmuara nga MF dhe MK, dega e thesarit Tiranë, paraqiten si më poshtë vijon:

Grafiku nr. 1*.Totali i fondeve të shpenzimeve kapitale*



Grafiku nr.2*Totali i fondeve tëshpenzimevebuxhetore*



Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa i përket problematikave në ndërtesën e aneksit të BK-së (biblioteka e vjetër) në Dhjetor 2020, Ministria e Kulturës ka filluar rikonstruksionin e kësaj ndërtese, me fondet e saj duke mundësuar zgjidhjen e problematikave në lidhje me ruajtjen dhe sigurinë nga dëmtimet e mundshme (zjarri, lagështira, dëmtime, vjedhje etj.) të këtij objekti dhe të materialeve bibliotekare që janë të depozituara në këtë objekt.

Për sa i përket financimit të politikave të pasurimit të koleksioneve rezulton se:

-BK për periudhën 2018-2020 e në vazhdim nuk ka kryer asnjë blerje të materialeve bibliotekare, kryesisht libra albano-balkanologjike në funksion të detyrave duke mos realizuar detyrat e saj për krijimin dhe pasurinë e koleksioneve sipas nenit 15 të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000, i ndryshuar, kjo për faktin se nuk janë akorduar fonde për këtë qëllim nga MK pavarësisht kërkesave në PBA të BK, të trajtuar më hollësisht në tabelën 2 dhe 3. Referuar kontratës së dhurimit nr.595 datë 09.10.2019, janë dhuruar sallës Franceze në BK libra dhuratë në sasi prej 254 libra nga Ambasada Franceze.

Për sigurinë dhe ruajtjen e materialeve bibliotekare në vendet e depozitimit të tyre, rezultuan problematike financimi nga MK për vitet objekt auditimi si më poshtë:

-Mos akordimi i fondeve për masat e sigurisë në sallat e fondeve (katet e nëndheshme) nga vjedhjet e mundshme nga keqbërës të jashtëm ku janë të depozituara materialet pasi ato janë të kufizuara me ambiente të tjera të objektit të Pallatit të Kulturës. Biblioteka Kombëtare ka të instaluar në ambientet e sallave të fondeve(katete nëndheshme) një sistem elektronik të ruajtjes dhe sigurisë fizike nga vjedhjet nga keqbërës të jashtëm, i cili qysh nga rënia e zjarrit në muajin mars 2017 është i dëmtuar dhe është jashtë funksioni. Për këtë qëllim BK në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar në Ministrinë e Kulturës fonde për blerjen e një sistemi të ri elektronik *të ruajtjes nga vjedhjet* (pasi ekzistuesi është i pariparueshëm), por nuk është bërë i mundur alokimi i fondit për blerjen dhe montimin e këtij sistemi (referuar të dhënave nga Tabela 2).

-Problematikparaqitet mos financimi nga MK në sistemet/pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, të instaluara/montuara në sallat e fondeve (katet e nëndheshme) dhe në ambiente të tjera të BK-së, megjithëse janë në gjendje funksionale, sipas mendimit të ekspertëve të fushës si: Inspektorati i MZSH-së, Instituti i Ndërtimit, rezultojnë tejet të amortizuara si rezultat i jetëgjatësisë dhe nuk japin garanci për kryerjen e funksionit të tyre në dhënien e sinjalizimit në raste zjarri;
Fikset tava norë automatike të zjarrit me pluhur nuk janë efikase për shkak të vendosjes së tyre jo në korrespondencë me çdo hapësirë ndërmjet rafteve me libra, duke lënë pjesën më të madhe të hapësirës ndërmjet rafteve të pambuluar dhe të pambrojtur.
Ndërkohë përdorimi i pluhurit për shuarjen e zjarrit e dëmton librin, pasi pastrimi i librit nga pluhuri zjarrshuarës është mjaft i vështirë dhe pothuajse i pamundur të pastrohet në masën 100%.
Po ashtu vendosja e librave në rafte deri në tavan, (shumë afër ndriçuesve elektrik) dhe mbi nivelin e veprimit të pluhurit zjarrshuarës të fikseve bën që zjarri i rënë mbi këtë nivel të mos shuhet.
Përfundimisht janë kërkuar fonde për impiantin e shuarjes së zjarrit me ñAEROSOLò (gaz IG55 me përzierje 50% Azot dhe 50% Argon), pasi është më efikase dhe më i përdorshëm në rastin konkret për bibliotekën, pasi Argoni është një gaz inert, jo toksik dhe miqësor me ambientin, vepron mbi zjarrin duke ulur sasinë e oksigjenit nga 20.9% në 15% dhe gjatë shuarjes së zjarrit nuk dëmton objektet mbi të cilat vepron, përfshirë dhe librat, referuar detyrave të lëna nga Inspektorati i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMZSH) në Akt-Kontrollin nr.15, datë 27.03.2017, me protokoll hyrje në institucion nr. 92, datë 27.03.2017, me objekt: ñPër kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò dhe konkluzioneve të Institutit të Ndërtimit.

Biblioteka Kombëtare mban nën kontroll të vazhdueshëm situatën profilaktike- dezinfektuese të dy objekteve të institucionit dhe materialeve/pajisjeve, materialeve bibliotekare dhe në mënyrë të veçantë kontrollit të vazhdueshëm të sallave të fondeve, katet e nëndheshme, salla leximi etj., ku janë të depozituara materialet bibliotekare si libra, periodikë etj. Totali i shpenzimeve për dezinfektim viti 2018-2020 është realizuar në shumën prej 701,354 lekë. Po paraqiten si më poshtë vijon buxheti i akorduar nga MK për shpenzime operative BK për periudhën objekt auditimi:

***Tabela nr.21**: Buxheti i Bibliotekës Kombëtare për vitet 2018-2020 në artikullin 602 (shpenzime operative) si më poshtë:* *Në 000/lekë*

Artikulli	*Emërtimi*	*Viti 2018*		*Viti 2019*		*Viti 2020*	
		Planifikimi	*Plan buxheti*	*Planifikim*	*Plan buxheti*	*Planifikimi*	*Plani buxheti*
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	1870	1,243	1,305	1,316	1,305	1,492
6021	Materiale dhe Shërbime speciale	1180	380	1,400	0	1,500	145
6022	Shërbime nga të tretët	13083	9,333	12,275	9,936	12,275	9,719
6023	Shpenzime transporti (karburant, nafte ngrohje)	2860	989	2,260	988	1,950	1,090
6024	Shpenzime udhëtimi	350	232	350	400	350	64

6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1930	1,308	2,080	1,118	1,830	1,403
6026	Shpenzime për qiramarrje						
6027	Detyrime (vendime gjyqësore)				1,551	1,554	
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua						
6029	Shpenzime të tjera operative	1731	103	1,730	147	1,740	67
602	**Totali i shpenzimeve operative**	**23004**	**13,588**	**21,400**	**15,456**	**22,504**	13,980

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Më poshtë në mbështetje të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarisë së institucionit, ku përfshihen dhe përmirësimi i masave për ruajtjen dhe sigurinë fizike nga dëmtimet e mundshme të objekteve të institucionit, veçanërisht ato në sallat nëntokësore të fondeve (ku ruhen materiale bibliotekare me rëndësi kombëtare e më gjerë), institucioni ka kërkuar vazhdimisht fonde nga Ministria e Kulturës.

Bashkëlidhur po paraqesim shkresat e dërgimit të kërkesave për fonde si për investime dhe për shpenzime të përgjithshme si më poshtë:

a. Shkresa me nr. 143.prot., datë 20.04.2017 ñKërkesë për alokim fondesh drejtuar Ministrisë së Kulturës; 231 fond i pa alokuar (sistemi elektronik i sigurisë së vendit të depozitimit në fond).
b. Shkresa me nr. 157.prot. datë 03.05.2017 ñKërkesë për alokim fondesh drejtuar Ministrisë së Kulturës;(artikulli 230 (projekti nga mbrojtja nga zjarri dhe sigurinë për dy godinat e BK), fond i pa alokuar.
c. Shkresa me nr. 180.prot. datë 30.05.2017 ñKërkesë për alokim fondesh drejtuar Ministrisë së Kulturës; artikulli 230 dhe 231 , për sigurinë e vendit të depozitimeve nuk është alokuar.
d. Shkresa me nr. 278.prot. datë 03.04.2018 ñKërkesë për alokim fondesh, drejtuar Ministrisë së Kulturës; nuk janë alokuar fonde shkresa të ripërsëritura për investime për sigurinë.
e. Shkresa me nr. 382/58.prot. datë 26.07.2018 ñKërkesë për alokim fondesh dhe për masa të tjera të nevojshme për realizimin e projektit ñPlani i masave paraprake për eliminimin e pasojave të përmbytjes në Bibliotekën Kombëtare, të Institutit të Ndërtimitò, drejtuar Ministrisë së Kulturës; fond i alokuar
f. Shkresa me nr. 349.prot. datë 13.06.2019 ñKërkesë për alokim fondesh në artikullin 230 të buxhetit për vitin 2019ò, drejtuar Ministrisë së Kulturës; artikulli 230 fond i pa alokuar për projektin mbrojtjen nga zjarri.
g. Shkresa me nr. 92.prot. datë 15.01.2020 ñKërkesë për alokim fondesh në artikullin 231 dhe 230 të buxhetit për vitin buxhetor 2020ò, drejtuar Ministrisë së Kulturës; fond i pa alokuar për projekte dhe pajisje mbrojtje nga zjarri fond i alokuar për rikonstruksionin artikulli 231 (P300) dhe artikulli 230 (projekte nuk është alokuar).
h. Shkresa me nr.92/1.prot. datë 13.02.2020 e ripërsëritur ñKërkesë për alokim fondesh në artikullin 230 (për projektin mbrojtje nga zjarri dhe lagështia nga tubat e shkarkimit) nga MK nuk është alokuar fondi.
i. Shkresa me nr. 442. prot. Datë: 17.06.2020 ñKërkesë për mbështetje financiare me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të krijimit të Bibliotekës Kombëtare, drejtuar Ministrisë së Kulturës fondi i alokuar në zërin 604;

Nevojat vjetore për fonde për investime (rikonstruksione, pajisje, projekte) etj. i ka paraqitur nëpërmjet kërkesave buxhetore (PBA-ve) drejtuar në MK , të pasqyruara në tabelat si më poshtë:

Tabela nr.22:*Planifikimi i buxhetit për investime (rikonstruksione, pajisje, projekte) për vitet2018 – 2020 (sipas PBA)*.

Në 000/lekë

Nr.	Emri i projektit	Kërkesat e PBA Viti 2018	Kërkesat e PBA Viti 2019	Kërkesat e PBA Viti 2020	Fonde të alokuara nga MK ne vitin 2018 (shtesa)me kërkesa gjatë vitit
1	Rikonstruksioni i sallës P300 në fond për eliminimin e pasojave të përmbytjes (punime elektrike, mekanike).				1,556
2	Rikonstruksioni i aneksit të BK Rikonstruksioni i ndërtesës qendrore të BK(salla P.300 e fondit),dhoma e serverëve.	4,000			0
3	Sistemi elektronik i alarmit kundër vjedhjeve në sallat e fondeve.	700			0
4	Blerje pajisje kompjuterike, elektronike, server për arkivin digjitale.	4,000	2,500	2,000	0
5	Përditësimi i programit Adlib (blerje dhe zhvillim i programit).	12,000			0
6	Pajisje, orendi zyrash ,sallash (karrige, rafte, tryeza pune)ekrane etj.	2,500	800	800	0
7	Skedar (metalik ose druri).	2,000	1,500	1,000	0
8	Grila plastike ndërtesa qendrore e BK.			3,375	0
9	Blerje pajisje vegla pune(elektromotor gur fleksibël,) etj.	100	150	100	0
10	Blerje pajisje laboratorike (aparat matës lagështire temperature).	200			0
11	Blerje libra.	800	800	800	0
12	Studim projektime.	400	200	200	0
	Totali	**26,700**	**5,950**	**8,375**	**0**

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.23:*Planifikimi i buxhetit për investime (rikonstruksione, pajisje, projekte) për vitet 2019 – 2021 (sipas PBA).*

Në 000/lekë

Nr.	**Emri i projektit**	**Kërkesat e PBA Viti 2019**	**Kërkesat e PBA Viti 2020**	**Kërkesat e PBA Viti 2021**	**Fonde te alokuara nga MK në vitin 2019 (shtesa)me kërkesë gjatë vitit.**
1	Rikonstruksioni i aneksit të BK, Rikonstruksioni në Biblioteka Qendrore (salla p.300 e fondit(rrjeti elektrik)dhe ambienti i serverëve etj.	2,660			0
2	Sistemi elektronik i alarmit kundër vjedhjeve (salla e fondeve).	700			0

3	Blerje pajisje kompjuterike, elektronike, server për arkivin digjital, skaner etj.	8,000	2,500	2,000	0
4	Përditësimi i programit Adlib (blerje dhe zhvillim i programit).	12,000			0
5	Pajisje, orendi zyrash ,sallash (karrige, rafte, tryeza, tavolina) rafte metalik librash ,ekran TV etj.	3,600	800	800	0
6	Skedar (metalik ose druri)	2,000	1,500	1,000	0
7	Grila plastike ndërtesa qendrore e BK.		3,375		0
8	Blerje pajisje vegla pune(fshesa korrenti, elektromotor gur fleksibël, trapan) etj.	1,000	200	200	0
9	Blerje pajisje tharëse, dezinfektuese për laboratorin (libërlidhja).	600	300	300	0
10	Blerje libra.	800	800	800	0
11	Studim projektime.	800	200	200	0
	Totali	**32,160**	**9675**	**5,300**	**0**

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.24:*Planifikimi i buxhetit për investime (rikonstruksione, pajisje, projekte) për vitet 2020 – 2022 (sipas PBA).* *Në 000/lekë*

Nr.	Emri i projektit	Kërkesat e PBA Viti 2020	Kërkesat e PBA Viti 2021	Kërkesat e PBA Viti 2022	Fonde të alokuara nga MK ne vitin 2020 (shtesa)me kërkesa gjatë vitit.
1	Rikonstruksioni i aneksit të BK Rikonstruksioni i ndërtesës qendrore të BKSH (rrjetit elektrik në sallën P300 në fond)dhe ambienti i serverëve .	3620			2400
2	Sistemi elektronik i alarmit kundër vjedhjeve (salla e fondeve).	700			0
3	Blerje pajisje kompjuterike, elektronike, server për arkivin digjital, skaner etj.	6500	2500	2000	0
4	Pajisje ,orendi zyrash ,sallash (karrige, rafte, tryeza, tavolina) rafte metalik librash ,ekran TV etj.	5000	800	800	0
5	Skedar (metalik ose druri).	2000	1500	1000	0
6	Grila plastike ndërtesa qendrore e BK.		3375		0
7	Blerje pajisje vegla pune(fshesa korrenti, elektromotor gur fleksibël, trapan) etj.	1000	200	200	0
8	Blerje pajisje tharëse, dezinfektuese për laboratorin (libërlidhja).	600	300	300	0
9	Blerje libra.	800	800	800	0
10	Studim projektime.	1200	200	200	0

	Totali	**21420**	**9675**	**5300**	**0**

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga fondet e kërkuara në PBA për vitet objekt auditimi:

Në vitin 2018 si pasojë e depërtimit të ujit në sallën P300 (katet e nëndheshme) të fondeve dhe për eliminimin e këtyre pasojave dhe marrjen e masave për mos përsëritjen në të ardhmen, me kërkesë të BK-së nga MK u alokua fondi me vlerë 1,556 mijë lekë me destinacion ñRikonstruksion (punime ndërtimi, punime elektrike, punime mekanike) të sallës P300 të fondeve (katet e nëndheshme) të Bibliotekës Kombëtare.

Në vitin 2020 është alokuar fondi me vlerë 2,400 mijë lekë me destinacion ñRikonstruksion i rrjetit elektrik në sallën P300 (katet e nëndheshme) të Bibliotekës Kombëtareò, rrjet elektrik i cili ishte i dëmtuar qysh nga rënia e zjarrit në muajin Mars 2017.

Të ardhurat e realizuara nga shërbimet ndaj individëve të ndryshëm (fotokopje materiale bibliotekare dhe përdorimi i tyre për shpenzime operative blerje kancelari) për vitet 2018,2019,2020 paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr.25: ***Në lekë***

Nr.	Viti	Realizimi i të ardhurave (total)	Pjesa që i takon institucionit	Përdorur	Derdhur në buxhet
1	2018	323,037	95,711	0	323,037
2	2019	8,4460	25,338	21,000	63,460
3	2020	41,750	12,525	10,000	31,750
	Totali	449,247	133,574	31,000	418,247

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Institucioni në relacionet shpjeguese të PBA-së 2018- 2020, 2019-2021, 2020-2022, ka parashtruar nevojën që botimet kërkojnë një ndarje të veçantë në buxhetin e institucionit.

Aneksi i Bibliotekës Kombëtare po ri konstruktohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës në bazë të kontratës publike të shërbimit në datën 03.12.2020 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ñXò SHPK, i përfaqësuar nga Sekretaria e Përgjithshme z. X dhe nga përfaqësuesi i operatorit nga Administratori z. X në shumën prej 44,636,849 lekë me TVSh me afat përfundimi deri në Dhjetor të 2022.

Pasurimi i koleksioneve bibliotekare për vitet 2018-2020.

BKSH ndonëse nuk ka pasur fonde për blerje librash, parashtruar edhe në kërkesat e PBA-së 2018-2020, 2019-2021, 2020-2022, ka bërë përpjekje institucionale për të mundësuar pasurimin e koleksioneve bibliotekare me libra në gjuhë të huaj në interes për përdoruesit nëpërmjet shkëmbimit bibliotekar me bibliotekat e huaja (20 libra) dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione kulturore e shkencore në Kosovë, si: Bibliotekën Kombëtare ñPjetër Bogdaniò të Kosovës, Institutit Albanologjik në Prishtinë, Institutit të Historisë ñAli

Hadriò në Prishtinë, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Universitetit të Prishtinës, etj. (50 libra), nënshkrimit të marrëveshjeve me Ambasadën Franceze në Tiranë (460 libra) dhe fondacionin Goethe-Zentrum (133 libra), si edhe dhuratave nga personalitete dhe individë të ndryshëm.

Në mungesë të fondeve në buxhetin e institucionit, Biblioteka Kombëtare, për të përmbushur detyrën funksionale si ent botues, për periudhën 2018-2020, ka zhvilluar një politikë të veçantë

për këtë qëllim, duke i dhënë përparësi botimeve të veprave me rëndësi për kulturën shqiptare e jo vetëm, që paraqesin interes, si për publikun shqiptar, ashtu edhe studiuesit e huaj. Për këtë qëllim ajo ka bërë të gjitha përpjekjet dhe ka mundur të gjejë fonde duke realizuar botime me mbështetjen financiare të Kuvendit të Shqipërisë, Fondacionit kulturor ñXò dhe Bibliotekës Kombëtare të Marrëveshjet Kosovës ñPjetër Bogdaniò.

Financimi nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondacionit kulturor ñXò është bërë mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara mes tyre e BKSH-së. Ndërsa me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës BKSH ka marrëveshje bashkëpunimi që datojnë nga viti 2006, të zhvilluara edhe në vitet në vijim. Për sa më sipër thuhet po paraqesim si më poshtë vijon botimet e bëra në institucion të financuara nga fondacione dhe nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe nga BK e Kosovës:

Tabela nr.26. *Tabela e botimeve të financuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga BK e Kosovës.*

Titulli	**Viti**	**FINANCIMI**
Diturija, V. 1: botim anastatik	2018	Fondacioni kulturor "X"
Diturija, V. 2 :botim anastatik	2018	Fondacioni kulturor "X"
Bibliografia retrospektive 1945-1958	2018	Fondacioni kulturor "X"
Lumo Skëndo dhe themelimi i rev. "Diturija"	2019	Fondacioni kulturor ñX"
Lumo Skëndo dhe themelimi i rev. "Diturija", konferenca, Tiranë	2019	Fondacioni kulturor "X"
Lumo Skëndo dhe themelimi i rev. "Diturija", konferenca, Prishtinë	2019	Fondacioni kulturor "X"
Gazeta "Lirija" : botim anastatik	2019	Fondacioni kulturor "X"
Anton Pashku : konferencë shkencore	2019	Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani" e Kosovës
Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë	2020	Kuvendi i Shqipërisë

Burimi i të dhënave: BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Marrëveshjet e bashkëpunimit për botimet të kryera në BK.

1) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 75. prot. i (BKSH), nr. 94. prot.(Fondacioni ñXò),
2) datë 23.01.2018 për botimin analitik të koleksionit të revistës kulturore ñDituria 1ò dhe ñDituria 2ò
3) me rastin e 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit;
4) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 430 i prot.(BKSH), nr. 390 i prot.(X) , datë 15.08.2018

5) për botimin e ñBibliografisë Retrospektive të Librit Shqip (1945-1958);
6) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 192.prot. (BKSH), nr. 98.prot.(Fondacioni ñXò),
7) datë 22.02.2019 për 3 botimet ñLumo Skëndos dhe themelimi i revistës ñDituriaò;
8) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 193.prot. (BKSH), nr. 99.prot . (Fondacioni ñXò),
9) datë 22.02.2019 për botimin anastatik të koleksionit të plotë të gazetës ñLirijaò;
10) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 442/1.prot . (BKSH), nr. 2195/2.prot. (Kuvendi i Shqipërisë),
11) datë 17.09.2020 për botimin ñ100 thesare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisëò.
Marrëdhëniet e bashkëpunimit të BKSH-së me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës janë të hershme dhe janë zhvilluar ndër vite.

Marrëveshjet e bashkëpunimit për pasurimin e koleksioneve bibliotekare.

1) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 149.prot. (BKSH me Ambasadën Franceze në Tiranë),
2) datë 07.02.2018;
3) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 399.prot. (BKSH me Goethe-Zentrum në Tiranë),
4) datë 12.07.2018;
1) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 291.prot. (BKSH me Ambasadën Franceze në Tiranë),
2) datë 25.04.2019;
3) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 595.prot. (BKSH me Ambasadën Franceze në Tiranë),
4) datë 09.10.2019;
5) Marrëveshja e bashkëpunimit me Institutin Albanologjik daton nga viti 2014 (04.06.2014).

Trajnimet e specialistëve në vitet 2018-2020.

Në mbështetje të ligjit nr. 8567, dt. 03.02.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar Biblioteka Kombëtare ñDrejton, organizon dhe kryen trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të bibliotekave të vendit ò.
Në këtë kuadër për të mundësuar kualifikimin e vijueshëm bibliotekar dhe promovimin e praktikave më të mira botërore, falë bashkëpunimit të BKSH-së me Ambasadën Franceze në Tiranë, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, janë organizuar trajnime/ëorkshop të punonjësve të sistemit kombëtar bibliotekar, përfshirë edhe specialistë të Bibliotekës Kombëtare, të drejtuara nga lektorë francezë, mbështetur nga Ambasada Franceze në Tiranë. Për përudhen 2018-2020 janë organizuar 2 ëorkshope:

1-Ëorkshop-i ñRuajtja dhe restaurimi i materialeve bibliotekareò (2-6 dhjetor 2019) me pjesëmarrjen e restauratorëve dhe libër lidhësve nga Biblioteka Kombëtare, bibliotekat publike e ato universitare, drejtuar nga përgjegjësi i Qendrës së Ruajtjes dhe Restaurimit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Strasburgut, i cili solli përvojën franceze të sistemit bibliotekar duke shoqëruar trajtesat teorike të ruajtjes dhe restaurimit të vlerave të rralla të trashëgimisë kombëtare edhe me demonstrime praktike;
2-Ëorkshop-i ñImpakti i teknologjive të reja në biblioteka dhe në leximò, (9-10 tetor 2019) me
pjesëmarrjen e bibliotekarëve nga Biblioteka Kombëtare, bibliotekat publike e ato universitare,

drejtuar nga drejtori i bibliotekës ñVaclav Havelò (Francë):Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Strasburgut, e cila solli jo vetëm përvojën franceze të sistemit bibliotekar, por edhe atë të vendeve evropiane, fokusuar në risitë e shërbimeve bibliotekare, rolin e bibliotekarëve në orientimin e përdoruesve në njohjen e mënyrave të reja të kërkimit,përfshirë edhe instrumentet e reja (elektronike) të leximit. Gjithashtu është punuar fort për nënshkrimin e një marrëveshjeje të BKSH-së me BKU-së të Strasburgut, e cila i hap rrugën trajnimeve të stafit, dhe finalizohet në korrik 2021.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u kostatua se fondet buxhetore nuk i janë akorduar BKSH-së, në bazë të kërkesave të PBA, drejtuar MK-së, për periudhën objekt auditimi. Fondet e akorduar kanë rezultuar në ulje nga viti 2018 e në vazhdim referuar akt rakordimeve të fondeve buxhetore të mbajtura në fund të vitit me përfaqësuesit e MK. Biblioteka Kombëtare për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2020, është financuar me fonde buxhetore nga Ministria e Kulturës e konkretisht për vitin 2018 në shumën prej 102,459 mijë lekë ose 4,4 % të totalit të fondeve të MK, për vitin 2019 në shumën prej 99,011 mijë lekë ose 4,3% të totalit të fondeve të MK, për vitin 2020 në shumën 99,894 mijë lekë ose 4% të totalit të fondeve të MK, fonde të cilat kanë pësuar ulje ndër vite dhe në mungesë totale të fondeve për investime të kërkuara në PBA-të e Bibliotekës Kombëtare.
Fondet për investime për Bibliotekën Kombëtare janë dhënë për vitin 2018 dhe për vitin 2020,vetëm për raste emergjente si rezultat i dy ngjarjeve të rënda të ndodhura, zjarri dhe përmbytja në sallën P300 në vitin 2017 dhe vitin 2018.
Vlen të theksohet fakti se me gjithë kërkesat e vazhdueshme të BK në domosdoshmërinë për ngritjen e një godine të re bashkëkohore për vitet 2018 e në vazhdim nuk rezulton të jenë përcaktuar fonde buxhetore konkrete nga MK, referuar dhe objektivit të Strategjisë së MK 2019-2025 për një projekt të ri godine me standarde bashkëkohore. Mungesa e fondeve buxhetore, veçanërisht të fondeve për investime ka sjellë mosfunksionimin e një pjese të hapësirave të shërbimit ndaj lexuesve, të cilat janë përdorur për mbajtjen e kutive me libra, jashtë cdo standardi të ruajtjes së tyre nga lagështira dhe zjarri.
Nga auditimi u konstatua se godina ku zhvillon aktivitetin institucioni rezulton pa status juridik të pronësisë.
Mos lëvrimi i fondeve për blerje librash për albano- Balkanologjinë në BK ka ndikuar negativisht në pasurimin dhe arkivimin e botimeve nga të huajt për Shqipërinë duke mos realizuar dhe objektivat e institucionit bazuar në nenin 17 të ligjit 8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.

1. Konkluzion:

BKSH veprimtarinë e ka zhvilluar në dy godina të cilat ekzistojnë pa status juridik të pronësisë dhe në mungesë totale të fondeve për investime në drejtim të ndërtimit të një godine të re. Situata aktuale tregon për trajtimin nga MK e institucionit unik për Shqipërinë të BK-së, jo me vëmendje dhe me një qasje të veçantë por e lënë në harresë referuar situatës të rënduar të ambienteve të ndërtesës shumë të amortizuar pa hapësira të depozitimit të arkivit të koleksioneve dhe pa standarde depozitimi dhe sigurie, gjë që evidentohet nga mos financimi ndër vite për një ndërtesë të re me standarde bashkëkohore referuar së fundmi shkresës me nr.618.prot. datë 25.11.2019 me objekt ñ Kriza e hapësirësò, drejtuar Ministres së Kulturës, nga Titullari aktual i BK.
Mungesa e fondeve për botime dhe blerje librash ka ndikuar dhe në politikat e ndjekura nga institucioni duke mos pasuruar me koleksione të tjera, arkivin e BK-së.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa në rritjen e fondeve të alokuara për investime për BKSH-në, për përmirësimin e ambienteve ekzistuese të Bibliotekës Kombëtare dhe shtimin e tyre brenda Pallatit të Kulturës.

Brenda vitit 2022

1.2. Rekomandimi: Ministria e Kulturës për realizimin e objektivave të BK duhet të përcaktojë dhe të lëvrojë fonde për blerje librash për Albano-Balkanologjinë të botuar jashtë Shqipërisë të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore.

Brenda vitit 2022

4.2. A është kryer digjitalizimi i plotë i shërbimit bibliotekar,përperiudhënnëauditim?

1.Biblioteka Kombëtare është biblioteka qendrore e Republikës së Shqipërisë; institucioni kryesor i rrjetit kombëtar të bibliotekave; qendra e arkivit të botimeve shqip, e depozitimit të dorëshkrimeve dhe të antikuarit, e veprave të albanologjisë dhe të ballkanologjisë, materialeve të tjera bibliotekare (përfshirë edhe botimet elektronike); qendra më e rëndësishme e vendit për grumbullimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e botimeve të huaja; institucioni kryesor bibliografik në shkallë kombëtare;qendër metodike-shkencore në fushën e bibliotekonomisë dhe përgatitjes profesionale për të gjithë rrjetin bibliotekar të vendit.

2.BKSH është institucion qendror kulturor, informues e shkencor dhe u shërben përdoruesve nëpërmjet koleksioneve të veta, mjeteve elektronike të informimit dhe veprimtarive të tjera të organizuara prej saj apo në bashkëpunim me institucione dhe organizma të tjerë.

BKSH funksionon sipas bazës ligjore të poshtëshënuar:

- Ligjit nr. 8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar,
- Ligjit nr. 9217, datë 8.4.2004 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò;
- Ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 ñPër trashëgiminë kulturore dhe muzetëò.
- Ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò.
- Ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 ñPër bazat e të dhënave shtetëroreò.
- Ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- Rregullores së Brendshme të miratuar nga Drejtori i Institucionit me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò.
- Urdhrit të Kryeministrit nr. 139, datë 28.03.2014 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò.
- Urdhrit nr. 122, datë 17.09.2019, ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BK.
- VKM nr. 945, datë 2.11.2012 Për miratimin e rregullores ñAdministrimi i sistemit të bazave së të dhënave shtetëroreò.
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò të ndryshuar.
- VKM nr. 134, datë 7.3.2018 ñPër krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar DATA BKSH.

Ajo zhvillon veprimtarinë e saj profesionale në përputhje me dokumentet organizatave ndërkombëtare në fushën e bibliotekave dhe të informacionit, ku ajo aderon si IFLA, CENL, LIBER, UNESCO etj., direktivat e BE-së, rekomandimet e Komisionit Evropian, të cilët ndër objektivat kryesorë në strategjitë e tyre vitet e fundit ***kanë digjitimin e trashëgimisë***

kulturore evropiane dhe qasjen sa më të madhe në të , për të cilën është duke u punuar në vijimësi në BKSH.
Bibliotekë digjitale synon të sigurojë qasje digjitale në formë të strukturuar dhe autoritare në mënyrë që të integrojë teknologjinë e informacionit, arsimin dhe kulturën në bibliotekat bashkëkohore.

BK është Qendër e mirëmbajtjes dhe administrimit të Bibliotekës Digjitale, administrimit dhe mirëmbajtjes të faqes zyrtare të BKSH-sëhttp://www.bksh.al/ dhe faqes zyrtare në facebook https://www.facebook.com/bksh.al, Qendër bibliotekare e digjitimit të trashëgimisë së shkruar. Kjo qendër realizon procesin e skanimit të materialeve bibliotekare (libër, dorëshkrim, hartë, periodik etj.); kryen përpunimin e imazheve të skanuara, si dhe mundëson ruajtjen e njësive bibliotekare sipas standardeve ndërkombëtare të bibliotekonomisë (shkencës së bibliotekave) duke krijuar bibliotekën digjitale.

4.2.1.A ka qenë efektiv procesi i digjitalizimit të të dhënave të Fondit të materialeve bibliotekare?
Për tëu përgjigjur këtyre dy pyetjeve, shtjellimi i pyetjeve do të bëhet i integruar për të dyja pyetjet paralelisht pasi i tillë është procesi i digjitalizimit në BKSH, trajtimi i të cilit është *"zinxhir"* i funksioneve të alternuara ndërmjet disa sektorëve, analiza e të cilëve do të jepet hollësisht në vijim.
Nga auditimi i strukturës organizative në funksion të objektivave të institucionit për periudhën në auditim u konstatua se: struktura dhe organika e BK-së, është hartuar dhe zbatuar sipas kërkesave të Ligjit nr. Nr.8576, datë 3.2.2000 ñPër Bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të miratuar nga ish-Drejtori i Institucionit, z. X, me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò, si dhe ndryshimet e saj, përkatësisht me urdhër nr. 139, datë 28.03.2014 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò dhe Urdhri nr. 122, datë 17.09.2019, ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò.
Në lidhje me sektorët që kanë funksionin kryesor në digjitalizimin e të dhënave dhe shërbimeve on-line në BK dhe ndërlidhja e tyre në këtë proces, të paraqitur në organigramë jepen në skemën e mëposhtme:

Skema nr.2.



Sektori i IT në BK

(paraqitja online e materialeve pasi janë verifikuar dhe dorëzuar nga sektorët e mësipërm)

Japim një përshkrim të shkurtër të secilit prej sektorëve të mësipërm për të kuptuar më pas rolin
dhe funksionin e tyre në procesin e digjitalizimit në BKSH.
Sektori i Bibliografisë kombëtare është një nga sektorët më të rëndësishëm në veprimtarinë e BK-së. Përbërja e këtij sektori për periudhën në auditim është:

Tabela nr.27:Struktura e sektorit të Bibliografisë sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.139, datë 28.03.2014 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò, për periudhën në auditim:

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 01.01.2018	Nr. Punonjësish(fakt) 31.07.2018
1	Përgjegjës sektori	1	1	1
2	Bibliografë	5	5	5
3	Bibliotekarë	**1**	**1**	**1**
4	Ndihmës bibliotekarë	**1**	**1**	**1**
Total		**8**	**8**	**8**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Sikurse është cituar më sipër me Urdhrin e Kryeministrit nr. 108, datë 31.07.2018, ñPër disa ndryshime në urdhrin e Kryeministrit, nr.122, datë 17.09.2019 ò Për miratimin e strukturës dhe të organikës së BKò, Qendra e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar (QTDSH) kalon në varësi të sektorit të Bibliografisë dhe struktura në vijim është:

***Tabela nr.28*:** Struktura e sektorit të Bibliografisë sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 108, datë 31.07.2018, ñPër disa ndryshime në urdhrin e Kryeministrit, nr.139, datë 28.03.2014ò, si dhe Urdhrit nr. 122, datë 17.09.2019, ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò, për periudhën në auditim:

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 31.07.2018	Nr. Punonjësish(fakt) 31.05.2021
1	Përgjegjës sektori	1	1	1
2	Bibliotekarë	5	5	5
3	Bibliotekarë të QTDSH-së	**2**	**2**	**2**
4	Ndihmës bibliotekarë të QTDSH-së	**2**	**2**	**2**

Total	**10**	**10**	**10**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

1-Misioni i Sektorit të Bibliografisë është: Përgatitja e informacionit bibliografik për materialet shqip që botohen në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, të cilat hyjnë në fondet e BKSH-së.
2- Harton dhe boton:

- ✓ Bibliografinë Kombëtare të Librit që botohet në Republikën e Shqipërisë.
- ✓ Bibliografinë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë - Artikujt e Periodikut Shqip
- ✓ Bibliografinë Kombëtare Retrospektive të Shtypit Shqiptar (1848-1960)
- ✓ Bibliografinë e Librit Shqip që botohet jashtë Republikës Shqipërisë
- ✓ Bibliografinë e përkthimeve për "Index Translationum"
- ✓ Bibliografi tematike, rekomanduese, lista bibliografike

4.2.2.A ka qenë efektiveQendra e Digjitimittë Trashëgimisë sëShkruar përperiudhën2018-2020?

Sikurse e kemi cituar, Qendra Bibliotekare e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar është pjesë integrale e sektorit të Bibliografisë ***me rëndësi të veçantë në procesin e digjitalizimit në BK.***
Misioni i Qendrës Bibliotekare të Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar, është ofrimi i digjitimit të materialeve të mediave dhe formateve të ndryshme, duke garantuar njëkohësisht aftësinë për të ndërhyrë përmes mjeteve të posaçme dhe soft eve për përshtatje apo korrigjim të ndonjë defekti në material duke mundësuar riprodhim sa më afër origjinalit.

Digjitimi përfshin:

1. Përgatitjen e listave të njësive/koleksioneve për digjitim.
2. Përzgjedhja (Kontrolli fizik i tyre dhe përgatitja e koleksionit të plotë (periodiku) dhe plotësimi i mungesave, kur është e mundur)
3. Skanimi dhe kontrolli i skanimit (Skanon njësitë bibliotekare në kushtet e një ndriçimi të ftohtë, konkretisht dritë neoni që siguron ruajtjen dhe integritetin e origjinalit. Skanimi kryhet sipas proceseve të përcaktuara teknike të formatimit faqe për faqe duke përshtatur përmasat e njësisë me ato të skanerit, të realizmit të ndarjes së faqeve të skanuara majtas dhe djathtas, të krahasimit të njësisë me origjinalin.
4. Përpunimi i njësive/koleksioneve të digjituar (kryen proceset teknike të përpunimit të faqeve, si: të prerjes, kontrastit sipas ngjyrës së materialit, numërtimit të faqeve etj.)
5. Kodimin e tekstit (OCR)
6. Kontrolli përfundimtar dhe organizimi në Arkivin Digjitale
7. Pajisja me meta datë e koleksionit/njësisë së digjituar
8. Publikimi i koleksioneve të digjituara. Njësia e digjituar bëhet e qasshme për përdoruesit si pjesë e koleksionit të Bibliotekës Digjitale, e ofruar në faqen zyrtare të BK dhe/ose portale kombëtare dhe ndërkombëtare.

Organizimi i koleksioneve në Bibliotekën Digjitale Online
Ky proces përfshin: hedhjen, organizimin dhe shfaqjen e koleksioneve/njësive të digjituara në programin e Bibliotekës Digjitale **dhe kryhet në bashkëpunim me sektorin e Bibliografisë kombëtare, sektorin Albano-Balkanologjisë dhe sektorin e IT-së.**

Hapat:

- Hedhja e koleksioneve/njësive në programin e Bibliotekës Digjitale
- Pajisja me meta data e koleksioneve/njësive të shtuara
- Pajisja me funksionet e *SHFLETIMIT dhe KËRKIMIT* sipas fushave të përcaktuara koleksionet/njësitë e shtuara
- Rindërtimi i koleksionit të plotë (koleksionet/njësitë ekzistuese dhe koleksionet/njësitë e reja)
- Shfaqja e koleksionit të plotë online
- Kontroll i koleksionit të shfaqur online nga sektorët përkatës (Bibliografia, Albanologjia)
- Njoftimi mbi titujt e rinj të shtuar në Bibliotekën Digjitale në faqen zyrtare të BKSH.

Rekomandimet e Komisionit Evropian në strategjitë e tyre vitet e fundit kanë për objektiv kryesorë digjitimin e trashëgimisë kulturore evropiane dhe qasjen më të madhe në të, për të cilën është duke u punuar në BKSH me intensitet për periudhën koherente.

Në Bibliotekën Kombëtare, *fondi i arkivit të botimeve shqip, i antikuarëve, i dorëshkrimeve, hartave, si dhe fondi albano-balkanologjik përbëjnë pasuri me vlera të mëdha për thesarin e kulturës kombëtare shqiptare e për rrjedhim të kulturës evropiane.*

Në vitin 1994, në Bibliotekën Kombëtare filloi katalogimi në një sistem të automatizuar, përmes përpunimit dhe regjistrimit elektronik të gjithë fondit të saj arkivor. Shfrytëzimi i kërkimit elektronik, përmes Katalogut elektronik (OPAC), ka lehtësuar rrënjësisht aksesin në informacion. Prej 10 vitesh, Biblioteka Kombëtare, përmes faqes së saj zyrtare (ëëë.bksh.al), ofron një sërë shërbimesh të rëndësishme online si: Katalogët online, Katalogët e Digjituar, Biblioteka Dixhitale, e-Bibliografi etj., duke pasur vit pas viti rritje shumë të shpejtë të frekuentuesve të saj.

Shumë lehtë i aksesueshëm për përdoruesin është edhe fondi elektronik i disa prej bibliografive më të rëndësishme të BKSH-së përmes shërbimit online: ñe-Bibliografiò.

Në epokën digjitale, në Bibliotekë më mirë se kudo, publiku mund të marrë një informacion të shpejtë, të detajuar dhe mbi të gjitha të sigurt, si për tõi kujtuar njerëzve se sa gjëra fantastike gjenden në Bibliotekë, duke iu dhënë atyre një arsye të fuqishme për ta vizituar dhe frekuentuar atë.

-Biblioteka Kombëtare Shqiptare, si institucioni kryesor i bibliotekave në Republikën e Shqipërisë, e cila luan dhe rolin e një biblioteke publike për qytetin e Tiranës, përveç të tjerash, ka si detyrë kryesore: shërbimin direkt ndaj përdoruesve nëpërmjet koleksioneve të veta(libra, dorëshkrime, periodikë, harta, etj.), informimit të tyre me mjete elektronike, organizimit të veprimtarive të ndryshme informuese në bashkëpunim dhe me institucione e organizma të tjera, si: ekspozita, promovime, konferenca shkencore, etj., për përmbushjen e rolit parësor të saj: *plotësimin e nevojave bibliotekare dhe informuese të komunitetit të cilit i shërben.*

Në vitin jubilar të kremtimit të 100-vjetorit të krijimit të BKSH-së, falë realizimit të projektit, përmes sistemit të ri bibliotekar,prej muajit qershor të vitit 2020, për përdoruesit e grup moshave të ndryshme ofrohet një faqe e re me dizajn të ri konceptuar, një format modern dhe lehtësisht i përdorshëm, rubrika të reja, fusha dhe funksionalitete të shtuara,shumëllojshmëri elementësh kërkimi e shfletimi të bibliotekës digjitale (imazh. libër, galeri), tanimë të ofruara edhe nëpërmjet rrjetit mobile. Mbi 265 mijë faqe librash, revistash, dorëshkrimesh, antikuarësh, hartash vijnë për lexuesit/përdoruesit, studiuesit shqiptarë e të huaj, studentët e pedagogët, si materiale të digjituara të shfletueshme duke përbërë një vlerë të shtuar edhe për punën kërkimore - shkencore.

Treguesit në lidhje me përdorimin on-line të materialeve të ndryshme bibliotekare paraqitet në tabelën nr.3, në vijim dhe grafikun përkatës:

***Tabela nr.29**:Treguesit në lidhje me përdorimin on-line të materialeve të ndryshme bibliotekare*

VITI	Përdorues online të faqes së BKSH-së	Vizita online në faqen BKSH-së	Përdorimi i rubrikave të faqes online
2018	65.181	173.913	251.905
2019	60.925	173.124	254.649
2020	62.057	259.314	434.979

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Grafiku nr:3



Pra ka një rritje të konsiderueshme të vizitave on-line në faqen e ëeb-it të BKSH-së, si dhe në shfletimin e materialeve bibliotekare të digjituara tashmë, me rëndësi të veçantë kulturore.

Qendra Bibliotekare e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar, në bazë të Rregullores së Sektorit në nenin 15, si pjesë përbërëse e Sektorit të Bibliografisë Kombëtare, ofron:

- digjitimin e materialeve të mediave dhe formateve të ndryshme,
- realizon procesin e skanimit të materialeve bibliotekare (libër, dorëshkrim, hartë, periodik etj.,); kryen përpunimin e imazheve të skanuara,
- si dhe mundëson ruajtjen e njësive bibliotekare sipas standardeve ndërkombëtare të bibliotekonomisë (shkencës së bibliotekave) duke krijuar arkivën kombëtare digjitale.

Gjithashtu BKSH është partnere në portale evropiane dhe botërore për të mundësuar qasje në trashëgiminë kulturore kombëtare.

***Në informacionin e marrë** nëpërmjet pyetësorit nr.7, me nr.prot.380, datë .06.05.2021 drejtuar sektorit të Bibliografisë në BKSH, dhe intervistave të kryera në mënyrë periodike me personat përgjegjës, rezultoi se:*

Në përgjigje të pyetjes : **A ka qenë efektiv procesi i digjitalizimit të të dhënave të Fondit të materialeve bibliotekare?**
Përgjigja e p/sektorit është : Në respekt ***të protokolleve të procesit të Digjitimit të materialeve të Fondit, përkatësisht Protokollit të datës 21.06.2016 dhe 23.06.2016,*** është arritur përzgjedhja, kontrolli, skanimi, përpunimi, kontrolli pas procesit të përpunimit, përshkrimi bibliografik (hartimi i meta datave) dhe më pas shfaqja në ëeb e antikuarëve, dorëshkrimeve, librave, hartave, periodikëve.
1. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se sektori i bibliografisë kombëtare në BK vazhdon të punojë me një protokoll formal, konkretisht të datave 21.06.2016 dhe 23.06.2016, të cilat në përmbajtjen e tyre kanë të përshkruar në mënyrë mekanike detyrat funksionale që duhet të kryejë ky sektor. Nuk ka plane specifikë mujore e vjetorë të punës për periudhën në auditim se si do të kryhet përzgjedhja e materialeve për digjitim, kriteret që janë përdorur për përzgjedhjen e materialeve bibliotekare për digjitim, përparësitë dhe normat mujore të digjitimit të koleksioneve të Bibliotekës Kombëtare, për të matur efektivitetin e këtij procesi me rëndësi primare si nga funksionet drejtuese ashtu edhe për ne si auditues të jashtëm. Planet janë në formë e-maileve, apo dokumentesh të pa miratuara dhe të pa firmosura nga Drejtori i Institucionit, si dhe të pa protokolluara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, e cila ka hartuar ñNormat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò.
1. Konkluzion: Mungesa e planeve operacionale me detyra, afate të mirë përcaktuara, norma mujore të digjitimi për secilin punonjës përgjegjës, në Sektorin e Bibliografisë si dhe mungesa e listave vjetore të materialeve bibliotekare, të planifikuara për digjitim e të pa miratuara nga Drejtori i Institucionit, ka sjellë përdorim të burimeve njerëzore pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.
1.1. Rekomandimi: Sektori i Bibliografisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të marrë masa për hartimin e planeve operacionale vjetore dhe periodike të mirë organizuar, me afate dhe lista përkatëse për digjitim të cilat të marrin miratim nga drejtori i BK-së, me qëllim matjen e efektivitetit të këtij procesi në BK.

Janar 2022 e në vijimësi

Nisur nga të dhënat e marra në formë shkresore dhe elektronike nga sektori i Bibliografisë Kombëtare, materialet bibliotekare për digjitim në mënyrë tabelore dhe grafike jepen në vijim:

Tabela nr.30: *Materiale bibliotekare për t'u digjituar dhe të digjituar deri në vitin 2020.*

Lloji i materialeve	Për t'u digjituar	Të digjituar	Mbeten për tu digjituar	% e digjitimit
Antikuarë	2491	176	2315	7%
Dorëshkrime	1199	234	965	20%
Harta	1032	79	953	8%
Libri Shqip	4391	444	3947	10%
Periodiku Shqip	450	156	294	35%

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Grafiku nr.4: Materialet e digjituara dhe për digjitim



Për sa konstatohet nga tabela, kemi një përqindje shumë të ulët të digjitimit të antikuarëve, hartave dhe librit shqip, përkatësisht 7, 8 dhe 10%, për periudhën në auditim.
Në lidhje me librin shqip, përqindja e ulët e digjitimit rrjedh si pasojë e zbatimit të Ligjit Nr. 35/2016 ñPër të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me toò, neni 41, ku citohet se:
Afatet e mbrojtjes së të drejtave pasurore *1. Të drejtat pasurore, të parashikuara nga ky ligj, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky nen, mbrohen gjatë gjithë jetës së autorit dhe deri në* ***70 vjet pas vdekjes së tij,*** *pavarësisht nga data kur vepra është bërë publike në mënyrë të ligjshme. Pas vdekjes së autorit, të drejtat pasurore do të transferohen nëpërmjet trashëgimisë, sipas legjislacionit civil.*
Në lidhje me antikuarët dhe hartat të cilat janë dokumente më vlerë të rrallë historike në trashëgiminë e pasurisë kulturore, pasi i përkasin periudhës **para vitit 1856,** numri i digjitimit të të cilëve gjithashtu është shumë i ulët, skanohen nga Qendra e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar dhe përzgjedhja e tyre, hartimi i listave, kontrolli para dhe pas skanimit, kryhet nga
Sektori i Albanolo-Ballkanologjisë(SAB).
Bashkëpunimi i këtij sektori me sektorin e bibliografisë /QTDSH, kryhet nëpërmjet e-maileve.
Edhe për këtë sektor konstatohet mungesa e planeve operacionale vjetorë si dhe planeve mujorë të pa miratuara nga Titullari i Institucionit dhe të pa konsultuara në Këshillin Administrativ i cili përbëhet nga përgjegjësit e sektorëve dhe shqyrton të gjitha çështjet e rëndësishme në rrafsh institucional sipas nenit 7 të Rregullores të brendshme të miratuar nga Drejtori i Institucionit me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò.
E dhënë në shifra dhe e ndarë përkatësisht në vite për periudhën në auditim, QTDSH ka kryer digjitimin përkatësisht, si më poshtë:

<u>Viti 2018</u>
1. 176 antikuarë (Portali i Skënderbeut)
2. 22 libra (tituj)
3. 17 periodikë (tituj, kanë periodicitet, vite, vëllime, muaj e data të ndryshme)
4. 50 bibliografitë e librit shqip (vitet, të ndara sipas tremujorëve, 4 pjesë çdo vit)
5. 90 bibliografi të periodikut shqip (vitet të ndara sipas muajve, 13 pjesë bashkë me shtojcën vjetore)
6. Botimi anastatik revista ñDituriaò

Viti 2019

1. 150 dorëshkrime
2. 3665 skeda të skedarit topografik të antikuarëve dhe dorëshkrimeve
3. 75 libra
4. 6 periodikë
5. Fletorja Zyrtare, 1922-1944 (22 vite)
6. Botimi anastatik gazeta ñLiriaò

Viti 2020

1. 347 (tituj) libra
2. 133 (tituj) periodikë

Gjatë pandemisë është kryer përpunimi, kontrolli, ndarja dhe organizimi i gjithë njësive të digjituar në Bibliotekën Digjitale.

Pra sikurse konstatohet, antikuarë janë digjituar vetëm në vitin 2018, dhe për periudhën 2019-2020 e në vazhdim nuk janë kryer digjitime të antikuarëve.
E njëjta situatë paraqitet edhe në dorëshkrime ku ka digjitime vetëm gjatë vitit 2019.
Në intervistat e kryera periodikisht me përgjegjësit e sektorëve të sipërcituar, nuk ka argumente dhe shkresa ku të justifikohet arsyeja e digjitimit në vlera të ulëta të dokumenteve me rëndësi të madhe historike, që në vlerësimin tonë duhet të kishin përparësi pasi vjetërsia që këto materiale kanë paraqet rrezikshmëri në ruajtjen e qartësisë së dokumentit.
Nga këta sektorë listat për digjitim dhe atyre të cilave do tâu jepet përparësi janë përcaktuar në *"mbledhje spontane",* dhe jo në fillim të vitit duke sjellë një mos organizim të punës në tërësi si rezultat edhe i mungesës së planeve strategjikë të BKSH-së dhe planeve operacionale vjetorë, të trajtuar nga grupi i auditimit edhe më sipër.
Konkretisht:
Në 2018-ën i është kushtuar rëndësi portalit të Gjergj Kastriot Skënderbeut, për shkak të 550 vjetorit të vdekjes së tij dhe janë digjituar antikuarë që i përkasin figurës së tij. Janë digjituar antikuarë dhe dorëshkrime që kanë tematikë, ose flasin mbi figurën e Skënderbeut dhe historisë së tij. ***Miratimi i këtyre listave është detyrë funksionale e sektorit të Albano-Balkanologjisë.***
Sektori i Bibliografisë për vitin 2018 është angazhuar për botimin anastatik të revistës ñDituriaò dhe për vitin 2019, u realizua botimi anastatik i revistës ñLiriaò.
Hartat albanologjike kanë qenë prioritet i Sektorit të Albano-balkanologjisë, nga ku rezulton që për periudhën në auditim 2018-2019-2020, të mos jetë digjituar asnjë e tillë.
Në 2020-ën, këta sektorë kanë vijuar me punën e kryer për aktivitetin në kuadër të 100-vjetorit të BKSH-së, në Kryeministri dhe materialet që duhet të ekspozoheshin për këtë arsye.
Të gjitha këto veprime shoqërohen me e-maile, pa një plan të detajuar dhe të paargumentuara në mënyrë shkresore sipas normave Tekniko Profesionale për Arkivat, neni 13. Paralelisht janë hartuar lista librash dhe revistash për t`u skanuar.
Nisur nga të dhënat e ardhura nga ky sektor, rezulton që janë digjituar (theksojmë progresivisht, pra jo vetëm për periudhën në auditim) si më poshtë:
Në formë tabelore:

Tabela nr.31*: Përqindja e digjitimit*

Koleksionet bibliotekare	**Digjituar %**
Antikuarë	7 %
Dorëshkrime	19, 5 %

Harta	7,6 %
Libri shqip	10,1 %
Periodiku shqip	34, 6 %
Bibliografia e librit shqip (1555-2003)	100 %
Bibliografia e periodikut shqip (1912-2004)	100 %

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Bibliografi e Librit Shqip (vitet 1555-2003) dhe Periodikut Shqip (vitet 1912-2004).
Pikërisht këto elementë të sipërcituar kanë sjellë në ñmos matjenò e punës dhe detyrave funksionale të kryera nga specialistët e sektorëve përkatës, nga ana e përgjegjësve të këtyre sektorëve, si dhe mos përcaktimin nga ana jonë si auditues të jashtëm që a janë ñshfrytëzuarò si duhet burimet njerëzore dhe a ka pasur ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet puna e kryer nga secili sektor në digjitalizimin e të dhënave dhe shërbimeve bibliotekare.

Observacioni i subjektit(*në formë të përmbledhur*)*: BKSH*, me shkresën prot. nr. 185/15, datë 24.09.2021, shkresës me nr. 185/6, datë 20.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 203/6, datë 24.09.2021, sugjeroni se protokollet e digjitimit janë afatgjata dhe viti 2016 nuk është i hershëm, nuk bëhen çdo vit protokolle të reja sepse proceset janë të njëjta.
Gjithashtu ndër të tjera ..... shpreheni se:
Bumi entuziast i përshkruar në fq 93, mbi vizituesit dhe përdoruesit on line të faqes së bksh.al, si dhe qershori i 2020-ës me mbi 265 mijë faqe librash (të numëruara nga sektori i bibliografisë në datë 09 prill 2020), nuk do të ishte një vlerë e shtuar edhe për punën kërkimore shkencore, pa mirëorganizimin dhe angazhimin e sektorëve të Bibliografisë dhe Albano-balkanologjisë.
....Titullari në mënyrë periodika ka realizuar takime me 3 drejtuesit (sektorët përkatës....) dhe me stafin e QTDSH, ku janë rrahur mendimet në kushtet kur kemi vetëm 2 skanerëdhe 2 përpunues, që të kemi më shumë efektivitet. Në fund të çdo takimi përcaktoheshin kriteret të cilat janë përcjellë me e-mail.....etj...
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Shënim: Edhe pse observacionet nuk janë vendosur totalisht në raport, theksojmë që ato janë lexuar dhe trajtuar tërësisht nga grupi i auditimit.
-Observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë, reflektuar edhe më sipër në mesazhin e auditimit, duke zëvendësuar fjalën ñdobëtò me pjesërisht efektiv dhe duke ri theksuar faktin që procesi i digjitimit në BKSH ***ka qenë pjesërisht efektiv*** dhe kjo si rezultat i arsyeve të cituara e të konsultuara nga ana jonë me stafin punonjës dhe struturat drejtuese vazhdimisht gjatë periudhës së auditimit në terren, për të cilat paraprakisht ka pasur dakordësi nga ana e të tre sektorëve por edhe e Drejtorit dhe zv/Drejtorit të BKSH-së.
Konkretisht në vijim ri paraqesim argumentet:
1-Për pyetjen: 4.2. A është kryer digjitalizimi i plotë i shërbimit bibliotekar,përperiudhënnëauditim? Dhe nën pyetjet përkatëse:
4.2.1. A ka qenë efektiv procesi i digjitalizimit të të dhënave të Fondit të materialeve bibliotekare?
4.2.2.A ka qenë efektiveQendra e Digjitimittë Trashëgimisë sëShkruar përperiudhën2018-2020?
-Në lidhje me protokollin e vitit 2016 që ju citoni në observacionin tuaj , trajtuar nga ne si në raport por edhe në intervistat e vazhdueshme, ***nuk merret në konsideratë***, pasi parimisht ai protokoll është thjesht një ñletërò, ku përcakton në përgjithësi detyrat funksionale që sektori i bibliografisë ka, pra është një udhëzues manual për mënyrën se si funksionon dhe punon ky

sektor, por ai nuk mund të zëvendësojë në asnjë mënyrë atë që ne kemi theksuar: Mungesën e planeve vjetorë operacionalë nga sektorët përkatës, planifikimi konkret i listave për digjitim vjetore dhe mujore dhe rrjedhimisht si mungesë e këtyre mos matje e punës dhe efektivitetit si dhe mungesë monitorimi nga përgjegjësit e sektorëve.
Në asnjë moment nga ana juaj nuk u vu në dispozicion (pasi nuk i kishit) lista planifikimi për digjitim, norma tëmatshme pune, analiza mujore e vjetore mbi punën e kryer apo problematikat që ju pengonin në moskryerjen me efektivitet të punës.
Si mund të vlerësojmë ne si auditues të jashtëm një proces pune kur mungon gjurma e auditimit, kur mungon planifikimi për të cilin më pas do të kërkohesh feed back?!
Puna nuk mund të vlerësohet nga emaile ditore ku ju përshkruani një proces monoton pa kryer një përmbledhje mujore e cila dokumentohet dhe i dorëzohet Titullarit apo zv /titullarit.
Rrjedhimisht procesi i digjitimit për ne konsiderohet ñi pa matshëmò.
Edhe pse BKSH funksionon sipas standardeve të Bibliotekave të tjera në botë, përsëri ai është një institucion i shtetit shqiptar dhe rrjedhimisht duhet të gjejnë veprim dhe zbatim të gjitha ligjet e këtij shteti dhe konkretisht Ligji për MFK-në me nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ñ, nuk gjen zbatim tek ju.
E rëndësishme është të ketë një lidhje midis planeve vjetorë të njësive organizative dhe planit strategjik të njësisë publike.Mungesa në rastin konkret të këtyre planeve dhe realizimit të tyre ka sjellë menaxhim të burimeve njerëzore dhe financiare pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.
Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ñ, nenin 16, pika 2, si dhe nenin 23, ku citohet se:
Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit.
2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
Neni 23 Informacioni dhe komunikimi. *Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë:*
1. Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, ***brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.***
2. Një komunikim efektiv, ***si vertikal, ashtu edhe horizontal,*** *në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.*
3. Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
4. Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet ***gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.***

Auditimi i performancës ka për qëllim të evidentojë realitetin dhe mangësitë që një institucion ka për përmirësimin e punës dhe politikave në tërësi.

3- Observacioni juaj në lidhje me ñSektorin e Restaurimitò merret parasysh, por kjo në kuadër të rekomandimit të bërë nga ana jonë, pasi si problematikë ajo është trajtuar nga grupi i auditimit në fq. 38 të PRA.
Gjithashtu sqarojmë se programi i auditimit të KLSH-së në lidhje me auditimin e performancës si dhe risqet apo drejtimet që ne trajtojmë janë puna jonë e vazhdueshme të cilat përcaktohen dhe miratohen nga Kryetari i KLSH-së.

***SEKTORI I ALBANO – BALKANOLOGJISË**

Misioni i këtij sektori është pasurimi i koleksioneve albano-balkanologjike (më tej Al-Ba)/Antikuarit/ Dorëshkrimeve/Hartave.
Struktura e sektorit të **Albano-Balkanologjisë,** sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.139, datë 28.03.2014 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò, për periudhën në auditim, paraqitet në vijim :

Tabela nr.32: *Organika e sektorit albano-balkanologjik.*

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 01.01.2018	Nr. Punonjësish(fakt) 17.09.2019
1	Përgjegjës sektori	1	1	1
2	Klasifikatorë	1	1	1
3	Bibliografë	**2**	**2**	**2**
4	ndihmës bibliotekarë	**1**	**1**	**1**
Totali		**5**	**5**	**5**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Struktura e fundit e ndryshuar sipas Urdhrit nr. 122, datë 17.09.2019, ka reduktuar numrin total të punonjësve të BKSH-së, në 92, dhe konkretisht ndryshimet kanë qenë në :
Sektori i Katalogimit Retrospektiv Elektronik, me ardhjen e organigramës së re të 2019-ës, u shkri, duke u bërë pjesë e Sektorit të Albano-Balkanologjisë. Konkretisht struktura e këtij sektori ka ardhur në rritje nga 5 punonjës në 9 punonjës, paraqitur në tabelën nr.33.
Struktura e sektorit të Bibliografisë sipas Urdhrit nr. 122, datë 17.09.2019, ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò, për periudhën në auditim:

Tabela nr.33: *Organika e sektorit albano-balkanologjik.*

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 17.09.2019	Nr. Punonjësish(fakt) 31.05.2021
1	Përgjegjës sektori	1	1	1
2	Klasifikatorë	1	1	1
3	Bibliografë	**2**	**2**	**2**
4	ndihmës bibliotekarë	**1**	**1**	**1**
5	Katalogimi retrospektiv elektronik/specialistë	**4**	**4**	**4**
Totali		**9**	**9**	**9**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Përveç detyrave që ky sektor ka, ndër detyrat kryesore që lidhen me digjitimin dhe QTDSH, janë

1. Ndjek dhe punon për pasurimin e bibliotekës digjitale me këto fonde:

- Fondi i dorëshkrimeve;
- Fondi i antikuarëve;
- Fondi i mikrofilmave antikuarë;
- Fondi i hartave me përmbajtje albano-balkanologjike.
- Fondi i librave me përmbajtje albano- balkanologjike.

2.Përzgjedh njësinë bibliotekare, që përmbushin parametrat më të mirë bibliografikë dhe fizikë për digjitim.

3.Dorëzon në Qendrën Bibliotekare të Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar njësitë bibliotekare për digjitim.

4.Kontrollon njësinë e digjituar pas përpunimit të njësisë së digjituar duke i krahasuar me njësinë origjinale.

5.Njofton për problematikat e hasura gjatë kontrollit të njësisë së digjituar punonjësit përgjegjës të QBDTSH.

6.Kryen përshkrimin bibliografik (Meta data) të njësisë bibliotekare të digjituar
dhe e përcjell në formë elektronike pranë përgjegjësit të Sektorit të Bibliografisë Kombëtare.

7.Kontrollon njësitë e digjituara pas hedhjes online duke i krahasuar me njësitë origjinale.

8.Njofton Sektorin e Bibliografisë Kombëtare për problematikat e hasura pas hedhjes online;

9. Verifikon saktësinë e produktit të shfaqur online në Bibliotekën Digjitale në faqen zyrtare të BKSH-së.

10. Hedh përshkrimin bibliografik të njësisë së digjituar në Bazën e të Dhënave Shtetërore (katalogun online/OPAC) me shënimin përkatës që njësia është edhe e digjituar. Pasqyron në skedarin manual shënimin që njësia është edhe e digjituar.

11.Çdo njësi bibliotekare që është objekt digjitimi është në përgjegjësinë individuale të punonjësit të caktuar për njësinë e përzgjedhur.

Sipas pyetësorit drejtuar këtij sektori nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.prot.350, datë 09.04.2021, intervistave të vazhdueshme të kryera me përgjegjësin e sektorit, u konstatua se:

Sipas detyrave të sipërcituara, në funksion të procesit të digjitalizimit, ky sektor ashtu sikurse e theksuam në analizën që iu bë edhe sektorit të bibliografisë, nuk ka një praktikë korrekte të përzgjedhjes së njësive bibliotekare për digjitim, të mirë përcaktuar me plane strategjike afatgjata si dhe në plane operacionale vjetorë. Përgjegjësi i sektorit e organizon punën nëpërmjet listave të dërguara me e-mail të cilat më pas nuk marrin miratim nga Titullari i Institucionit dhe janë të ndryshueshme çdo muaj sipas përparësive të ngjarjeve apo ekspozitave që BKSH zhvillon. Në këtë mënyrë nuk ka matje dhe menaxhim të burimeve njerëzore me ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë, pasi planifikimi mbetet spontan dhe pa llogaridhënie të punës së kryer.

Ky sektor si sektori përgjegjës në pasurimin e koleksioneve albano-balkanologjike (më tej Al-Ba)/Antikuarit/ Dorëshkrimeve/Hartave, duhet të kishte një planifikim të saktë vjetor më afate të mirë përcaktuara, duke parashikuar edhe ngjarjet me rëndësi historike për të cilat BKSH bazon aktivitetin e saj, listat përkatëse të antikuarëve, dorëshkrimeve dhe hartave që do të digjitohen në bashkëpunim me QTDSH-në, në bazë të të cilave në analizat tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore të institucionit dhe monitorimit të vazhdueshëm të verifikohej efektiviteti i punës së kryer nga sektorit, sipas planit të përcaktuar në numër apo njësi. Çdo njësi publike duhet të përgatisë planet vjetore të punës me informacion mbi objektivat të cilat janë planifikuar për të arritur. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se në procesin e

miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara.

E rëndësishme është të ketë një lidhje midis planeve vjetorë të njësive organizative dhe planit strategjik të njësisë publike.Mungesa në rastin konkret të këtyre planeve dhe realizimit të tyre ka sjellë menaxhim të burimeve njerëzore dhe financiare pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ñ, nenin 16, pika 2, si dhe nenin 23, ku citohet se:

Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit.

2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 23 Informacioni dhe komunikimi. *Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë:*

1. Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, ***brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.***

2. Një komunikim efektiv, ***si vertikal, ashtu edhe horizontal,*** *në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.*

3. Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4. Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet ***gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.***

2. Gjetje nga auditimi: Mungesa e planeve operacionale vjetorë dhe mujorë, për sektorin e Albano-Balkanologjisë, si sektori bazë për hartimin dhe planifikimin për digjitim të materialeve më rëndësi të veçantë kulturore, dhe si rrjedhim mungesa e gjurmës së auditimit, pasojë ***e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to, ka sjellë një digjitim në norma shumë të ulëta të*** antikuarëve, hartave dhe dorëshkrimeve.

Të dhënat statistikore nga BKSH, për sa është digjituar dhe sa ka mbetur për tâu digjituar, janë bazuar në bibliografitë kombëtare të librit shqip dhe të bibliografisë të materialeve albano-balkanologjike. Pra nga asnjë nga dy sektorët kryesorë që janë Sektori i Bibliografisë dhe Sektori i Albano-Ballkanologjisë, nuk mund të merret një shifër e saktë apo ñe certifikuarò se sa antikuarë apo materiale të tjera bibliotekare ka në tërësi Fondi për tâu digjituar.

Nga sa më sipër ky proces si në raportim ashtu dhe në digjitim paraqitet me mangësi të theksuara pasi asnjë nga sektorët përkatës nuk raporton të saktë, përqindje të punës së kryer në raport me njësitë bibliotekare totale të regjistruara **nga sektori i Zhvillimit të Koleksioneve.**

Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi përgjegjësit e sektorëve, si dhe nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues si dhe janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe Kontrollin ñ, si dhe manualin për MFK-në.

2. Konkluzion:BKSH-së i mungon një strategjie e qartë, brenda një kuadri ligjor të përshtatshëm, e cila është domosdoshmëri për përparimin dhe përmirësimin e procesit të digjitimit në BKSH.Kjo bëhet me qëllim jo vetëm për të siguruar rezultate të matshme, por e rëndësishme është që Strategjia të monitorohet dhe të vlerësohet në përputhje me metodologjinë e pranuar të treguesve të performancës.

Mungesa e gjurmës së auditimit në sektorin e Albano-Balkanologjisë si dhe në të gjitha proceset e digjitimit e cila mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura, ka sjellë një digjitim pjesërisht efektiv të materialeve bibliotekare të Fondit, pa pasur as pritshmëri dhe as targete të cilat duhet të arriheshin në fund të çdo tremujori, gjashtëmujori apo vit kalendarik.

2.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të hartohet një strategji digjitale me plane veprimi konkretë, duke dhënë përparësi dhe afate veprimi për çdo muaj.

Janar 2022 e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:Këshilli Shkencor dhe Këshilli Administrativ i Bibliotekës rezulton të kenë qenë jo efektiv, duke mos përmbushur detyrat e tyre funksionale në kundërshtim me nenin 16 dhe 17 të Statutit të BK miratuar me Urdhër nr.70, datë 13.02.2015, si dhe nenin 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò, duke sjellë mungesë në gjurmën e auditimit, mungesë të planeve të veprimtarisë studimore dhe mungesë te efektivitetit të BK-së, në procesin e digjitalizimit.

Nga auditimi u konstatua se Këshilli Shkencor i BK-së, funksionon si organ këshillimor i Drejtorit të BK dhe përbëhet prej 7 anëtarësh. Përbërja e Këshillit Shkencor miratohet nga Ministri i Kulturës me propozim të BK. Mbledhja e Këshillit thirret dhe drejtohet nga Titullari i saj dhe mblidhet jo më pak se 4 herë në vit, bazuar në nenin 16 të Statutit të BK, miratuar me Urdhër nr. 70, datë 13.02.2015. Për periudhën në auditim ky këshill është mbledhur përkatësisht 3 herë për vitin 2018, 0 (zero) për 2019 dhe 1 herë për vitin 2020.

- Nuk rezulton të ketë proces verbale të mbledhjeve të kryera nga Këshilli Administrativ i Bibliotekës në BK, për periudhën në auditim, për të parë dhe kuptuar se si janë zbatuar prioritetet kryesore të BK-së dhe konkretisht: Ecurinë e procesit të digjitalizimit dhe normimin e këtij procesi më qëllim matjen e efektivitetit të tij, në kundërshtim me nenin 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò. Ky këshill duhet të thirret nga drejtori dhe përbëhet nga përgjegjësit e sektorëve dhe si funksion kryesor ka: Shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, që kanë rëndësi primare në aktivitetin e BK-së. Drejtori planifikon dhe organizon veprimtarinë e institucionit mbështetur e ndihmuar nga Këshilli Administrativ dhe Këshilli Shkencor i BK.

3. Konkluzion:Këshilli Shkencor dhe Këshilli Administrativ i Bibliotekës rezulton të kenë qenë joefektiv, duke mos përmbushur detyrat e tyre funksionale në kundërshtim me nenin 16 dhe 17 të Statutit të BK miratuar me Urdhër nr.70, datë 13.02.2015, si dhe nenin 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò, duke sjellë mungesë në gjurmën e auditimit, mungesë të planeve të veprimtarisë

studimore dhe mungesë te eficencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të aktivitetit të BK-së, në procesin e digjitalizimit.
Nga auditimi u konstatua se Këshilli Shkencor i BK-së, funksionon si organ këshillimor i Drejtorit të BK dhe përbëhet prej 7 anëtarësh. Përbërja e Këshillit Shkencor miratohet nga Ministri i Kulturës me propozim të BK. Mbledhja e Këshillit thirret dhe drejtohet nga Titullari i saj dhe mblidhet jo më pak se 4 herë në vit, bazuar në nenin 16 të Statutit të BK, miratuar me Urdhër nr. 70, datë 13.02.2015.
Këshilli Shkencor shqyrton dhe jep mendime për:
a)Politikat e zhvillimit të BK, programet dhe planet e veprimtarisë studimore dhe vlerësimin e rezultateve të tyre.
b)Veprimtaritë kryesore të BK-së
c)Çështje të tjera që lidhen me aktivitetin e BK-së.
Nga verifikimet e kryera në arshivën e Institucionit, u konstatua se Këshilli shkencor është mbledhur përkatësisht sipas viteve, treguar në tabelën në vijim:

Tabela Nr.34: *Aktiviteti i këshillit Shkencor*

Periudha	Mbledhjet e Këshillit Shkencor
2018	3 (tre)
2019	0 (zero)
2020	1 (një)

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

b)Këshilli Administrativ i Bibliotekës, i cili sipas nenit 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò, thirret nga drejtori dhe përbëhet nga përgjegjësit e sektorëve dhe si funksion kryesor ka: Shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, që kanë rëndësi primare në aktivitetin e BK-së. Nuk rezulton të ketë proces verbale të këtyre mbledhjeve për periudhën në auditim, për të parë dhe kuptuar se si janë zbatuar prioritetet kryesore të BK-së dhe konkretisht: **Ecurinë e procesit të digjitalizimit dhe normimin e këtij procesi më qëllim matjen e efektivitetit të tij.**

3.1. Rekomandimi:Këshilli Shkencor të mblidhet jo më pak se 4 herë në vit **në zbatim të** nenit 16 të Statutit të BK, miratuar me Urdhër nr. 70, datë 13.02.2015, në bashkëpunim me Drejtorin e Institucionit duke bashkërenduar në fillim të çdo vitit kalendarik një plan pune me tema dhe prioritete konkrete në funksion të përmirësimit të performancës së aktivitetit të BKSH-së.

Janar 2022 e në vijimësi

3.2. Rekomandimi:Këshilli administrativ i BKSH i përbërë nga përgjegjësit e sektorëve të thirret çdo fillim muaji nga Drejtori i Institucionit, duke mbajtur proces-verbalet përkatëse në shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, që kanë rëndësi primare në aktivitetin e BK-së, si dhe mbajtjen e përgjegjësisë të secilit përgjegjës sipas sektorit që përfaqëson.

Janar 2022 e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua seDrejtori i Institucionit miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të BK, por ndryshimi i fundit ligjor në organikën e BK-së, i cili daton në datën 17.09.2019 nuk është i shoqëruar me një ndryshim në rregulloren aktuale të brendshme të miratuar nga ish-Drejtori i Institucionit me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò. Ajo që

konstatohet në vazhdimësi, është mos përditësimi i rregullores së brendshme të Institucionit *për një periudhë 10 vjeçare* pasi edhe rregullorja e re është akoma draft. Pra BK me gjithë ndryshimet strukturore por edhe teknologjike, ka vazhduar të funksionojë me një Rregullore tashmë ñ*të vjetër"*. Pikërisht mungesa e një rregulloreje në funksion të ndryshimit të strukturave ka bërë që mos të realizohet objektivi kryesor i saj që është :
BK veprimtarinë e saj e ndërton në bazë të Rregullores së Brendshme që përcakton detyrat dhe të drejtat e të gjithë elementëve të strukturës, duke synuar realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.
Gjithashtu në rregulloren aktuale të brendshme të Institucionit nuk janë reflektuar detyra të mirë përcaktuara si dhe detajim i detyrave për të gjitha strukturat ekzistuese si dhe të bëhet përshkrimi i punës për secilin specialist sipas funksionit që përfaqëson, bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 ñMbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, duke mos parashikuar marrëdhëniet e punës. Janë përcaktuar funksionet që ka ñpërgjegjësi i sektoritò, por nuk janë detajuar objektivat e punës për secilin specialist sipas sektorit përkatës, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion dhe kush përgjigjet për realizimet e detyrave për çdo sektor duke krijuar një mungesë llogaridhënie të vazhdueshme dhe jo efikasitet në punën e kryer, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.

<u>Konkluzion:</u>Mos përditësimi i rregullores së brendshme aktuale të BK-së të miratuar nga ish-Drejtori i Institucionit **me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010** ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtare ò *për një periudhë 10 vjeçare*, edhe pas ristrukturimit të BK më shumë se 1 (një) herë për periudhën në auditim ka sjellë një performancë të dobët të BK në tërësi në të gjitha funksionet e saj. Pra BK me gjithë ndryshimet strukturore por edhe teknologjike të cilat në këtë periudhë kanë evoluar në mënyrë të shpejtë, ka vazhduar të funksionojë me një Rregullore tashmë ñ*të vjetër"*. Pikërisht mungesa e një rregulloreje në funksion të ndryshimit të strukturave ka bërë që mos të realizohet objektivi kryesor i saj që është :
BK veprimtarinë e saj e ndërton në bazë të Rregullores së Brendshme që përcakton detyrat dhe të drejtat e të gjithë elementëve të strukturës, duke synuar realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.
Gjithashtu në rregulloren aktuale të brendshme të Institucionit nuk janë reflektuar detyra të mirë përcaktuara si dhe detajim i detyrave për të gjitha strukturat ekzistuese si dhe të bëhet përshkrimi i punës për secilin specialist sipas funksionit që përfaqëson, bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 ñMbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, duke mos parashikuar marrëdhëniet e punës. Janë përcaktuar funksionet që ka ñ**përgjegjësi i sektorit"**, por nuk janë detajuar objektivat e punës për secilin specialist sipas sektorit përkatës, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion dhe kush përgjigjet për realizimet e detyrave për çdo sektor duke krijuar një mungesë llogaridhënie të vazhdueshme dhe jo efikasitet në punën e kryer, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.

<u>4.1. Rekomandimi</u>: BKSH në bashkëpunim më Këshillin Shkencor **si**organi këshillimor i saj të marrë masa të menjëhershme për miratimin e draft-rregullores së re **"**Për organizimin, funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së BKSH-së ñ, duke kryer ndryshimet e nevojshme në përshtatje dhe në funksion të gjithë elementëve të strukturës, për realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.

Janar 2022 e në vijimësi

Observacioni i subjektitBKSH, me shkresën prot. nr. 185/15, datë 24.09.2021, shkresës me nr. 185/6, datë 20.09.2021, shkresës me nr.prot. 185/12, dt 21.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 203/6, datë 24.09.2021.
Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Observacioni juaj pranohet pjesërisht për të njëjtat argumente të paraqitura në fq. 102-103.
Gjithashtu vlen të theksohet që sektori i albano-balkanologjisë në raport është trajtuar vetëm për funksionin e përbashkët që ky sektor ka në procesin e digjitimit dhe marëdhëniet me QTDSH.

Struktura organizative, e sektorit të IT dhe teknologjive të reja, punonjësit, paraqitet si vijon:
Sipas organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 139, datë 28.03.2014 ñMbi miratimin e strukturës dhe organikës së BKò dhe të ndryshuar me urdhrin nr.108, datë 31.07.2018 òPër disa ndryshimeò në urdhrin e Kryeministrit, nr.139, datë 28.03.2014ò Për miratimin e strukturës dhe të organikës së BKò, ky sektor ka këtë përbërje:

***Tabela nr.35*:** *Struktura e IT deri në 31.07.2018*

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 01.01.2018	Nr. Punonjësish(fakt) 31.07.2018
1	Përgjegjës sektori	1	1	1
2	Specialistë IT	2	2	2
3	**Specialistë të QTDSH-së**	**2**	**2**	**2**
Totali		**5**	**5**	**5**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Me Urdhrin e sipërcituar, në gusht të vitit 2018. Sektori i IT, kalon pranë AKSH-it dhe QTDSH kalon në varësi të sektorit të Bibliografisë (viti 2019) duke i dhënë një prioritet programit të digjitimit përmes fuqizimit të ñQendrës Bibliotekare të Digjitimit të trashëgimisë së shkruarò, me shtimin e saj në numër me specialistë dhe përpunues të materialeve të digjituara, e cila do të funksionojë nën autoritetin e një prej sektorëve më të rëndësishëm të Institucionit.

Pavarësisht këtij ndryshimi, sektori i IT megjithëse u pakësua në përbërje dhe konkretisht u pakësua në numër si rezultat i ndryshimit strukturor, paraqitur në tabelë nr.36:

Tabela nr.36: *Struktura e IT, për periudhën 01.08.2018-e në vazhdim*

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 01.08.2018	Nr. Punonjësish(fakt) 25.05.2021
1	Përgjegjës sektori	1	1	1
2	Specialist IT	2	2	2
Totali		**3**	**3**	**3**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nuk ka ndryshuar asnjë funksion në rolin e vet si sektor dhe në punën e përbashkët të kryer për digjitalizimin si të materialeve bibliotekare ashtu edhe të shërbimeve online që BKSH u ofron lexuesve.
Përpara hartimit dhe miratimit të strategjisë Kombëtare të Ministrisë së Kulturës 2019-2025, në programin 2014-2018 të Ministrisë së Kulturës një ndër prioritetet e saj ka qenë ñDigjitalizimi i fondeve të Bibliotekës Kombëtareò. Në këtë kuadër, për fuqizimin e procesit të digjitimit, institucioni është mbështetur nga Ministria e Kulturës me fonde prej 22.880.000 lekë për blerje pajisjesh (viti 2014); me 5 (pesë) punonjës me kontratë të përkohshme pranë Qendrës Kombëtare të Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar (4 orë) miratuar me VKM nr.23, datë 20.01.2016òPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016, në njësitë e qeverisjes qendroreò (periudha maj-dhjetor 2016) dhe VKM nr.7, datë 11.01.2017, òPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendroreò.(shkurt-gusht 2017); përfshirjen në një delegacion të Ministrisë së Kulturës, të përgjegjëses së Sektorit të Informatikës e Teknologjive të Reja për të parë përvojat më të mira evropiane (Poloni, 2015). Në vitin 2018 institucioni bashkëpunoi me AKSH-in për hartimin e projektit ñNgritja e Sistemit të Dixhitalizimit të Bibliotekës Kombëtareò.
Në vitin 1999 në BKSH u instalua sistemi i parë i integruar bibliotekar, (sistemi informatik) **ADLIB**, versioni 4.4, nga kompania Adlib Informacion Sisteme (Holandë) sistem me anë të cilit janë regjistruar të dhënat e materialeve që gjenden në BKSH për periudhën 1999-2020. Përkatësisht të dhënat e data-basë-s për periudhën në të cilën BKSH ka funksionuar me Sistemin ADLIB jepen në tabelën nr.38:

Tabela nr.38: Të dhënat totale të regjistrimit informatik

Tipi i materialeve	2018	2019	2020	Data baza(1999-2020)
Libra	10468	4855	3599	123,026
Artikuj	8723	10054	4770	318,501
Audio vizuale	13	18	5	415
Seriale	10	14	6	1,597
Disertacione	766	551	153	8,189
Harta	70	17	0	1,372
Hedhur në sistem	**20,050**	**15,509**	**8,533**	(rekorde) **453,608**

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Aktualisht integrimi i të dhënave të digjituara bibliotekare, si rezultat i mangësive dhe problemeve të shfaqura në vite nga sistemi ADLIB, dhe kërkesave të vazhdueshme të BKSH-së, kryhet tashmë nga një Sistem i ri informatik i quajtur ALIS.
Në pyetësorin e drejtuar këtij sektori dhe intervistave të vazhdueshme të kryera, janë paraqitur mangësitë që sistemi ADLIB paraqiste në punën e përditshme të sektorëve të bibliotekës, dhe konkretisht:
Që prej vitit 2001 sistemi informatikë i BKSH-së nuk ka mundur të përditësohet duke sjellë edhe mangësitë e cituara në vijim:

1. nuk lejonte implementimin e të rejave të fundit në fushën e shkencës së bibliotekave dhe të informacionit; si p.sh. Nuk mbështet formatin 13 shifror të ISBN;
fusha ISBN nuk plotësohet nga punonjësit dhe nuk është element kërkimi për përdorues-it në katalogun online;

2. sistemi menaxhohej në platformën DOS dhe për rrjedhojë ishte i vështirë implementimi i funksionaliteteve të reja mbi këtë version dhe përshtatja ndaj risive në teknologji.
(nuk përshtatej me versionet e reja të sistemeve operative);
3. nuk realizohej anëtarësimi online
4. nuk realizohej rezervimi online
5. rekordet e programit eksportoheshin në formate jo të përshtatshëm për tâu integruar në sisteme të tjera të ngjashme;
6. nuk shfaqej statusi i huazimit online
7. fushat e hedhjes së të dhënave në sistem ishin të kufizuara, si rrjedhojë dhe fushat e kërkimit online për përdoruesin.
8. Sistemi ADLIB nuk njihte standardin UNICODE

Nga sektori i IT, në bashkëpunim me sektorët e tjerë në BK janë bërë sugjerime mbi përmirësimin që duhej kryer në sistemin e integruar bibliotekar, si domosdoshmëri për sigurinë e bazës së të dhënave e më pas për shtimin e funksionaliteteve të saj. Në korrespodencën shkresore marrë nga protokolli i BKSH-së janë shkresat e ish ï titullarit të Institucioni, z. X, drejtuar Ministrisë së Kulturës ku kërkon parashikimin në buxhetin e vitit 2019, të fondit për realizimin e prokurimit me objekt: ñNgritja e sistemit të digjitalizimit të BK-sëò, konkretisht , shkresa e AKSH-it me nr.prot.6474, datë 19.11.2018; shkresa e BK-së, me nr. prot.455/3, datë 22.11.2018, shkresa e BK-së, me nr. prot.455/5, datë 07.12.2018, si dhe shkresa e Ministrisë së Kulturës me nr.prot.8908/1, datë 05.12.2018, e cila kundërshton rishikimin e buxhetit për vitin 2019, të BK-së, pasi kërkesat e BK-së janë jashtë afateve të parashikuara për fondet buxhetore dhe si rrjedhim nuk mund të plotësohen.
Në zbatim të pikës II, nënpika 1" dhe "1" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 673 datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" i ndryshuar, Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", procedurën e prokurimit mbi ñNgritjen e sistemit të dixhitalizimit për Bibliotekën Kombëtareò e realizoi AKSH-I dhe pas përfundimit të procedurës u lidh kontrata me Nr. prot.7442 me datë 27.12.2018 midis palëve:
AgjenciaKombëtareeShoqërisësëinformacionit(AKSHI),e cila ështëAutoriteti kontraktor Kontraktuesi: ñ***X." ShPK,*** dhe ***Biblioteka Kombëtare,*** përfituesi i shërbimit me vlerë totale: 102,270,000 lekë pa TVSH ose 122,724,000 lekë me TVSH. Sipas kontratës, neni 3, është përcaktuar se:
Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 57 muaj, nga të cilat 9 muaj implementim dhe 48 muaj (4vjet)mirëmbajtje. Sipas shkresës me nr.prot.455/8, datë 26.12.2018, të BKSH-së, personat e autorizuar nga BKSH, për ndjekjen e kontratës ñNgritja e sistemit të dixhitalizimit për Bibliotekën Kombëtareò me Nr. Prot.7442 me datë 27.12.2018 për procedurën e prokurimit të finalizuar nga AKSH-i, janë z.X (përgjegjëse e sektorit të IT në BK) dhe z.X , (përgjegjëse e sektorit të studimeve dhe kualifikimit në BK).
Sipas këtij neni të kontratës të sipërcituar, afati i implementimit të sistemit të ri të integruar informatikë ka qenë data 27.09.2019, nga ku rezulton se në këtë datë nuk është bërë marrja në dorëzim e sistemit nga BKSH nga kontraktuesi ñXò ***ShPK.***
Këtëedëshmojnë shkresat me nr.prot.534, datë 11.09.2019 (memo) drejtuar Drejtorit të BKSH-së, z. X nga mbikëqyrësja e kontratës, z.X , me lëndë: Mosrespektimi i afatit të raportit përfundimtar në BKSH nga Kontraktuesi.

Konkretisht: Draft raporti përfundimtar, testimi i sistemit, trajnimi i përdoruesve të stafit, si dhe raporti përfundimtar i cili duhet të dorëzohet brenda 20 ditëve, pas marrjes së komentit të draft raportit.
Mosrespektimi i afatit është përcjellë me shkresë drejtuar AKSH-it nga Titullari i BKSH-së, me nr.prot.534/2, datë 14.10.2019, dhe nga verifikimi në protokollin e Institucionit nuk rezulton të ketë kthim përgjigje nga autoriteti kontraktor ***AgjenciaKombëtareeShoqërisësëinformacionit(AKSH-I).***
Nga kërkesat e vazhdueshme të grupit të auditimit, në lidhje me mosrespektimin e afatit, AKSH-i dërgon me e-mail në adresën zyrtare të BKSH-së: Amendamentin me nr.prot.5281, datë 04.09.2019 të lidhur ndërmjet palëve AKSH-it dhe X, ShPK (kontraktuesi), ku në nenin 1, citohet shprehimisht:
Nëpërmjet këtij amendamenti, palët bien dakord të shtyjnë afatin e realizimit të punimeve të mbetura të përcaktuar nën nenin 3 të kontratës, duke përcaktuar si afat përfundimtar datën ***27 nëntor 2019.***
Nga verifikimet e kryera në protokoll shoqëria ñXò, ShPK , ka dorëzuar dokumentacionet përkatës për realizimin e shërbimeve, në BKSH, me shkresën me nr.prot.7363, datë 27.11.2019.



Sistemi i ri (***i prezantuar në qershor 2020 dhe i vendosur në çdo kompjuter në BK në korrik 2020***) përmban module të ndërlidhur me njëri-tjetrin të cilat janë të përshtatur sipas kërkesave specifike të stafit dhe institucionit të Bibliotekës Kombëtare, paraqitur në skemën bashkëlidhur:

Për stafin e Bibliotekës Kombëtare u krijua një mjedis më i mirë pune, më i shpejtë dhe më funksional.
Janë shtuar fusha të funksionaliteteve për të cilat implementimi në sistemin e vjetër ishte i pamundur.
Shembull:

- Numri unik i ISBN që merr çdo libër që botohet kishte vite që nuk regjistrohej në data bazën e BK-së si dhe mungesën e ndërveprimit të moduleve me njëri-tjetrin.
- Ndërfaqe të veçanta raportesh / statistikash;
- Lehtësimin në menaxhim dhe në mirëmbajtje teknike;

Digjitalizimi i materialeve të Bibliotekës Kombëtare.(Skanim i materialeve)
Një nga objektivat kryesorë të projektit është leximi online i trashëgimisë kulturore kombëtare të shkruar, e jo vetëm, pjesë e *draft-strategjisë* së Bibliotekës Kombëtare, për të cilin konstatohet se janë ndjekur të gjithë procedurat dhe standardet e bibliotekave simotra për procesin e skanimit, përpunimit të materialeve si dhe publikimin e tyre. Falë këtij procesi të digjitalizimit, BKSH është bërë pjesë e portaleve euro-atlantike EUROPEANA (marrëveshje anëtarësimi CENL / 2010) dhe ËORLD DIGITAL LIBRARY (ftesë për partneritet nga UNESCO-s dhe Bibliotekës së Kongresit / 2009).

Ndërsa për shfaqjen në ëeb është shfrytëzuar formati PDF i tyre pasi këto materiale kalojnë në procesin e njohjes së karaktereve. (Optical Character Recognition, OCR)
Materiali pasi kalon në proceset e mësipërme paraqitet me një cilësi të lartë dhe në një ndërfaqe të pajisur me funksionalitete shtesë të cilat janë të bazuara në frameëork-un ndërkombëtar të ndërveprimit të imazheve IIIF (International Image Interoperability **Frameëork).**
Gjithashtu u zgjidh problematika disa vjeçare në lidhje me publikimin online të njësive bibliotekare të digjitalizuara. (hapësira digjitale). Nga mungesa e hapësirave digjitale numri i faqeve të publikuara online ishte shumë i kufizuar, pavarësisht që procesi i skanimit vazhdonte rregullisht.
Më poshtë janë paraqitur pamje të shfaqjes në ëeb-in e BKSH-së, të faqeve apo materialeve të ndryshme bibliotekare të skanuara, proces i cili ka vazhduar rregullisht por me sistemin e vjetër informatikë ADLIB, nuk arrinte të shfaqeshin një numër kaq i madh faqesh, për arsye të cituara në material në faqen nr. 113.





Në vitin jubilar të kremtimit të 100-vjetorit të krijimit të BKSH-së, falë realizimit të projektit, përmes sistemit të ri bibliotekar,prej muajit qershor të vitit 2020, për përdoruesit e grup moshave të ndryshme ofrohet një faqe e re me dizajn të ri konceptuar, një format modern dhe lehtësisht i përdorshëm, rubrika të reja, fusha dhe funksionalitete të shtuara,shumëllojshmëri elementësh kërkimi e shfletimi të bibliotekës digjitale (imazh. libër, galeri), tanimë të ofruara edhe nëpërmjet rrjetit mobile. Mbi 265 mijë faqe librash, revistash, doreshkrimesh, antikuarësh, hartash vijnë për lexuesit/përdoruesit, studiuesit shqiptarë e të huaj, studentët e pedagogët, si materiale të digjituara të ñ*shfletueshme"* duke përbërë një vlerë të shtuar edhe për punën kërkimore - shkencore.

Grafiku nr. 5 Paraqitja e Bibliotekës Digjitale online me numrin e faqeve të digjituara në vitet 2015-2020



Grafiku nr. 6. Paraqitja e Bibliotekës Digjitale online me njësitë e digjituara në vitet 2015-2020



Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Digjitalizimi i shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare.

Në qershor të 2020, BK u prezantua online me një sistem të ri të integruar bibliotekar, konform standardeve tekniko-profesionale si dhe me një faqe zyrtare të re moderne, më e lehtë në përdorim (user-friendly) si dhe me elementë më të shumtë sigurie.

Si dhe u shtuan dhe u përmirësuan shërbime si:

- Anëtarësimi online
- Rezervimi i librit online;
- Leximi i librit online;
- Logimi i përdoruesve;
- Aplikim për marrje dhe anulim ISBN online

Të dhënat për **statistikat për aksesin online në faqen zyrtare të Bibliotekës Kombëtare,** në mënyrë tabelore dhe grafike, jepen në vijim në tabelën nr.11dhe grafikun përkatës:

Tabela nr.38:

	Vizita online të faqes	Qasja në rubrikat e faqes online	Qasja në Katalogun Elektronik	Qasja në Bibliotekën Digjitale	Qasja në Bibliografitë Online
2018	173913	251905	110494	6871	1593
2019	173124	254649	106624	8047	1865
2020	259314	434979	150136	10850	2745

Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Grafiku nr. 7: Qasja online në faqen zyrtare të BK



Nga analiza e kryer sipas intervistave dhe përgjigjeve shkresore të marra nga sektori i IT-së në BKSH, ka përmirësim në hedhjen, organizimin dhe shfaqjen e koleksioneve/njësive të digjituara në programin e Bibliotekës Digjitale, dhe kjo si rezultat i implementimit të sistemit të ri ALIS, pasi ky sistem e ofron këtë mundësi si në shpejtësinë e realizimit të hedhjes online të njësive të digjituara ashtu edhe në sigurinë që ofron për ruajtjen e tyre, pavarësisht numrit të madh të hedhjeve. Implementimi i këtij sistemi mundësoi hedhjen online të rreth 445,370 rekorde të bazës së të dhënave shtetërore data BKSH/data NLA, të cilat ishin të skanuara në

vite nga sektorët përkatës por nuk mund të kryhej shfaqja e tyre me një sistem informatik mbi 20 vite të pa përditësuar.

***Por duhet të theksojmë se nuk ka ecur me këtë ritëm procesi i skanimit të materialeve bibliotekare,* si rezultat i mungesës së organizimit të punës nga tre sektorët me rëndësi primare në këtë proces, të analizuara hollësisht në raport. Nëse procesi i skanimit do të kishte pasur efektivitetin e duhur dhe të matshëm nga strukturat drejtuese të BKSH-së, do të kishim një numër më të madh njësish të digjituara, siç janë dokumentet me vlerë të rrallë historike dhe kulturore, të cilat do të asistoheshin lehtë në internet nga lexuesit, pa qenë nevoja e ardhjes në ambientet e bibliotekës.**

Një arsye e vonesës së përshtatjes edhe nga ana e punonjësve të BKSH-së me sistemin e ri informatik, ka qenë edhe situata e shkaktuar prej pandemisë *COVID-19*, e cila ka sjellë pasojat tashmë konkrete.

Observacioni i subjektitBKSH, me shkresën prot. nr. 185/15, datë 24.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 203/6, datë 24.09.2021, ju shpreheni se (fq.32)(në mënyrë të përmbledhur):
Paragrafi i parë s'qëndron dhe paragrafi i dytë – s'ka lidhje fare me pandeminë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Observacioni juaj nuk pranohet dhe asnjë argument që ju shkruani nuk ñqëndronò.

Në lidhje me paragrafin e parë janë problematika të shpjeguara dhe të shkruajtura nga përgjegjësja e IT dhe pikërisht për asyen qëështë një gjë teknike, grupi i auditimit ka qenë korrekt edhe në përshkrimin e situatës ashtu siç është paraqitur në përgjigjen dhe intervistat e vazhdueshme sipas pyetësorit drejtuar këtij sektori dhe unë po e ri vë këtë pjesë të RPA

Nga sektori i IT, në bashkëpunim me sektorët e tjerë në BK janë bërë sugjerime mbi përmirësimin që duhej kryer në sistemin e integruar bibliotekar, si domosdoshmëri për sigurinë e bazës së të dhënave e më pas për shtimin e funksionaliteteve të saj. Në korrespodencën shkresore marrë nga protokolli i BKSH-së janë shkresat e ish ï titullarit të Institucioni, z. X drejtuar Ministrisë së Kulturës ku kërkon parashikimin në buxhetin e vitit 2019, të fondit për realizimin e prokurimit me objekt: ñNgritja e sistemit të digjitalizimit të BK-sëò, konkretisht , shkresa e AKSH-it me nr.prot.6474, datë 19.11.2018; shkresa e BK-së, me nr. prot.455/3, datë 22.11.2018, shkresa e BK-së, me nr. prot.455/5, datë 07.12.2018, si dhe shkresa e Ministrisë së Kulturës me nr.prot.8908/1, datë 05.12.2018, e cila kundërshton rishikimin e buxhetit për vitin 2019, të BK-së, pasi kërkesat e BK-së janë jashtë afateve të parashikuara për fondet buxhetore dhe si rrjedhim nuk mund të plotësohen.

Në zbatim të pikës II, nënpika 1" dhe "1" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 673 datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" i ndryshuar, Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", procedurën e prokurimit mbi ñNgritjen e sistemit të dixhitalizimit për Bibliotekën Kombëtareò e realizoi AKSH-I dhe pas përfundimit të procedurës u lidh kontrata me Nr. prot.7442 me datë 27.12.2018 midis palëve:

AgjenciaKombëtareeShoqërisësëinformacionit(AKSHI), e cila ështëAutoriteti kontraktor Kontraktuesi: ñ***X." ShPK,*** dhe ***Biblioteka Kombëtare,*** përfituesi i shërbimit me vlerë totale: 102,270,000 lekë pa TVSH ose 122,724,000 lekë me TVSH. Sipas kontratës, neni 3, është përcaktuar se:

Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 57 muaj, nga të cilat 9 muaj implementim dhe 48 muaj (4vjet)mirëmbajtje. Sipas shkresës me nr.prot.455/8, datë 26.12.2018, të BKSH-së, personat e autorizuar nga BKSH, për ndjekjen e kontratës

ñNgritja e sistemit të dixhitalizimit për Bibliotekën Kombëtareò me Nr. Prot.7442 me datë 27.12.2018 për procedurën e prokurimit të finalizuar nga AKSH-i, janë z.X (përgjegjëse e sektorit të IT në BK) dhe z.X, (përgjegjëse e sektorit të studimeve dhe kualifikimit në BK).
Sipas këtij neni të kontratës të sipërcituar, afati i implementimit të sistemit të ri të integruar informatikë ka qenë data 27.09.2019, nga ku rezulton se në këtë datë nuk është bërë marrja në dorëzim e sistemit nga BKSH nga kontraktuesi ñXò ***ShPK.***
Këtëedëshmojnë shkresat me nr.prot.534, datë 11.09.2019 (memo) drejtuar Drejtorit të BKSH-së, z. X nga mbikëqyrësja e kontratës, z.X , me lëndë: Mosrespektimi i afatit të raportit përfundimtar në BKSH nga Kontraktuesi.
Konkretisht: Draft raporti përfundimtar, testimi i sistemit, trajnimi i përdoruesve të stafit, si dhe raporti përfundimtar i cili duhet të dorëzohet brenda 20 ditëve, pas marrjes së komentit të draft raportit.
Mosrespektimi i afatit është përcjellë me shkresë drejtuar AKSH-it nga Titullari i BKSH-së, me nr.prot.534/2, datë 14.10.2019, dhe nga verifikimi në protokollin e Institucionit nuk rezulton të ketë kthim përgjigje nga autoriteti kontraktor ***AgjenciaKombëtareeShoqërisësëinformacionit(AKSH-I).***
Nga kërkesat e vazhdueshme të grupit të auditimit, në lidhje me mosrespektimin e afatit, AKSH-i dërgon me e-mail në adresën zyrtare të BKSH-së: Amendamentin me nr.prot.5281, datë 04.09.2019 të lidhur ndërmjet palëve AKSH-it dhe X, ShPK (kontraktuesi), ku në nenin 1, citohet shprehimisht:
Nëpërmjet këtij amendamenti, palët bien dakord të shtyjnë afatin e realizimit të punimeve të mbetura të përcaktuar nën nenin 3 të kontratës, duke përcaktuar si afat përfundimtar datën ***27 nëntor 2019.***
Nga verifikimet e kryera në protokoll shoqëria ñXò, ShPK , ka dorëzuar dokumentacionet përkatës për realizimin e shërbimeve, në BKSH, me shkresën me nr.prot.7363, datë 27.11.2019.
Por duhet të theksojmë se nuk ka ecur me këtë ritëm procesi i skanimit të materialeve bibliotekare, **si rezultat i mungesës së organizimit të punës nga tre sektorët me rëndësi primare në këtë proces, të analizuara hollësisht në raport. Nëse procesi i skanimit do të kishte pasur efektivitetin e duhur dhe të matshëm nga strukturat drejtuese të BKSH-së, do të kishim një numër më të madh njësish të digjituara, siç janë dokumentet me vlerë të rrallë historike dhe kulturore, të cilat do të asistoheshin lehtë në internet nga lexuesit, pa qenë nevoja e ardhjes në ambientet e bibliotekës.**
Pra sikurse konstatohet për arsye të cituara më sipër implementimi i sistemit të ri ALIS ka qenë i domosdoshëm në procesin e digjitalizimit pasi kështu është edhe shkresa e cituar nga ish Drejtori i BKSH, z.X :*Në korrespodencën shkresore marrë nga protokolli i BKSH-së janë shkresat e ish –titullarit të Institucioni, z.X drejtuar Ministrisë së Kulturës ku kërkon parashikimin në buxhetin e vitit 2019, të fondit për realizimin e prokurimit me objekt:* ***"Ngritja e sistemit të digjitalizimit të BK-së",*** *konkretisht , shkresa e AKSH-it me nr.prot.6474, datë 19.11.2018; shkresa e BK-së, me nr. prot.455/3, datë 22.11.2018, shkresa e BK-së, me nr. prot.455/5, datë 07.12.2018, si dhe shkresa e Ministrisë së Kulturës me nr.prot.8908/1, datë 05.12.2018, e cila kundërshton rishikimin e buxhetit për vitin 2019, të BK-së, pasi kërkesat e BK-së janë jashtë afateve të parashikuara për fondet buxhetore dhe si rrjedhim nuk mund të plotësohen.*
Gjithashtu ky sistem ka pasur vonesat e veta si në implementim të argumentuar më sipër(ju lutem ri lexojini) ashtu edhe në përshtatjen e punonjësve të BKSH me këtë sistem të ri, konfirmuar kjo nga çdo punonjës i BKSH-së në intervistat e vazhdueshme.

- ***Të tjera të dala gjatë auditimit.***

Sektori i studimeve dhe kualifikimit dhe roli i tij në efektivitetin e procesit të digjitalizimit.

Konkretisht me trajnimin e punonjësve në çdo fushë të bibliotekonomisë por edhe për përdorimin e sistemit të ri informatikë, ALIS, merret **Sektori i studimeve dhe i kualifikimit, sipas** Rregullores së Brendshme të miratuar nga Drejtori i Institucionit me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò.

Misioni i këtij sektori është:

- Organizon, bashkërendon dhe ndjek përgatitjen profesionale dhe kualifikimin e vijueshëm të punonjësve të bibliotekave të sistemit kombëtar. Ndjek zhvillimet e shkencës së bibliotekës dhe të informacionit bibliotekar dhe punon për zbatimin e tyre në BKSH dhe në sistemin bibliotekar të vendit.
- **Harton udhëzime për unifikimin e proceseve të përpunimit të materialeve bibliotekare në bibliotekat e sistemit kombëtar, bazuar në standardet përkatëse, si faktor me rëndësi për shkëmbimin e informacionit. Studion dhe përgjithëson përvojën më të mirë të punës së bibliotekave, si dhe harton rregullat bazë të teknikës bibliotekare për sistemin kombëtar të bibliotekave dhe udhëzime të ndryshme metodike.**
- Përgatit botime profesionale dhe kryen aftësimin në informacion të përdoruesve.
- Organizon dhe koordinon Shkollën Kombëtare të Bibliotekonomisë pa shkëputje nga puna për sistemin kombëtar bibliotekar.
- Përgatit leksione, tekste mësimore, manuale, materiale metodike për probleme të bibliotekonomisë dhe të informacionit bibliotekar për të gjithë sistemin bibliotekar të vendit, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, si dhe në bashkëpunim me sektorët e BKSH-së.

Gjithashtu e përfshirë brenda këtij sektori është edhe Qendra e Trajnimit Bibliotekar, e cila ndër të tjera kryen kualifikimin e vijueshëm të punonjësve për tôu diplomuar në bibliotekonomi, për të gjithë sistemin bibliotekar të vendit.

Nisur nga pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.prot.380, datë 06.05.2021, drejtuar këtij sektori, si dhe përgjigjeve dhe intervistave të vazhdueshme të kryera, ka rezultuar se:

Programet e trajnimit për vitet 2018-2019 dhe 2020 për specialistët e BK-së, janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit në bashkëpunim me zv/drejtoren, z.X , dhe kanë marrë miratim nga Titullari i Institucionit. Për vitet 2019-2020, programet e trajnimit janë fokusuar kryesisht në projektin ñNgritja e sistemit të dixhitalizimit të Bibliotekës Kombëtareò. Kështu, programet kanë qenë të bazuara në dy komponentë, më konkretisht në përditësimin e njohurive mbi standardet ekzistuese, si dhe në marrjen e njohurive mbi standardet e reja dhe zbatimin e tyre në praktikë, por edhe në mbështetje të shërbimeve online që BK do të ofronte. Komponenti i parë ka qenë përforcimi dhe përditësimi i njohurive të stafit në lidhje me standardet ndërkombëtare, në të cilat bazohej edhe më parë puna në sistem, si ISBD (Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik), duke përfshirë të gjitha zonat e përshkrimit (siç është pasqyruar edhe në tabelën më lart); AACR2 (Rregullat Anglo-Amerikane të Përshkrimit) në harmoni me ISBD-në; KDU (Klasifikimi Dhjetor Universal), duke u përqendruar në metodikën e klasifikimit për të gjitha klasat kryesore, si dhe përdorimin e

përcaktuesve të përgjithshëm e të veçantë dhe përcaktimin dhe analizimin e subjektit sipas klasifikimit lëndor, standarde këto që përdoren për katalogimin përshkrues dhe sipas subjektit të materialeve bibliotekare, duke vazhduar me prezantimin, shpjegimin dhe përvetësimin e standardeve të reja ndërkombëtare, si MARC 21 (Formate të Komunikimit dhe Shkëmbimit të Informacionit), ISO 639 (Standard Ndërkombëtar për Përfaqësimin e Kodeve të Gjuhëve), të cilat po implementoheshin për herë të parë në sistemin e integruar bibliotekar të BK-së. Komponenti i dytë ka qenë prezantimi dhe njohja me shërbimet online që BK ofronte përmes platformës qeveritare e-Albania, si dhe aftësimi i stafit në performimin e këtyre shërbimeve në ndihmë të përdoruesve, botuesve, lexuesve etj. të BK-së.
Nëse në vitin 2019 trajnimet me stafin e BK-së rezulton të jenë përqendruar më tepër në aspektin teorik, duke prekur më pak atë praktik, gjatë vitit 2020 trajnimet janë fokusuar tërësisht në aspektin praktik dhe më konkretisht në shërbimet online të BK-së për përdoruesit e saj, si dhe në plotësimin e fushave të standardit MARC 21 për të gjithë tipat e regjistrimeve, si bibliografike, ashtu edhe për termat e njësuara, duke ushtruar njëkohësisht edhe punën në sistemin e ri. Duke pasur parasysh vitin 2020 si vit pandemik, nga muaji prill e përgjatë gjithë vitit, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, programi i trajnimeve është zhvilluar online, përmes aplikacionit SKYPE dhe google classroom.
Në vitin 2020 janë kryer nga ky sektor në bashkëpunim me specialistët e Sektorit IT në BK, ***16 seanca trajnimi*** me këto tema :

1. Platforma online google classroom:
2. krijimi i llogarive dhe menaxhimi i tyre nga punonjësit e bibliotekës;
3. Shërbimet e-Albania:
4. aksesi në platformën qeveritare e-Albania;
5. shërbimet që ofrohen nga BK përmes platformës e-Albania;
6. si të ndihmojmë përdoruesit për të aplikuar për anëtarësim dhe rezervim/huazim në BK.

Ndërsa nga Sektori i Studimeve dhe i Kualifikimit janë realizuar ***48 seanca trajnimi,*** me këto tema:

- Vështrim i përgjithshëm mbi formatet MARC 21, çfarë janë dhe përse shërbejnë ;
- formati i të dhënave bibliografike;
- formati i të dhënave të termave të njësuara;
- formati i të dhënave të klasifikimit;
- formati për informimin e komunitetit;
- formati për të dhënat e koleksioneve bibliotekare;
- listat e kodeve MARC;
- struktura e rekordeve MARC si dhe zbatimi i formateve MARC 21 sipas fushave dhe nën fushave përkatëse.

QTB kryen kualifikimin e vijueshëm të punonjësve të diplomuar në bibliotekonomi për të gjithë sistemin bibliotekar të vendit, përmes realizimit të programit të saj vjetor, i cili miratohet nga titullari i institucionit. Nëpërmjet saj organizohen seminare për probleme të veçanta bashkëkohore të shkencës së bibliotekës dhe të informacionit në ndihmë të kualifikimit të vijueshëm të punonjësve të BKSH-së dhe të bibliotekave të tjera të vendit.
Programi realizohet përmes seminaresh, leksionesh, diskutimesh, demonstrimesh etj. dhe konceptohet si përçim i zhvillimeve më të fundit të shkencës së bibliotekës dhe të informacionit, zhvillimit të standardeve ndërkombëtare, praktikave më të mira botërore, por edhe kombëtare, si dhe rifreskimit të njohurive apo përditësimit të tyre. Lektorët zgjidhen nga specialistët më të mirë të vendit në fushën e bibliotekonomisë. Në raste të veçanta ftohen

edhe specialistë të huaj. Përmes trajnimeve kryhet kualifikimi i vijueshëm nëpërmjet pajisjes së bibliotekarëve me dije, informacion dhe të reja nga fusha e bibliotekonomisë. QTB realizon njohjen dhe përvetësimin e teknologjisë dhe të pajisjeve informatike nga ana e specialistëve të bibliotekave.
Zbatimi i programit të QTB-së ndiqet nga specialisti për trajnim i saj.
Përgjatë vitit 2018 pranë QTB-së kanë ndjekur programin e kualifikimit të vijueshëm (sipas programit të miratuar nga titullari, me 24 tema) 45 punonjës të bibliotekave të rrjetit kombëtar dhe 39 punonjës të BKSH-së. Për shkak të gjendjes së emergjencës së datës 23 qershor 2018, QTB e ndërpreu veprimtarinë e saj në lidhje me zhvillimin e programit të trajnimit, (pasi të gjithë specialistët e BK-së u angazhuan në mbarëvajtjen e situatës së emergjencës), duke e rifilluar në 26 shtator të vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019 u realizua pjesa e mbetur e programit të vitit 2018 me sistemin bibliotekar kombëtar. Të dhënat mbi numrin e pjesëmarrësve dhe numrin e trajnimeve në BK, për periudhën në auditim jepen në formë tabelore dhe grafikisht në vijim:

Tabela nr.39: *Tabela e trajnimeve të specialistëve të BK-së.*
Burimi i të dhënave BKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Institucioni	**2018**		**2019**		**2020**	
BKSH	***Nr. trajnimeve***	***Pjesëmarrës***	***Nr. trajnimeve***	***Pjesëmarrës***	***Nr. trajnimeve***	***Pjesëmarrës***
	14	39	17	55	24 tema (64 seanca trajnimi)	59
Sistemi bibliotekar kombëtar	***Nr. trajnimeve***	***Pjesëmarrës***	***Nr. trajnimeve***	***Pjesëmarrës***	***Nr. trajnimeve***	***Pjesëmarrës***
	9	45	5	54	----	-----
Totali	**23**	**84**	**22**	**109**	**64**	**59**

E dhënë grafikisht niveli i trajnimeve dhe pjesëmarrësve për periudhën në auditim paraqitet në grafikun nr. 8:

Grafiku nr.8.*Realizimi i programit vjetor të QTB-së.*



Nga të dhënat statistikore marrë nga ky sektor për periudhën në auditim, rezultoi se:
-Përgjatë vitit 2019 pranë QTB-së kanë ndjekur programin e kualifikimit të vijueshëm (sipas programit të miratuar nga titullari, me 17 tema) 55 punonjës të BK-së, gjithashtu edhe 54 punonjës të bibliotekave të rrjetit kombëtar për 5 temat e mbetura nga programi i vitit 2018, i cili u shty në kohë për shkak të pezullimit të tij nga situata e emergjencës e datës 23 qershor 2018.
-Për vitin 2020, pranë QTB-së kanë ndjekur programin e kualifikimit të vijueshëm (sipas programit online të miratuar nga titullari, për shkak të situatës së pandemisë shkaktuar nga COVID-19 ï me 24 tema) 59 specialistë të BK-së nga sektorët e Katalogimit, Bibliografisë, Albano-Balkanologjisë, Zhvillimit të Koleksioneve, Marrëdhënieve dhe Shkëmbim-Huazimit Bibliotekar me Jashtë, Koleksioneve, Shërbimit dhe Informacionit dhe Sektorit të Studimeve dhe të Kualifikimit. 24 Temat e programit online të QTB-së për vitin 2020 janë zhvilluar në 16 seanca trajnimi nga specialistët e IT në BK, në lidhje me përvetësimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në mbarëvajtjen e trajnimeve online, komunikimit virtual dhe shërbimeve online në ndihmë dhe funksion të përdoruesve të bibliotekës në distancë, si dhe në 48 seanca trajnimi nga Sektori i Studimeve dhe i Kualifikimit, në lidhje me njohjen, përvetësimin dhe zbatimin e standardeve të reja në sistemin e digjitalizimit të BK-së, në regjistrimin më të detajuar e në nivel më të plotë të të dhënave bibliografike dhe të dhënave të termave të njësuara, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësi më të lartë të bazës së të dhënave të katalogut online dhe në dhënien e një informacioni më të plotë, më të saktë e cilësor përdoruesve. E dhënë grafikisht trendi i trajnimeve të kryera në fushën e teknologjisë dhe pajisjeve informatike, sipas standardeve bibliotekare jepet në vijim në grafikun nr. 9:

Grafiku nr.9



Sikurse konstatohet, numri i trajnimeve për përvetësimin e teknologjisë dhe pajisjeve informatike në lidhje me implementimin e sistemit të ri ALIS, është rritur ndjeshëm gjatë 2020, edhe pse kanë qenë trajnime-online, si rezultat i pandemisë Covid -19.

Nga auditimi u konstatua se: Referuar detyrave funksionale të sektorit, sipas Rregullores së Brendshme të miratuar nga Drejtori i Institucionit me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò, neni 18/Funksionimi i BK-së, konkretisht Sektori i studimeve dhe kualifikimit, objektin kryesor të misionit të tij ka:

✓ *Harton udhëzime për unifikimin e proceseve të përpunimit të materialeve bibliotekare në bibliotekat e sistemit kombëtar, bazuar në standardet përkatëse, si faktor me rëndësi për shkëmbimin e informacionit. Studion dhe përgjithëson përvojën më të mirë të punës së*

bibliotekave, si dhe harton rregullat bazë të teknikës bibliotekare për sistemin kombëtar të bibliotekave dhe udhëzime të ndryshme metodike.

✓ *Përgatit botime profesionale dhe kryen aftësimin në informacion të përdoruesve.*

Organizon dhe koordinon Shkollën Kombëtare të Bibliotekonomisë pa shkëputje nga puna për sistemin kombëtar bibliotekar.

Nga përgjigjet e pyetësorëve dhe dokumentacionet shkresore të dorëzuara nga ky sektor, në kuadër të "Ngritjes së sistemit të digjitalizimit të BK-së", janë paraqitur :

- Manual për regjistrimin e termave të njësuara në MARC 21;
- Manual për katalogimin e monografive në MARC 21; Manual për vlerat e indikatorëve të fushave në formatin e komunikimit MARC 21 për të dhënat bibliografike;
- Manual për katalogimin e periodikëve në MARC 21;
- Manual për përdorimin e modulit të pasurimit;
- Udhëzues për përdorimin e sistemit të kërkimit në Alis;
- Udhëzues mbi plotësimin e disa fushave të të dhënave bibliografike dhe të njësuara në sistem; Udhëzues mbi përdorimin e fushës 008 në formatin MARC 21;
- Udhëzues mbi përdorimin e Leader 000 në formatin MARC 21;
- Udhëzime për ngritjen e sistemit të digjitalizimit në BKSH;
- Udhëzime mbi standardet që duhet të bazohet ngritja e sistemit të digjitalizimit në BKSH.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga sektori i studimit dhe kualifikimit në BKSH, janë paraqitur udhëzimet standarde për unifikimin e proceseve të përpunimit të materialeve bibliotekare në bibliotekat e sistemit kombëtar, si faktor me rëndësi për shkëmbimin e informacionit, por ato nuk janë të publikuara nëËEB, për tëi shërbyer gjithë sistemit bibliotekar kombëtar.

5. Konkluzion: Në kushtet aktuale ku BKSH gëzon statusin e partnerit me të drejta të plota në disa projekte ndërkombëtare si: Bibliotekën Evropiane (EUROPEANA) si dhe në Bibliotekën Digjitale Botërore, informacionet që transmeton nëpërmjet faqes online, kërkojnë një staf cilësor dhe bashkëkohor me përgatitje të lartë profesionale, reflektuar kjo në akte metodikë dhe udhëzues në mbështetje të përmirësimit të proceseve të punës pjesërisht të informatizuar si dhe të hartuara në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: BKSH, sektori i studimit dhe kualifikimit të marrë masa për të publikuar në faqen e internetit të BK-së, të gjitha udhëzimet, metodikat apo përkthimet e ndryshme për tëi ardhur në ndihmë dhe për të pasur një standard pune në të gjithë sistemin kombëtar bibliotekar në Shqipëri.

Janar 2022 e në vijimësi

5. PËRMBLEDHJE

Raporti i auditimit të performancës në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë me temë ñEfektiviteti i aktivitetit të BKSHò, krahas evidentimit të kornizës legjislative mbi të cilën duhet të përputhet organizimi dhe funksionimi i BK-së, ka synuar gjithashtu të krijojë një tablo të qartë mbi funksionin e çdo sektori në Bibliotekën Kombëtare për vlerësimin e situatës aktuale të menaxhimit dhe efektivitetit të aktivitetit të saj kombëtar. Në këtë auditim jemi përqëndruar vetem në institucionin kryesor që është BKSH, por nuk mund tëa shikonim veprimtarinë e saj të ndarë nga varësia që ajo ka nga Ministria e Kulturës si organi përgjegjës

që harton dhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar.Objektivi kryesor i auditimit ka qenë analizimi i politikave dhe zbatimi i planeve strategjikë të BK në zbatim të bazës ligjore: Ligjit nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligjit nr.9616, datë 27.09.2006 ñPër librin në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, dhe rregullores së brendshme të këtij institucioni miratuar me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010.

Auditimi u fokusua në drejtim të hartimit të planeve operacionale për realizimin e objektivave referuar strukturave përkatëse, monitorimi i zbatimit të objektivave strategjik, proces i cili është vendimtar për të vlerësuar arritjen e rezultateve të parashikuara, si dhe për të evidentuar shmangiet nga rezultatet e pritura me qëllim marrjen e masave për përmirësim. Në mënyrë të detajuara të gjitha mangësitë janë trajtuar hollësisht në këtë Raport Auditimi rast pas rasti si gjetje konkrete me konkluzionet përkatëse si dhe për çdo rast është rekomanduar mënyra e përmirësimit dhe përsosjes së tyre.

-Veprimtaria e Bibliotekës Kombëtare si institucioni unik kulturor, shkencor publik e qendror i vendit, referuar akteve ligjore, përgjigjeve të pyetësorëve dhe dokumentacionit të paraqitur nga BK rezultoi se për periudhën objekt auditimi:

Nuk është zhvilluar në bazë të një politike kulturore për zhvillimin e rrjetit të bibliotekave të hartuar nga MK.

Kjo për faktin se Ministria e Kulturës ka detyrimin ligjor që të hartojë strategji afatmesme apo afatgjatë mbarë-kombëtare për bibliotekat publike dhe Bibliotekën Kombëtare, referuar nenit. 11 të ligjit nr. 8576, datë 3.2.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, ku citohet se: ñ*Ministria e Kulturës hartondhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe të politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar*ò, e *parealizuar* për periudhën objekt auditimi.

Strategjia Kombëtare e MK për vitin 2019-2025, miratuar me VKM nr.903, datë 24.12.2019, dhe dërguar në formë elektronike BKSH-së, më 22 Prill 2020, prek tagencialisht misionin e parashikuar prej shumë vitesh hartimin e projektit për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore në të cilën përfshihet edhe ideja për ngritjen e një Biblioteke të re Kombëtare, por kjo ka mbetur vetëm në letra dhe aktualisht BKSH vazhdon të zhvillojë aktivitetin e saj në një godinë tejet të amortizuar dhe me shume risqe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në strategjinë e MK-së nuk ka afate kohore dhe nuk janë alokuar fonde buxhetore për realizimin e kësaj ñprojekt idejeò, por ajo që u konstatua është edhe minimizimi i fondeve të buxhetit të shtetit të alokuara BKSH-së për periudhën në auditim në lidhje me kërkesat e PBA-së të bërë nga ky institucion për investime në ruajtjen e librave dhe zgjerimin apo sigurimin e hapësirave ekzistuese të BKSH-së.

-Rezulton se për periudhën 2018-2020 e në vazhdim, veprimtaria e BK është mbështetur në *draft strategjinë 2016-2021* të hartuar nga një grup prej 13 anëtarësh punonjës të Bibliotekës Kombëtare, të përbërë nga kryetar ish Titullar ja e BK z. X, dhe 12 anëtarët e tjerë përgjegjës të sektorëve të institucionit, sipas shkresës nr.19.prot., datë 19.01.2015, draft i cili nuk rezulton të jetë shqyrtuar nga Këshilli Shkencor në bazë neni 24 të ligjit nr. 8576,datë 03.02.2000, ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisë ñi ndryshuar, dhe të jetë miratuar nga MK si institucion i cili harton politikat për tu zbatuar nga institucionet e varësisë, në bazë të nenit 11të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000.të ligjit nr. 8576,datë 03.02.2000, ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëòi ndryshuar. Hartimi i kësaj strategjie në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës ka qenë dhe një nga rekomandimet kryesore të KLSH-së, në auditimin e mëparshëm të kryer në BK me shkresën nr. prot. 100/26, datë 26.12.2014, e cila rezulton e zbatuar pjesërisht.

-Gjithashtu aktiviteti i BKSH-së për periudhën në auditim është bazuar në rregulloren aktuale të brendshme të miratuar nga ish-Drejtori i Institucionit **me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010** ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò dhe ndryshimet e strukturave për punonjësit për më shumë se 1 (një) herë dhe evoluimi i kohës dhe sfidave teknologjike nuk janë shoqëruar me ndryshimin shumë të nevojshëm të kësaj rregulloreje e miratuar para 10 vjetësh. Pra BK me gjithë ndryshimet strukturore por edhe teknologjike, ka vazhduar të funksionojë me një Rregullore tashmë ñ*të vjetër"*. Pikërisht mungesa e një rregulloreje në funksion të ndryshimit të strukturave ka bërë që mos të realizohet objektivi kryesor i saj që është :

BK veprimtarinë e saj e ndërton në bazë të Rregullores së Brendshme që përcakton detyrat dhe të drejtat e të gjithë elementëve të strukturës, duke synuar realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.

Gjithashtu në rregulloren aktuale të brendshme të Institucionit nuk janë reflektuar detyra të mirë përcaktuara dhe detajim i tyre për të gjitha strukturat ekzistuese si dhe të bëhet përshkrimi i punës për secilin specialist sipas funksionit që përfaqëson, bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 ñMbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, duke mos parashikuar marrëdhëniet e punës. Janë përcaktuar funksionet që ka ñ**përgjegjësi i sektorit"**, por nuk janë detajuar objektivat e punës për secilin specialist sipas sektorit përkatës, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion dhe kush përgjigjet për realizimet e detyrave për çdo sektor duke krijuar një mungesë llogaridhënie të vazhdueshme dhe jo efikasitet në punën e kryer, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.

-E njëjta situatë paraqitet në veprimtarinë organizative të secilit sektor dhe përgjegjësve të tyre ku konstatohet se puna e tyre mbështetet në plane *sporadikë* të pa detajuar në afate dhe përgjegjësi individuale, të pa konsultuar në Këshillin Administrativ të BKSH dhe të pa miratuara nga Drejtori, në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ñ, nenin 16, pika 2, si dhe nenin 23. Mungesa në rastin konkret të këtyre planeve dhe mos monitorim i realizimit të tyre ka sjellë menaxhim të burimeve njerëzore dhe financiare pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.

-Një nga sektorët me rëndësi në BKSH i cili ka ñvuajturò, mungesën e politikave dhe strategjisë së MK si dhe mungesën e planeve strategjikë vjetorë të BK ështëSektori i Zhvillimit të Koleksioneve, pasi ai administron, dokumenton dhe kryen verifikimin e materialeve bibliotekare. Ai është ñPorta e parëò për çdo libër që hyn në Bibliotekë, por me funksionet e tij kryen edhe ruajtjen e kësaj trashëgimie nëpërmjet procesit të inventarizimit i cili nuk ka funksionuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr.25/2018 datë 15.05.2018 ñ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, si dhe në Udhëzimittë MF nr.30, datë 27.12.2011 ñ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar. Këto politika jo efektive kanë ndikuar veçanërisht në Komisionin e Inventarizimit të Koleksioneve, sektor që në përbërjen e tij mungojnë ekonomistë, të cilët janë të domosdoshëm pasi përpilohen dokumente dhe mbahen regjistra, verifikohen koleksione të cilët do të zbatonin rregulla dhe procedura që kërkojnë njohuri nga kontabiliteti duke kryer paralelishtedhe trajnime në fushën e bibliotekonomisë në zbatim të kërkesave të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000 ñPër bibliotekat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar. Planet e punës rezultojnë të pa protokolluara pa analiza të detajuara, pa tregues të matshëm dhe të arritshëm të mbështetura në norma teknike profesionale duke sjellë mos realizimin e detyrave funksionale e në veçanti verifikimin e koleksioneve i cili rezulton i pa kryer ndër vite duke ndikuar në performancën e dobët të këtij sektori. Në sektor **nuk është organizuar ndër vite mbajtje e veçantë e kartelave të inventarit për materialet bibliotekare** sipas vendit të depozitimit dhe personave përgjegjës,

referuar kërkesave të Udhëzimi i MF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 26, pika 35/pika c.
-Problematikatë konstatuara, janë dhe përpilimi i dokumenteve që evidentojnë hyrjen e materialeve bibliotekare dhe regjistrimi i tyre në libra përkatës sikurse është Akti i hyrjes, i cili mbahet në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve për çdo material bibliotekar që hyn në BK përveç periodikut që mbahet nga Sektori i Shërbimit dhe i Informacionit, ku vendoset sasia në numër, datë dhe me emër botuesi, ose me emër dhuruesi në sasi, çmim dhe vlerë duke vendosur emrin e subjektit botues por pa vendosur numrin e faturës bashkangjitur, aktetë cilat përpilohen në dy kopje dhe si pasojë në regjistër në inventarin e akt-hyrjeve rezulton e pa evidentuar kopja e detyruar si burimi i ardhjes dhe fatura si dokument justifikues. Gjithashtu edhe në sektorin e Shërbimit dhe të Informacionit për materialet periodike të mbërritura në BK nuk vendoset në Akt Hyrjen e përgatitur prej këtij sektori burimi i ardhjes dhe çdo dokument tjetër shoqërues.

-Aktualisht, shërbimi bibliotekar dhe veçanërisht Biblioteka Kombëtare e ushtron aktivitetin e saj në kushte të vështira, jo të denja për një institucion të tillë, simbol të kulturës kombëtare. Një nga problemet kryesore dhe i pashmangshëm në gjithë historikun e këtij institucioni është kriza e hapësirave që konsistojnë si në mungesën ambienteve për ruajtjen dhe koleksionimin e librave, në mungesën e hapësirave për lexuesit, në mungesën e hapësirave për personelin punonjës të BKSH-së, në mungesën e kushteve në shërbim tëpërdoruesvemeaftësitëkufizuar tëcilat kanë sjellë në mos përmirësimin e performancës të BKSH për periudhën në auditim.
Ajo që është shqetësuese është se edhe sot pas 6-vitesh nga auditimi i fundit situata vazhdon e njëjtë dhe më problematike pasi sa më shumë kalojnë vitet, aq më shumë amortizohet ndërtesa, duke sjellë një risk të lartë si në rënien e zjarrit ashtu edhe në përmbytjen e katit të parë, ku ruhet edhe fondi i vlerave të rralla, që për vetë rëndësinë që ai ka do të ishte ñkatastrofë kombëtareò humbja e tij.
Që prej vitit 1986 është ndjerë mungesa e hapësirës për të vendosur materialet bibliotekare në fond, çfarë ka detyruar që jashtë çdo standardi botëror të gjenden zgjidhje provizore të natyrave të ndryshme:

- Materialet bibliotekare nuk vendosen në rafte, por në dysheme;
- Fondi i vlerave të rralla (antikuar dhe dorëshkrime) vendoset pjesërisht në arka metalike jashtë çdo normative e standardi ndërkombëtar;

-Një nga objektivat kryesorë të BKSH, për periudhën në auditim ka qenë sfida teknologjike e BKSH dhe procesi i digjitimit të saj. Rolin kryesor në procesin e digjitimit e kanë tre sektorët të cilët janë Sektori i Bibliografisë kombëtare, sektori i albano-balkanologjisë si dhe sektori i IT-së. Prandaj për të kuptuar dhe vlerësuar efektivitetin e këtij procesi me rëndësi, puna audituese u fokusua pikërisht në këta sektorë dhe veprimtarinë e tyre për periudhën 2018-2020. Megjithëse procesi i digjitimit ka bërë hapa përpara, përsëri ka pasur mangësi në menaxhim duke sjellë jo efektivitet dhe pritshmërinë e duhur. Rolin kryesor në digjitimin e materialeve bibliotekare e ka Qendra Bibliotekare e Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar e cila është pjesë integrale e sektorit të Bibliografisë.
Misioni i Qendrës Bibliotekare të Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar, është ofrimi i digjitimit të materialeve të mediave dhe formateve të ndryshme, duke garantuar njëkohësisht aftësinë për të ndërhyrë përmes mjeteve të posaçme dhe soft eve për përshtatje apo korrigjim të ndonjë defekti në material duke mundësuar riprodhim sa më afër origjinalit.
Mungesa e planeve operacionalë me detyra, afate të mirë përcaktuara, norma mujore të digjitimit për secilin punonjës përgjegjës, si dhe mungesa e listave vjetore të materialeve

bibliotekare të planifikuara për digjitim e të pa miratuara nga Drejtori i Institucionit, në të dy sektorët e sipërcituar, ka sjellë përdorim të burimeve njerëzore pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.
Mungesa e gjurmës së auditimit në të gjitha proceset e digjitimit e cila mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura, ka sjellë një digjitim pjesërisht efektiv të materialeve bibliotekare të Fondit, pa pasur as pritshmëri dhe as targete të cilat duhet të arriheshin në fund të çdo tremujori, gjashtëmujori apo vit kalendarik.
Këshilli Shkencor dhe Këshilli Administrativ i Bibliotekës rezulton të kenë qenë joefektiv, duke mos përmbushur detyrat e tyre funksionale në kundërshtim me nenin 16 dhe 17 të Statutit të BK miratuar me Urdhër nr.70, datë 13.02.2015, si dhe nenin 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 ñPër organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtareò, duke sjellë mungesë në gjurmën e auditimit, mungesë të planeve të veprimtarisë studimore dhe mungesë te eficencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të aktivitetit të BK-së, në procesin e digjitalizimit.

Për të gjitha mangësitë e sipërcituara, grupi i auditmit të KLSH-së ka lënë rekomandimet përkatëse të detajuara për çdo gjetje.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

GRUPI I AUDITIMIT

Å X, Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
Å X, Auditues
Å X, Auditues